



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në
Evropë Prezenca në Shqipëri



Qendra e Aleancës Gjinore
për Zhvillim

DORACAK I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Tiranë, qershor 2008

Financuar nga:  **Austrian
Development Cooperation**

Ky doracak u përgatit në vazhden e zbatimit të projektit “Rritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimit në dhënien e asistencës ndaj viktimave të trafikimit”, të mbështetur nga OSBE, Prezenca në Shqipëri dhe financuar nga ADA (Austrian Development Cooperation). Materialet e këtij doracaku mbështeten kryesisht në ekspertizën e autoreve si dhe në burime parësore mbi temën e trafikimit. Për rrjedhojë, përmbajtja e këtij doracaku nuk përfaqëson domosdoshmërisht këndvështrimet e OSBE-së apo çdo organizate tjetër ku OSBE është pjesë.

| | |
|--------------------------|--|
| Përgatitur nga: | Eglantina Gjermeni Irena Taga Izela Tahsini Marjana Meshi |
| Redaktoi tekstin: | Aurora Guxholli |

© Për botimin në shqip, të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Qendrën e Aleancës Gjimore për Zhvillim dhe OSBE, Prezenca në Shqipëri.

Këtë botim mund ta gjeni në formën elektronike në adresën:
<http://www.gadc-al.org>

Layout: Visi Design

Shtypur në shtypshkronjën:  **mediaprint**
SHTËPIA BOTUESE
info@mediaprint@gmail.com
sh.p.k.

ISBN:

| | |
|--|----|
| Hyrje | 5 |
| KAPITULLI 1 KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE | 7 |
| 1.1 Hyrje - Historiku i fenomenit të trafikimit në Shqipëri | 8 |
| 1.2 Korniza ligjore kombëtare | 12 |
| a. Konventat kryesore në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore ku Shqipëria është palë | |
| b. Korniza ligjore kombëtare | 12 |
| I. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë | 12 |
| II. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale | 12 |
| 1. Dallimi mes veprave të trafikimit, ushtrimit të prostitucionit dhe kalimit të paligjshëm të kufirit. | 12 |
| III. Ligje dhe akte të tjera nënligjore | 16 |
| 1.3 Korniza institucionale | 19 |
| KAPITULLI 2 IDENTIFIKIMI DHE REFERIMI I VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT | 23 |
| 2.1 Format e fenomenit të trafikimit, shkaqet dhe pasojat | 24 |
| 2.1.1 Përmasat, format dhe shkaqet e lidhura me trafikimin | 24 |
| 2.1.2 Pasojat e trafikimit | 27 |
| 2.2 Procesi i identifikimit të një viktime trafikimi | 31 |
| 2.2.1 Pse është i rëndësishëm identifikimi i viktimës së trafikimit? | 31 |
| 2.2.2 Çfarë mund ta dëmtojë procesin e identifikimit | 32 |
| 2.2.3 Kush mund të identifikojë një viktimë trafikimi | 35 |
| 2.2.4 Përbërësit e procesit të identifikimit | 37 |
| 2.3 Rëndësia e referimit të viktimës dhe hapat që duhet të ndiqen | 43 |
| KAPITULLI 3 MBROJTJA DHE RIINTEGRIMI I VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT | 47 |
| 3.1 Ndërhyrja | 48 |
| 3.2 Metodatat/teknikat e vlerësimit | 52 |
| 3.3 Ndihma dhe shërbimet që u ofrohen viktimave | 57 |
| 3.4 Siguria dhe marrja e masave mbrojtëse ⁹⁹ | 71 |
| 3.5 Këshillimi | 73 |
| 3.6 Planifikimi i mbrojtjes dhe riintegrimit | 77 |
| 3.7 Monitorimi/Follow-up | 81 |

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|------------|
| KAPITULLI 4 TRAJTIMI I VIKTIMËS DHE KUJDESI NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMIT | 85 |
| 4.1 Standardet etike të punës me viktimat e trafikimit | 86 |
| 4.1.1 Vlerat dhe etika108 | 86 |
| 4.1.2 Kodi etik i punonjësit social | 92 |
| 4.2 Siguria e ofruesve të shërbimit | 97 |
| 4.3 Konsumimi profesional dhe kujdesi i profesionistëve për veten118 | 98 |
| KAPITULLI 5 PARANDALIMI I FENOMENIT TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE ... | 107 |
| 5.1 Strategjitë parandaluese | 108 |
| 5.2 Të tjera masa ligjore | 115 |
| 5.3 Programe parandaluese të shoqërisë civile | 116 |
| SHTOJCA | 119 |
| I Intervista | 119 |
| II Lista e qendrave që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit | 122 |
| BIBLIOGRAFIA | 127 |

Ky doracak u përgatit në vazhden e zbatimit të projektit “Rritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve në dhënien e asistencës viktimave të trafikimit; ndërgjegjësimi si kundërveprues i stigmatizimit të viktimave”. Qëllimi i tij është të përdoret nga trajnuesit si mjet informativ për çështje që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo dhe të tërthortë kanë të bëjnë me fenomenin e trafikimit. Pikërisht trajtimi gjithëpërfshirës i fenomenit të trafikimit është edhe risia që ky doracak sjell për përdoruesit e tij. Vlen të përmendim këtu përfshirjen e trajtimit profesional të temave si identifikimi, referimi dhe intervistimi i viktimave të trafikimit, procesi profesional i këshillimit, etj.

Për më tepër, ky doracak i mundëson përdoruesit të konkretizojë aspektin teorik të fenomenit të trafikimit duke pasqyruar shembuj të shumtë praktikë. Veçojmë këtu trajtimin e përpjekjeve për riintegrimin e viktimës, proces i cili është i lidhur ngushtë me rrethanat ekonomike e sociale të vendit ku ndodh. Përshkrimi i punës së bërë në disa qendra të pritjes dhe trajtimit të viktimave të trafikimit ofron informacion të përditësuar dhe konkret në lidhje me atë çka realisht ndodh në Shqipëri. Një tjetër risi e këtij doracaku është përfshirja e Standardeve për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale, të hartuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Standardet për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi hartohen për herë të parë, e si të tilla janë një dokument i rëndësisë së veçantë për sa i përket etikës së punës së ofruesve të shërbimeve.

Trajtimi i detajuar i temave si konsumimi profesional i ofruesve të shërbimit janë jo rastësisht të përfshira në këtë doracak. Me ofrues shërbimesh nënkuptohet punonjës socialë dhe inspektorë të zyrës së punës me viktimat e trafikimit, dy grupet kryesore për të cilat u përgatit ky doracak. Ai do të përdoret gjithashtu edhe si udhëzues informativ gjatë trajnimit të trajnerëve dhe trajnimeve në vijim me punonjësit socialë dhe inspektorët e zyrës së punës në 12 prefekturat e vendit.



***Korniza ligjore dhe
institucionale për
parandalimin dhe
Luftën kundër
trafikimit të qenieve
njerëzore***

1. HYRJE - HISTORIKU I FENOMENIT TË TRAFIKIMIT NË SHQIPËRI

“Trafikimi i personave është një formë e skllavërisë së kohëve moderne, një lloj i ri i tregtisë globale të skllavërisë”.¹

Sikurse dhe në vendet e tjera të rajonit, edhe në Shqipëri fenomeni i trafikimit filloi të zhvillohet e të marrë përmasa shqetësuese pas viteve 90. Në vitet 1990-1995, procesi i trafikimit kryhej nga individë të veçantë, bazuar në lidhjet familjare, fisnore apo krahinore. Më vonë ky fenomen erdhi duke u organizuar dhe arriti kulmin në vitet 1997-2001, kur u krijuan organizata të mirëfillta kriminale, të cilët u përqendruan në trafikimin e femrave për shfrytëzim prostitucioni dhe trafikimin e fëmijëve për lypje.

Në të njëjtën kohë, duhet theksuar fakti që trafikimi në njerëz, ashtu si në një pjesë të mirë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, është i lidhur ngushtë me faktorë të ndryshëm ekonomiko-shoqërorë dhe politikë në Shqipëri, zhvillimet e të cilit janë të ndryshueshme por gjithsesi me prirje për t'u ulur.

Vetëm pas vitit 2001 trafikimi u pranua si problem dhe filloi të goditej seriozisht nëpërmjet zbatimit me shpejtësi të reformës ligjore, duke përfshirë në Kodin Penal dispozita ligjore ku parashikohen dënime të ashpra për fenomenin e trafikimit.

Në Shqipëri, legjislacioni që merret me goditjen e trafikimit të qenieve njerëzore ka pësuar ndryshime thelbësore, duke synuar që me anë të ndryshimeve e përmirësimeve të herëpashershme të plotësohen sa më mirë standardet ndërkombëtare të legjislacionit të brendshëm. Masat penale të parashikuara nga legjislacioni ynë për trafikantët janë tepër të rënda, ato parashikojnë deri në 25 vjet burg dhe kur ka pasoja të jetës së viktimave të trafikuar dënimi ndryshon deri në burgim të përjetshëm.

Si rezultat i një politike agresive ndaj këtij fenomeni, e shoqëruar kjo me dënime të rënda dhe me konfiskim të pasurive të autorëve të krimit, fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore është ulur ndjeshëm. Sipas statistikave të Raportit të Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007, trafikimi si i femrave dhe i fëmijëve është në ulje. Kështu, për vitin 2005 ka pasur 30 femra viktime të trafikimit dhe 7 fëmijë; në vitin 2006 ka pasur 25 femra dhe 4 fëmijë viktime të trafikimit dhe në vitin 2007 ka pasur vetëm 12 femra dhe 3 fëmijë viktime të trafikimit².

¹Rice, Condoleezza. Raporti për Trafikimin në Njerëz i qershor 2007-s. <http://www.state.gov> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

²Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz. Raporti i Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007. Për më shumë referoju adresës: <http://www.moi.gov.al/images/pdf/buletini/RaportiVleresuesStrategjiseKombetareAntitrafikim2005-2007.pdf> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].*

Në bazë edhe të vlerësimeve ndërkombëtare, tashmë Shqipëria nuk është më vend tranziti dhe as ndonjë vend i rëndësishëm destinacioni, por është vend origjine për gratë dhe vajzat e trafikuar përtej kufijve, por në rritje gjithashtu edhe brenda kufijve. Viktimat shqiptare trafikohen drejt Greqisë dhe Italisë dhe më pas drejt Anglisë, Francës, Belgjikës, Norvegjisë, Gjermanisë dhe Holandës³. Trafikantët përdornin gjerësisht rrugët tokësore ose dokumente të falsifikuar për të transportuar viktimat e tyre me avion apo anije.

Pjesa më e madhe e fëmijëve të trafikuar në Greqi shfrytëzohen për punë të detyruar, përfshirë këtu lypjen dhe krimet e rrugës. Disa prej tyre trafikohen për qëllime shfrytëzimi seksual. Sipas Terre des Hommes (TdH) dhe Arsis 337 fëmijë shqiptarë janë identifikuar në Selanik dhe Athinë të Greqisë si viktima të trafikimit⁴. Gjithsesi, numri i fëmijëve shqiptarë të trafikuar në Greqi pati rënie në vitin 2006⁵.

Ajo ç'ka është shqetësuese për momentin është trafikimi i brendshëm. Policia dhe qendrat ri-integruese dëshmojnë për faktin që vajzat merren me forcë nga fshatrat dhe dërgohen në qytete të vogla apo të mëdha për të prostituiuar në hotele apo shtëpi private.

Nëse do të flisnim për mënyrat e rekrutimit, ato vazhdojnë të jenë martesë të rreme apo romanca mashtrimi për t'i joshur vajzat të shkojnë jashtë shtetit për t'i shfrytëzuar më pas për prostitucion. Gjendja ekonomike shumë e keqe dhe niveli i ulët arsimor i bëjnë vajzat dhe fëmijët tejet të cenueshëm ndaj këtij fenomeni dhe kriminelëve. Trafikantët sekuestrojnë dokumentet e viktimave dhe abuzojnë me to fizikisht dhe seksualisht, duke i detyruar të prostitutojnë para se të lejnë vendin. Një nga presionet kryesore që iu bëhet viktimave është kërcënimi se nëse nuk pranojnë të prostitutojnë, familjarët e tyre do të lëndohen⁶.

Në vijim do të njiheni më hollësisht me kuadrin ligjor në fuqi, si edhe me mekanizmat dhe institucionet e ngritura me qëllim luftën dhe parandalimin e trafikimit në njerëz.

³Departamenti Amerikan i Shtetit. Raporti për Trafikimin në Njerëz i qershor 2007-s. <http://www.state.gov> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

⁴Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor. Country Reports on Human Rights Practices - 2007, <http://www.state.gov/drl/rls/hrrpt/2007/100544.htm> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

⁵Departamenti Amerikan i Shtetit. Raporti për Trafikimin në Njerëz i qershor 2007-s. <http://www.state.gov> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

⁶Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor. Country Reports on Human Rights Practices - 2007, <http://www.state.gov/drl/rls/hrrpt/2007/100544.htm> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

2. KORNIZA LIGJORE

Duhet thënë se Shqipëria ka një kuadër të mirë ligjor, në përputhje të plotë me konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare ku ajo ka aderuar dhe është palë. Gjithashtu, Shqipëria parashikon masa tepër të rrepta ndëshkimi për personat që kryejnë veprën penale të trafikimit të personave, që shkojnë deri në dënim kapital – burgim të përjetshëm – në rrethana rënduese.

Në vijim do të jepet një tablo e përgjithshme e akteve ndërkombëtare që trajtojnë çështjen e trafikimit të personave, si dhe e kuadrit ligjor vendas, duke synuar dhënien e informacionit të duhur për identifikimin e një viktime të trafikimit.

Konventat kryesore në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore ku Shqipëria është palë

Për trafikimin si një term i tillë është folur rreth fundit të shekullit të 19-të.⁷ Duke marrë në konsideratë situatën dhe rrethanat e kohës në fjalë, edhe përpjekjet e para për të luftuar trafikimin në njerëz lidhen me Marrëveshjen Ndërkombëtare për Shtypjen e Tregut të Skllëvërve të Bardhë.⁸

Duke mos dashur të bëjmë një listë të gjatë të akteve ndërkombëtare që fillojnë, siç thuhet dhe më lart, që në fillim të shekullit të 19-të, le të shohim ato akte që kanë lidhje drejtpërsëdrejti me trafikimin në njerëz.

Kështu, Shqipëria ka aderuar dhe është palë në Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional, si dhe të Protokolleve të saj shtesë që në vitin 2002 dhe është ndër shtetet e para që ka zbatuar detyrimet që rrjedhin prej saj menjëherë pas nënshkrimit.

Një ndër protokollat e Konventës kundër Krimit të Organizuar Transnacional është “Protokolli Shtesë mbi ‘Parandalimin, shtypjen, dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve’ i Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional”, ndryshe i njohur si Protokolli i Palermos⁹. Në të, për herë të parë jepet përkufizimi i trafikimit të personave si krim dhe ky dokument shërben si model për hartimin e legjislacionit vendas në lidhje me trajtimin e çështjeve të trafikimit të personave. Në këtë drejtim, neni 110/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë është hartuar në përputhje të plotë me Protokollin e Palermos.

⁷Për më shumë informacion referoju adresës: www.antislavery.org [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

⁸Koca, Arqilea. Vështrim juridiko-penal krahasues kriminologjik dhe procedural mbi trafikimin e qenieve njerëzore. Tiranë: Konica, 2006.

⁹Ligji nr. 8920, datë 11.07.2002, Fletore Zyrtare nr. 41, korrik 2002.

Protokolli tjetër shtesë i po kësaj konvente, “Protokolli kundër Kontrabandimit të Emigrantëve me Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare” njohur ndryshe edhe si “Protokolli i Emigrantëve”, synon parandalimin dhe luftën kundër kontrabandimit të emigrantëve, si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.¹⁰

Një hap tjetër ndërkombëtar në drejtim të luftës kundër trafikimit të personave është edhe nënshkrimi dhe ratifikimi i Konventës së Këshillit të Europës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, maj 2005¹¹, risia e të cilës është përkufizimi i viktimës së trafikimit. Sipas kësaj konvente “Viktimë” do të nënkuptojë çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në këtë nen”.¹²

- i. Akte të Tjera Ndërkombëtare¹³
 1. ***Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut***, dhjetor 1948 – dokumenti themeltar për hartimin e legjislacioneve nga shtetet, i bazuar në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.¹⁴
 2. ***Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës*** – dokumenti themeltar për ngritjen e konceptit të “mbrojtjes” së fëmijëve.¹⁵
 3. ***Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut***¹⁶ - e cila dënon format më të shëmtuara të shfrytëzimit dhe degradimit të genies njerëzore.

¹⁰Për më shumë informacion referoju adresës: www.uncij.org/documents/conventions [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

¹¹Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore””, Fletorja Zyrtare nr. 132, 2006.

¹²Neni 4/e i Ligj Nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore””, Fletorja Zyrtare nr. 132, 2006.

¹³Për më shumë informacion në lidhje me Konventat apo Dokumentet Ndërkombëtare ku Shqipëria është palë referoju faqes zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme: http://www.mfa.gov.al/shqip/lista_e_konventave.asp www.uncij.org/documents/conventions [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

¹⁴Për më shumë informacion referoju adresës: <http://www.un.org/Overview/rights.html> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

¹⁵Neni 19 i Konventës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar më 27 shkurt 1992.

¹⁶Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për Ratifikimin e Konventës Europiane Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, Fletorja Zyrtare Nr 20, 1996.

4. **Protokollin shtesë i Konventës për të drejtat e fëmijës për shitjen e fëmijës, prostitucionin e fëmijës dhe pornografinë e fëmijës**¹⁷ – i cili ndalon dhe dënon shitjen e fëmijës, prostituimin dhe pornografinë me të mitur.

KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE

Më lart dhamë një pamje të përgjithshme të akteve ndërkombëtare të lidhura drejtpërdrejt ose jo me trafikimin e personave. Në vijim do të japim informacion në lidhje me kuadrin ligjor shqiptar, bazuar tek i cili duhet të bëhet procesi i identifikimit dhe ofrimi i menjëhershëm i asistencës ndaj viktimës së trafikimit. Duhet theksuar fakti që Shqipëria është bazuar pikërisht në dokumentet e lartpërmendura në hartimin e legjislacionit në vijim.

i. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹⁸

Është e vërtetë që në Kushtetutën e Shqipërisë nuk shprehet në mënyrë të drejtpërdrejtë lufta kundër trafikimit në njerëz, megjithatë, në Pjesën e Dytë, Kapitulli II “Të Drejtat dhe Liritë Personale”, si dhe në Nenin 3 ku *inter alia* thuhet: “...dinjiteti i një njeriu, të drejtat dhe liritë ... janë themeli i këtij vendi, që ka detyrimin për t’i respektuar dhe mbrojtur ato” sigurohet dinjiteti, të drejtat dhe liritë e çdo shtetasi shqiptar.

Në vijim, Neni 26 i Kushtetutës, në përputhje të plotë me Nenin 4 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut thotë: “Askush nuk duhet të kërkohet të kryejë punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, kryerjes së shërbimit ushtarak, apo për një shërbim që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme, ose nga një fatkeqësi natyrore që kërcënon jetën ose shëndetin e njeriut”.

ii. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

Për herë të parë trafikimi i qenieve njerëzore është parashikuar si krim në Kodin Penal të Shqipërisë, duke vendosur dispozita të veçanta, me Ligjin Nr. 8733, viti 2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në

¹⁷Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 9834, datë 22.11.2007 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijëve, për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë”. Fletorja Zyrtare Nr 165, 2007. Për më shumë informacion referoju: <http://www.unhchr.ch/html/menu2/6/crc/treaties/opsc.htm> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

¹⁸Për tekstin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë referoju adresës: <http://www.president.al/shqip/kushtetuta.asp> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Shqipërisë, ku pas nenit 110 u shtua neni 110/a “*Trafikimi i njerëzve*”. Po me këtë ligj, pas nenit 114 u shtua neni 114/a “*Trafikimi i femrave për prostitucion*”. Njëkohësisht po në këtë ligj, pas nenit 128 të Kodit Penal u shtua neni 128/b “*Trafikimi i fëmijëve*”.

Për të qenë në përputhje të plotë me Protokollin e Palermos, me Ligjin Nr. 9188, datë 12.2.2004, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Shqipërisë' i ndryshuar*”, neni 110/a u ndryshua si më poshtë¹⁹:

“TRAFIKIMI I PERSONAVE”:

“Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit,

Dënimi: **5-15 vjet burgim dhe gjobë prej 2-5 milion lek.**

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave

Dënimi: **7-15 vjet burg dhe gjobë nga 4-6 milion lek**

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin,

Dënimi: **Jo më pak se 15 vjet burgim dhe gjobë 6-8 milion lek.**

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit,

Dënimi: **Jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë 7-10 milion lek.**

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik,

Dënimi: **Një e katërt shtesë e burgimit dhe gjobës**”

¹⁹Ky ndryshim është bërë në përputhje të plotë me Nenin 3 të Protokollit të Palermos, i cili përkufizon si vijon:

a) “**Trafikim i qenieve njerëzore**” nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose marrjen e personave me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, të shpërdorimit të detyrës, të atyre që kanë një pozicion të pambrojtur apo dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur miratimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë minimalisht shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikatat e ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve.

Po me këtë ligj janë ndryshuar edhe përmbajtja e neneve 114/b “**Trafikimi i femrave**” dhe 128/b “**Trafikimi i të miturve**”, duke u vendosur për secilin prej tyre po e njëjta përmbajtje si ajo e nenit 110/a me ndonjë ndryshim të vogël dhe po me ato masa dënimi.

Duke marrë në konsideratë përkufizimin e mësipërm, trafikimi i personave ka si elementë të tij kyç:

1. **Veprimtarinë** – rekrutimi, transporti, transferimi, mbajtja dhe pritja e personave;
2. **Mënyrat** – kërcënim i ose përdorimi i forcës ose i formave të tjera të rrëmbimit, mashtrimit, falsifikimit, abuzimit me pushtetin ose situatën e pafavorshme, ose nëpërmjet dhënies dhe marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontrollin mbi një person tjetër;
3. **Qëllimin** – shfrytëzimi i një personi sipas mënyrave të renditura në nenin 110/a të Kodit Penal apo Nenit 3 të Protokollit të Palermos.²⁰

Ndërkohë që, sipas nenit 4/e të Konventës së Këshillit të Europës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, **viktimë** do të nënkuptojë çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në këtë nen.

Ndryshimet e mësipërme, *inter alia*, synonin harmonizimin e Kodit Penal me legjislacionin ndërkombëtar penal dhe dokumentet e tjerë ndërkombëtarë të ratifikuar nga Shqipëria, prezantimin e disa dispozitave të reja penale si rrjedhojë e një eksperience 6-vjeçare-* dhe kërkesat e reja bashkëkohore në luftë kundër krimit, kryesisht atij të organizuar, duke siguruar në të njëjtën kohë masa më të rënda ndëshkimi.

Ndryshime të tjera në Kodin Penal janë bërë edhe për të ndaluar dhe ndëshkuar edhe veprën penale të ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, më saktësisht Neni 298, me këtë përmbajtje:

²⁰IOM. Manuali i IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Tiranë, 2007.

“NDIHMA PËR KALIM TË PALIGJSHËM TË KUFIJVE”²¹

Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit, ose i mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihme tjetër me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë, ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër pa qene shtetas i tij, ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet, përbën veprë penale

Dënimi: 1-4 vjet burg dhe gjobë 3-6 milion lek.

Kur ndihma jepet për qëllime fitimi,

Dënimi: 3-7 vjet burgim dhe gjobë 4-8 milion lek.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një here, apo ka sjellë pasoja të rënda

Dënimi: 5-10 vjet burgim dhe gjobë 6-8 milion lek.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit

Dënimi: Jo më pak se 15 vjet burg ose me burgim të përjetshëm si dhe gjobë 8-10 milion lek.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik

Dënimi: Një e katërt shtesë e burgimit dhe gjobës.

Risia e këtij ndryshimi në Kodin Penal është që ndëshkon tashmë jo vetëm kalimin e paligjshëm të kufirit po edhe dhënien ndihmë për kryerjen e një veprë të tillë, si edhe ç’ka është më i rëndësishëm fakti që ndëshkimi në këtë rast shkon përtej kufijve dypalëshe, pra kalimi i paligjshëm i kufijve ndëshkohet edhe atëherë kur këta kufij janë të një shteti të tretë.

Të rëndësishme janë edhe ndryshimet e kohëve të fundit të **Kodit Penal**²² në lidhje me ***pornografinë me të mitur – Neni 117***, i cili ndëshkon përdorimin e të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarjen ose publikimin e tyre në internet apo në forma të tjera; në lidhje me ***keqtrajtimin e të miturit – Neni 124/b***, i cili ndëshkon keqtrajtimin fizik ose psikologjik të të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të, detyrimin e të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij, duke shtuar në këtë formë gamën e mbrojtjes së të miturve viktimë të krimit në përgjithësi dhe atij të trafikimit në veçanti.

²¹Miratur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin Nr. 9686, datë 26.2.2007 “Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të Ndryshuar”, Fletorja Zyrtare Nr 27, 2007.

²²Miratur rishtazi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin Nr. 9859, datë 21.1.2008 “Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të Ndryshuar” Fle-*torja Zyrtare nr. 10, 2008.

Ndryshime u hartuan dhe miratuan dhe në **Kodin e Procedurës Penale**, duke përfshirë në të përdorimin e metodave speciale të hetimit si: veprimet e simuluar – Neni 294/a, punonjësin e policisë së infiltruar – Neni 294/b, vëzhgimet, përgjimet ambientale dhe telefonike – Neni 221 etj.

- i. Dallimi mes veprave të trafikimit të personave dhe dhënies ndihme për kalim -*të paligjshëm të kufirit.

Trafikimi i personave dhe dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit janë dy vepra penale të ndryshme, kualifikimi i të cilave shpesh ngatërrohet, megjithëse kanë elementë të përbashkët.

Në tabelën më poshtë do të gjeni në mënyrë të përmbledhur elementët që bëjnë ndryshimin mes këtyre veprave penale.²³

| TRAFIKIMI I PERSONAVE | DHËNIA NDIHMË PËR KALIM TË PALIGJSHËM TË KUFIRIT |
|--|---|
| <p>Krim i kryer ndaj personit</p> <p>Kryhet, ndër të tjera, edhe nëpërmjet transportimit ndërkufitar</p> <p>Shfrytëzim i vazhdueshëm i viktimës. Marrëdhënia shfrytëzuese vazhdon për të maksimizuar përfitimet.</p> <p>Kryhet pa pëlqimin/miratimin e viktimës.</p> <p>Luftohet për të ruajtur të drejtat e njeriut</p> | <p>Krim i kryer ndaj shtetit</p> <p>Kryhet vetëm nëpërmjet transportimit ndërkufitar.</p> <p>Sigurimi i një përfitimi në këmbim të sigurimit të hyrjes se paligjshme në një shtet tjetër. Me hyrjen e emigrantit të paligjshëm në shtetin e dëshiruar, marrëdhënia kontrabandist-i kontrabanduar përfundon.</p> <p>Kryhet me vullnetin e lirë të të kontrabanduarit.</p> <p>Luftohet për të mbrojtur integritetin e kufijve shtetëror</p> |

i. Ligje dhe akte të tjera nënligjore

Përveç Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, si gurët e themelit për ndëshkimin e trafikantëve dhe në të njëjtën kohë mbrojtjen e viktimave të trafikimit, janë hartuar e miratuar një sërë ligjesh dhe

²³ ICMPD. Guidelines for the Development and Implementation of a Comprehensive National Antitrafficking Response. ICMPD, 2006.

aktesh nënligjore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi intensifikojnë luftën dhe goditjen ndaj trafikimit si fenomen dhe vepër penale, si dhe krijojnë një mburojë mbrojtëse për viktimat e trafikimit, duke u siguruar atyre mbrojtje, kompensim e siguri fizike/materiale.

Në vijim përmenden ligjet dhe aktet nënligjore më të rëndësishme në këtë fushë:

1. Me rëndësi të veçantë është miratimi i **Ligjit Nr. 9284, datë 30.09.2004** “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”²⁴, i cili synon parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe përcakton detyrat e punonjësve të policisë dhe prokurorisë nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar dhe trafiqe, si dhe kompensimin e viktimave;
2. **Ligji Nr. 9205, datë 15.03.2004**, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”²⁵, i cili synon të sigurojë deklaramë dhe dëshmi kyçe për proceset penale që lidhen me krimin e organizuar, të cilat vështirësohen për t’u siguruar nga kërcënimet dhe mungesa e garancive që shteti duhet t’u sigurojë shtetasve të tij.
3. **Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003** “Kodi i Familjes”²⁶ – i cili mbron dhe ka në konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.
4. **Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 195, datë 11.04.2007** “Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale”²⁷ – i cili përcakton qartë standardet që duhet të përmbushen nga qendrat rezidenciale që strehojnë persona të trafikuar/në rrezik trafikimi apo edhe grupe të tjera në rrezik. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta kontrollon të gjitha qendrat e licencuara prej saj në mënyrë periodike për zbatimin e këtyre standardeve.
5. **Urdhër-Shërbimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 871, datë 27.12.2007** “Për procedurat që kryhen në kufi për intervistimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera”²⁸, i cili përcakton qartë detyrat e policisë kufitare dhe asaj antitrafik në drejtim të identifikimit dhe referimit të viktimave të trafikimit, si dhe përcakton qartë pjesëmarrjen e punonjësve socialë gjatë intervistimit.

²⁴Fletorja Zyrtare nr. 79, 2004.

²⁵Fletorja Zyrtare nr. 22, 2004.

²⁶Fletorja Zyrtare nr. 49, 2003.

²⁷MPÇSSH. Standardet për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale. MPÇSSH, 2008.

²⁸Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz. Raporti i Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007. Teksti i plotë i këtij raporti gjendet në adresën: <http://www.moi.gov.al/images/pdf/buletini/RaportiVleresuesStrategjiseKombetareAntitrafikim2005-2007.pdf> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

6. **Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm, nr. 1085, datë 12.06.2006** “Për Procedurat që duhet të zbatojë Policia e Shtetit për përzgjedhjen e të huajve të parregullt”, i cili ndihmon strukturat përkatëse në identifikimin e viktimave të huaja të trafikimit dhe përbën në këtë mënyrë një masë efikase parandaluese.
7. **Ligji nr. 8610, datë 17.5.2000** “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave”²⁹, i cili përbën një mjet të fuqishëm në identifikimin e aseteve kriminale.
8. **Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006** “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”³⁰. Qëllimi i këtij ligji është të marrë disa masa parandaluese, që mund të veprojnë krahas ose duke iu paraprirë edhe masave përkatëse penale (sipas legjislacionit penal) por edhe më vete, pavarësisht në ka apo jo ndonjë proces penal të lidhur me dhunën në familje për rastin konkret. Risia e këtij ligji është mundësia e lëshimit nga gjykatat të një urdhër mbrojtjeje për viktimën, i cili mund të urdhërojë për shembull largimin e dhunuesit nga banesa, detyrimin e tij për të mos kryer më asnjë veprim që përbën dhunë në familje, ndalimin e tij për të kontaktuar me viktimën a familjarët e saj, përfshirjen e dhunuesit në programe riedukimi / rehabilitimi, etj.
9. **Marrëveshja e Bashkëpunimit për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore (MKR)** e firmosur më datë 18 Korrik, 2005. Marrëveshja është një kuadër bashkëpunimi ku përcaktohen përgjegjësitë e aktorëve kyç në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore për sa i përket identifikimit, referimit, akomodimit, asistencës dhe rehabilitimit të viktimave të trafikimit. Në thelb, MKR-ja është një sistem, një rrjet i ngritur mes policisë, shërbimit social, shërbimit diplomatik dhe konsullor, si dhe qendrave pritëse dhe rehabilituese për viktimat e trafikimit.
10. **Memorandumi i Mirëkuptimit** ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Europë në Shqipëri (OSCE) **për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm**, si një mjet për të luftuar trafikimin e fëmijëve në vend.³¹

²⁹Fletorja Zyrtare nr. 14, 2000.

³⁰Fletorja Zyrtare nr. 150, 2006.

³¹Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz. Raporti i Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007. Teksti i plotë i këtij raporti gjendet në adresën: <http://www.moi.gov.al/images/pdf/buletini/RaportiVleresuesStrategjiseKombetareAntitrafikim2005-2007.pdf> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

KORNIZA INSTITUCIONALE

Për të kuptuar se si funksionon rrjeti, ose më saktë sistemi i identifikimit, referimit, mbrojtjes dhe asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, duhet të kemi një tablo të qartë të strukturave përbërëse të këtij sistemi; struktura të përfshira në parandalimin dhe goditjen e trafikimit si fenomen dhe si veprë penale, si edhe struktura të cilat ofrojnë shërbime ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

Nëse do të flisnim për strukturat e përfshira në përpjekjet për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, do t'i ndanim në struktura në nivel qendror dhe struktura në nivel vendor.

NË NIVEL QENDROR

Struktura në nivelin më të lartë politikëbërës është **Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore**, ngritur në vitin 2002, i ndryshuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 653, datë 17.10.2005, i cili kryesohet nga Ministri i Brendshëm. Komiteti përbëhet nga Zëvendësministri i Brendshëm, i Drejtësisë, i Punëve të Jashtme, i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i Financave, i Arsimit dhe Shkencës, i Mbrojtjes, Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe SHISH-it, të cilët janë përgjegjës edhe për parandalimin dhe luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore në fushat përkatëse.

Ky Komitet mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj, analizon raportet për punën e kryer nga çdo institucion shtetëror dhe institucione të tjera për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në strategjinë kombëtare të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore, si dhe rekomandon zgjidhjet e mundshme për problemet e ndryshme dhe raporton periodikisht tek Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave. Në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore ftohen të marrin pjesë përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, të sistemit gjyqësor dhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe OJF-të vendase dhe të huaja që veprojnë në Shqipëri³².

Struktura që koordinon të gjitha përpjekjet antitrafik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe monitoron zbatimin e Strategjisë Kombëtare Antitrafik është **Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore / Zëvendësministri i Brendshëm**, ngritur në Nëntor të vitit 2005. Kjo është hera e parë që Shqipëria ka një zyrë me një mandat ekskluziv për antitrafikimin.

³²Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 05.01.2002 "Për Krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore" ndryshuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 653, datë 17.10.2005 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 8, datë 05.01.2002 "Për Krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore", të ndryshuar".

Zyra e Koordinatorit Kombëtar ka mandat të gjerë politik dhe nivel të lartë pavarësie në marrjen e iniciativave të nevojshme në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Autonomia e saj bazohet në një Urdhër të Kryeministrit.³³

Me urdhër të Kryeministrit, nr. 203, datë 19.12.2005, “Për mënyrën e Funkcionimit të Njesisë Antitrafik” u ngrit **Njësia Antitrafik**³⁴. Sipas këtij Urdhri, Njësia Antitrafik funksionon pranë Ministrisë së Brendshme, si pjesë organike e saj, dhe në ushtrimin e funksioneve të saj drejtohet nga **Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore/ Zëvendësministri i Brendshëm**. Misioni i kësaj Njësie është monitorimi dhe koordinimi i veprimeve të të gjitha strukturave dhe aktorëve të tjerë publikë shtetërorë dhe jo-shtetëror për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore. Njësia Antitrafik përgatit raporte periodike për situatën e trafikimit në Shqipëri dhe kryen rolin e Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror (Ndërministror) të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Duke iu referuar Mekanizmit Kombëtar të Referimit, të shtjelluar më lart, në zbatim të tij, në vitin 2006 është ngritur **Autoriteti Përgjegjës**³⁵. Ky Autoritet Përgjegjës është ngritur me një urdhër të përbashkët të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me qëllim bashkërendimin e procesit të referimit për ndihmë dhe mbrojtje fillestare dhe rehabilitimin afatgjatë të viktimave të trafikimit. Autoriteti Përgjegjës është një bërthamë personash nga tre agjencitë e përfshira, në funksion të drejtpërdrejtë të identifikimit, hetimit, referimit, mbrojtjes dhe asistencës ndaj viktimave të trafikimit.³⁶ Është pikërisht ky organ, i cili operon dhe administron **bazën e të dhënave për viktimat e trafikimit**, një program i instaluar në mënyrë të integruar në sistemin ekzistues TIMS (Total Information Management System), i cili do të bëjë të mundur unifikimin e të dhënave dhe ndjekjen e rasteve të trafikimit që prej identifikimit fillestar e deri tek riintegrimi i plotë i viktimave të trafikimit në jetën sociale.³⁷

³³Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz. Raporti i Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007. Teksti i plotë i këtij raporti gjendet në adresën: <http://www.moi.gov.al/images/pdf/buletini/RaportiVleresuesStrategjiseKombetareAntitrafikim2005-2007.pdf> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

³⁴Urdhër i Kryeministrit nr. 203, datë 19.12.2005 “Për mënyrën e funksionimit të Njesisë Antitrafik”.

³⁵Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz. Raporti i Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007. Teksti i plotë i këtij raporti gjendet në adresën: <http://www.moi.gov.al/images/pdf/buletini/RaportiVleresuesStrategjiseKombetareAntitrafikim2005-2007.pdf> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

³⁶Po aty.

³⁷Po aty.

Në vijim të strukturave të rëndësishme në zinxhirin e luftës kundër trafikimit në njerëz nuk mund të lemë kurrsesi pa përmendur një fakt të rëndësishëm siç është edhe ngritja e **Gjykatës për Krime të Rënda, si dhe e Prokurorisë për Krime të Rënda** në vitin 2004, të cilat janë pajisur me elementet e duhur teknike për mbrojtjen dhe sigurinë e nevojshme për viktimat e trafikut që dëshmojnë gjatë një procesi gjyqësor.

Një strukturë tepër e rëndësishme në procesin e ndjekjes penale është **Policia e Shtetit** me Drejtorinë kundër Krimin të Organizuar. Në këtë drejtori ka një sektor të veçantë që merret me luftën kundër trafikëve të paligjshme, ku i kushtohet vëmendje e veçantë trafikimit të qenieve njerëzore. E rëndësishme për t'u theksuar është fakti që struktura të tilla janë të pranishme në çdo drejtori qarku, të cilat, sipas edhe Urdhër-Shërbimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit³⁸, duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me punonjësit socialë, për t'i ofruar viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit të gjithë asistencën dhe shërbimet për të cilat ka nevojë.

Në të njëjtën kohë, në zbatim të Ligjit mbi Mbrojtjen e Dëshmitarit, në vitin 2007, me miratimin e strukturës së re të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit u ngrit **Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Personave të Veçantë**, e cila siguron mbrojtje për një gamë të gjerë personash, si: dëshmitarë të drejtësisë, bashkëpunëtorë të drejtësisë, si edhe persona të afërt apo të lidhur me ta. Zbatimi i masave të mbrojtjes bëhet për krime të rënda dhe vetëm në ato raste kur personat ndodhen në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz për jetën.

NË NIVEL VENDOR

Për të decentralizuar në nivel qarku sistemin e identifikimit, referimit dhe asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, me Urdhër Nr. 139, datë 19.06.2006 "Për Krijimin e **Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikut në Njerëz**", u ngritën Komitetet Rajonale Antitrafik në 12 qarqet e vendit. Këto Komitete drejtohen nga Prefekti i qarkut dhe anëtarë të tij janë Kryetari i Bashkisë Qendër në Qark, Drejtori i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtori Rajonal i Punësimit, Drejtori i Drejtorisë së Policisë në Qark, Drejtori Rajonal i Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtori Rajonal i Drejtorisë Arsimore si dhe Drejtori i Drejtorisë së Shëndetit Publik. Në këto komitete janë gjithashtu të ftuar të marrin pjesë edhe Prokurori i Rrethit si dhe përfaqësues të shoqërisë civile në nivel lokal.

³⁸Urdhër-Shërbim i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 871, datë 27.12.2007 "Mbi procedurat që duhet të kryhen për intervistimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera".

Komitetet kanë edhe një grup pune në nivel teknik “**Tryeza Teknike Antitrafik**”, me përfaqësues të të gjitha strukturave të përfshira në Komitet (*drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror; drejtoritë rajonale të punës; zyrat e përkujdesjes shoqërore, në bashki/komunë; Shefi i sektorit antitrafik të policisë së qarkut, drejtoritë rajonale të SHISH-it; drejtoritë rajonale arsimore; Inspektori i shëndetit riprodhues (nëna dhe fëmija); përfaqësues i prokurorisë së qarkut; përfaqësues të OJF-ve*). Këto komitete duhet të funksionojnë si një MKR në qarkun përkatës, pasi në përbërjen e tyre janë të gjithë aktorët e nevojshëm dhe të duhur për të bërë të mundur parandalimin e fenomenit në fjalë, qoftë edhe goditjen e tij. Megjithëse një pjesë e mirë e tyre kanë funksionuar, një punë më e mirë duhet të bëhet për të përcaktuar kategoritë e rrezikuara, ngritjen e rrjeteve mbrojtëse për to, sidomos të fëmijëve dhe mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit nëpërmjet institucioneve lokale në nivel qarku.³⁹

Struktura të tjera të përfshira në asistencën e dhënë ndaj viktimave të trafikimit

Në Marrëveshjen e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, përveç strukturave të zbatimit të ligjit dhe atyre të përfshira në parandalimin e fenomenit, janë palë edhe qendrat pritëse dhe rehabilituese për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, si struktura kyçe, pa të cilat sistemi nuk funksionon. Këto qendra janë të licencuara nga MPÇSSHB-ja dhe monitorohen për zbatimin e standardeve të miratuara me VKM-ja në vitin 2007.⁴⁰

Sipas Raportit Vlerësues 2005-2007, të hartuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz, Marrëveshja e MKR-së është e hapur për t’u zgjeruar me aktorë të rinj, të cilët mund të mos jenë domosdoshmërisht qendra rehabilituese apo integruese, por mund të jenë organizata, të cilat ofrojnë shërbime të caktuara për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, siç mund të jetë shërbimi ligjor falas, etj. Një koalicion tepër i rëndësishëm në këtë drejtim, një ombrellë e një sërë organizatash që ofrojnë shërbime të ndryshme për këtë kategori kaq të rrezikuar është edhe BKTF – Bashkë kundër Trafikimit të Fëmijëve.⁴¹

³⁹Për më shumë informacion, shih Raportin e Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007, hartuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz, si dhe The State of Efforts to Combat Trafficking of Persons in Albania – August 2006 – July 2007, CAAHT: www.CAAHT.com [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

⁴⁰Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 11.04.2007 “Për Miratimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, në Qendrat Rezidenciale për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimit”.

⁴¹Për më shumë informacion rreth këtij koalicioni, partnerëve dhe dokumenteve apo fushatave të organizuara, shih faqen zyrtare të internetit www.bktf-coalition.org [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

2

*Identifikimi dhe
referimi i
viktimave të
trafikimit*

2.1 FORMAT E FENOMENIT TË TRAFIKIMIT, SHKAQET DHE PASOJAT

2.1.1 PËRMASAT, FORMAT DHE SHKAQET E LIDHURA ME TRAFIKIMIN

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore kërkon domosdoshmërisht pranimin se ky krim nuk kursen shtete (është krim nacional dhe trans-nacional), shoqëri apo edhe individë. Kjo luftë kërkon njohjen e veçantive të krimit të trafikimit, mënyrat dhe përmasat në të cilat ai ndikon individin, shoqërinë dhe kushtet social- ekonomike dhe gjeo-politike në të cilat ky krim mund të rritet dhe harliset.

Trafikimi i njerëzve është një kërcënim shumë-dimensional; ai i privon njerëzit prej të drejtave dhe lirive njerëzore, është një rrezik global për shëndetin dhe ushqen rritjen e krimit të organizuar. Trafikimi i njerëzve ka një efekt shkatërrues në individët viktimë të trafikimit, të cilët shpesh vuajnë abuzime fizike dhe emocionale, përdhunim, kërcënime ndaj atyre vetë apo familjarëve të tyre, vjedhje të pasaportave, deri edhe vdekje. Por efekti i trafikimit të njerëzve shkon përtej viktimave individuale; ai minon shëndetin dhe sigurinë e të gjitha kombeve që ai prek.⁴²

Strategjitë e fshehjes që përdorin trafikantët, perspektivat e konceptet e ndryshme mbi këtë krim, ndryshueshmëria e vazhdueshme e formave të shfrytëzimit me qëllim rritjen e përfitimit nga ana e trafikantëve, mungesa e monitorimit të duhur të zonave ku ndodh shfrytëzimi e shumë arsye të tjera e bëjnë të vështirë matjen e trafikimit. Gjithsesi, në 2005, raporti mbi trafikimin e personave i Shteteve të Bashkuara shkruante që rreth 600,000 deri 800,000 persona trafikoheshin nëpërmjet kufijve në të gjithë botën (pa marrë parasysh trafikimin e brendshëm në shtete të ndryshme).⁴³

Gjykimi mbi situatën e trafikimit në Shqipëri në mungesë të një baze të dhënash zyrtare bëhet kryesisht mbi bazën e numrit të viktimave të asistuar dhe atyre që bashkëpunojnë me autoritetet e ligjit. Raportimet më të fundit vijnë nga policia dhe nga organizatat apo institucionet shtetërore të cilat ofrojnë shërbime pritjeje, rehabilitimi dhe riintegrimi për viktimat e trafikimit. Kështu, në raportin e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz⁴⁴ përmendet që për vitin 2007, Sektori Kundër Trafikeve të Paligjshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka raportuar 20 viktimë

⁴²U.S. State Department. Office to Monitor and Combat Trafficking in Persons. Facts About Human Trafficking. <http://www.state.gov/g/tip/rls/fs/2005/60840.htm> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

⁴³U.S. State Department. Trafficking in Persons Report: June 2005. United States Department of State, Washington DC, 2005

⁴⁴Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz. Raporti i Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007. Teksti i plotë i këtij raporti gjendet në adresën: <http://www.moi.gov.al/images/pdf/buletini/RaportiVleresuesStrategjiseKombetareAntitrafikim2005-2007.pdf> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

të trafikimit, prej të cilave 13 janë gra dhe 7 janë fëmijë, Qendra Kombëtare e Pritjes për Viktimat e Trafikimit ka akomoduar në vitin 2007 85 viktime trafikimi, 55 prej të cilave kanë qenë referuar gjatë atij viti ndërsa 30 raste kanë qenë akomoduar aty qysh prej viteve të mëparshme. Qendra Psikosociale “Vatra” ka raportuar tek Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Antitrafikimin se në periudhën 2005-2007 ka akomoduar dhe asistuar 380 gra të trafikuar dhe 69 në rrezik trafikimi, ndërsa “Të ndryshëm & Të barabartë” ka raportuar se ka asistuar për periudhën 2005-2007 100 gra të trafikuar dhe 27 fëmijë të përfituesve të programit.

Me iniciativën e Koordinatorit Kombëtar për Antitrafikimin, në Shqipëri po bëhen përpjekje për të finalizuar krijimin dhe aktivizimin e një baze të dhënash për viktimat e trafikimit që duhet të referohen dhe vendosen në mbrojtjen e Autoritetit Përgjegjës. Ky sistem do të bëjë të mundur që përgjegjës të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të regjistrojnë të gjitha rastet e viktimave që janë kthyer, referuar dhe mbrojtur në Shqipëri dhe të kenë një pamje të plotë për fenomenin.⁴⁵

Tre elementët e ndërvarur të krimit të trafikimit të përcaktuara nga Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore janë optika bazë e të vlerësuarit të trafikimit si fenomen.⁴⁶

Kështu ndër mënyrat më të hasura të trafikantëve për të rekrutuar viktimat e trafikimit femra në Shqipëri vazhduan të ishin premtimet false për martesë apo marrëdhëniet romantike false për t'i tërhequr viktimat jashtë shtetit për shfrytëzim seksual.⁴⁷

Për sa i përket formave të shfrytëzimit, sipas Raportit të Zyrës për Demokraci, Të drejtat e Njeriut dhe Punës së Departamentit Amerikan të Shtetit Për Praktikimin e të Drejtave të Njeriut, “*Shqipëria mbetet një vend origjine për trafikimin e grave dhe fëmijëve për qëllimin e shfrytëzimit seksual dhe punës së detyruar edhe pse më pak se në vitet e tjera*”.

Duhet përmendur gjithsesi që forma më e studiuar dhe e evidentuar e trafikimit është trafikimi i femrave dhe fëmijëve me qëllim shfrytëzimin seksual dhe akoma pak ose aspak nuk është bërë për studimin e formave të tjera të shfrytëzimit.

⁴⁵Shih me sipër në Kapitullin I.

⁴⁶Referoju përcaktimit në Kapitullin I.

⁴⁷U.S. Department of State. Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor. Country Reports on Human Rights Practices 2007. <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2007/100544.htm> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

Rrugët e lëvizjes së viktimave janë një optikë tjetër e përdorur për të vlerësuar dhe luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Është e rëndësishme të përmendet që lëvizja e viktimës për qëllim shfrytëzimi mund të ndodhë si brenda vendit, pa kaluar kufij shtetërore, gjë së cilës i referohen si *trafikim i brendshëm*, ashtu edhe nga një shtet në shtetin tjetër, kalim të cilin trafikantët e kryejnë qoftë si kalim i ligjshëm, të rregullt, apo si kalim të paligjshëm, të parregullt të kufirit.

Po sipas Raportit të Zyrës për Demokraci, Të Drejtat e Njeriut dhe Punës së Departamentit Amerikan të Shtetit Për Praktikimin e të Drejtave të Njeriut “*Trafikantët i trafikojnë brenda për brenda fëmijët nga të gjitha rajonet e vendit dhe në mënyre tipike i trafikojnë ata për në Tiranë ose Durrës.*” Sipas Terre des Hommes (TdH), numri i fëmijëve të trafikuar brenda për brenda, sidomos të komunitetit Rom dhe Egjiptianëve të Ballkanit është rritur gjatë vitit 2007. Trafikimi i fëmijëve për në Kosovë dhe Greqi për lypje apo shfrytëzim seksual vazhdoi të jetë një problem edhe pse numri i rasteve të raportuar është ulur. Policia dhe përfaqësuesit e strehëzave vazhduan të raportonin prirjen për lëvizjen e femrave nga fshatrat dhe qytetet më të vogla në qytete më të mëdha për prostitucion të detyruar në hotele dhe shtëpi private. Disa prej këtyre vajzave dhe grave janë lëvizur jashtë Shqipërisë për shfrytëzim seksual në vende të tjera europiane. Gjatë vitit 2007, TdH dhe ARSIS kanë identifikuar 337 fëmijë shqiptarë në Selanik dhe Athinë (Greqi) si viktime trafikimi”.⁴⁸

Një klasifikim tjetër shumë i njohur i lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore është edhe klasifikimi i shteteve si shtete origjine, tranziti dhe destinacioni. Me fjalë të thjeshta, vendi/shteti i origjinës është vendi ku trafikantët i rekrutojnë viktimat e tyre, ose ndryshe vendi i burimit. Vendet/shtetet nëpërmjet të cilave trafikantët i kalojnë viktimat e trafikimit dhe ku shpesh i venë edhe të punojnë për njëfarë kohe quhen vende tranziti. Si vende tranziti, zakonisht trafikantët zgjedhin vendet që ndodhen pranë një porti apo kufiri për në vendin e destinacionit, ku ka korrupsion në radhët e zyrtarëve të migracionit, apo ku ka baza të grupeve kriminale të organizuara. Vendet e destinacionit janë zakonisht vendet e pasura ku merren e shfrytëzohen viktimat e trafikimit.

Për vitin 2007, Shqipëria konsiderohet se “*mbetet një vend burimi/origjine për trafikimin e fëmijëve dhe grave për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe punës së detyruar, megjithëse më pak se vitet e fundit.*”⁴⁹ Një optikë tjetër e vështrimit të trafikimit është ajo e migrimit. Anti-Slavery International raporton se “*Pjesa më e madhe e njerëzve të trafikuar janë punëtorët emigrantë*”.⁵⁰ Në kontekstin e emigrimit,

⁴⁸U.S. Department of State. Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor. Country Reports on Human Rights Practices 2007. <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2007/100544.htm> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

⁴⁹Po aty.

⁵⁰Anti-Slavery International. The migration-trafficking Nexus. Combating Trafficking through the protection of migrant's rights. London: The printed Word. 2003.

trafikimi shpjegohet si shfrytëzim për përfitim nga ana e trafikantëve e të ashtuquajturve faktorë “shtytës” dhe “tërheqës” për migrim. Faktorët shtytës ose të lidhur me vendin e origjinës janë ato që i bëjnë njerëzit të migrojnë dhe këta janë ndër të tjera nevoja për mundësi më të mira, për të ikur nga situata abuzimi dhe dhune, persekutimi, diskriminimi, varfëria, fatkeqësitë natyrore, dhunimi i të drejtave të njeriut, mungesa e punësimit dhe e mjeteve të jetesës. Faktorët tërheqës ose faktorët e vendit të destinacionit janë ndër të tjera kërkesa për krah të lirë pune të llojeve të ndryshme, në mënyrë të veçantë në industrinë e seksit, punë shtëpie apo pune te pista, të vështira e të rrezikshme për të cilat do të kushtonte shumë më tepër të punësohej një vendas.

Mungesa e mundësive për emigrim të rregullt për të zënë punë në një vend tjetër dhe fakti që shumë emigrantë e shikojnë punën jashtë shtetit si një mënyre mbijetese më shumë sesa një mënyrë për të përmirësuar standardin e jetesës, i ka lënë emigrantët me shumë pak zgjedhje përveçse të mbështeten tek kontrabandistët apo trafikantët për të arritur të gjejnë punë.⁵¹

2.1.2 PASOJAT E TRAFIKIMIT

Pasojat e trafikimit janë të ndryshme e të shumta. Në radhë të parë ato janë pasoja mbi viktimën por edhe mbi shoqërinë në vendet/shtetet ku ndodh fenomeni i trafikimit, pavarësisht mënyrave të ndryshme. Për viktimat, pasoja e parë kryesore është shkelja e rëndë e të drejtave të njeriut. Viktimat janë të ekspozuara çdo ditë ndaj shtrëngimit, abuzimit dhe dhunës. Ato trajtohen shpesh si kriminele nga autoritetet në vendet e tranzitit dhe të destinacionit për shkak të statusit të tyre të parregullt në këto vende, si dhe për shkak të statusit të tyre si punëtore në të zezë apo si punëtore të seksit. Në etapa të ndryshme të procesit të trafikimit, viktimat janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të shumta e të ndryshme, ata përfshijnë dhunë fizike, shfrytëzim seksual, abuzime psikologjike, kushte të këqija jetese, sëmundje të shumta të cilat dëmtojnë dhe lenë pasojat mbi shëndetin e tyre fizik, mendor dhe riprodhues.

Pasojat janë po ashtu të rënda për vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit. Një nga pasojat është rritja e emigrimit të parregullt në vendet e tranzitit dhe destinacionit. Një pasojë tjetër është prezenca e organizatave kriminale të përfshira në shpërndarje droge, vjedhje, shfrytëzim të prostitucionit dhe forma të tjera dhune.⁵²

Ato që do të merren në shqyrtim më poshtë, për të ruajtur fokusin dhe qëllimin e këtij doracakut, janë pasojat që trafikimi ka mbi vetë viktimën.

Literatura që evidenton problemet e shëndetit të lidhura me trafikimin është e pakët, por për të

⁵¹Anti-Slavery International. The migration-trafficking Nexus. Combating Trafficking through the protection of migrant's rights. London: The printed Word. 2003.

⁵²IOM. Consequences of Trafficking and Policy Responses. <http://www.iom.int/jahia/Jahia/pid/677> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

kuptuar pasojat që le trafikimi mbi shëndetin e viktimave dhe për të planifikuar dhe zbatuar trajtimin e problemeve të shëndetit të viktimave studiuesit sugjerojnë referimin tek grupet e tjera të marginalizuara me eksperiencë të ngjashme, siç janë emigrantët dhe refugjatët, personat që kanë përjetuar dhunë, abuzim seksual, abuzim fizik dhe ose seksual në fëmijëri, prostitutat dhe punëtorët e shfrytëzuar, si edhe marrjen në konsideratë të eksperiencave të dhunës në faza të ndryshme të trafikimit.⁵³

Etapa para nisjes ka të bëjë me gjendjen shëndetësore fizike dhe mendore të personit para lëvizjes/zhvendosjes së trafikimit. Shumë prej viktimave vijnë prej vendeve e apo zonave me sistem shëndetësor të mangët, mund të mos kenë pasur asnjëherë akses në shërbime shëndetësore, nuk kanë qenë diagnostikuar dhe kuruar si duhet, e si rrjedhim kjo i bën ata lehtësisht të cenueshëm fizikisht dhe mendërisht nga trafikimi.

Etapa e udhëtimit dhe tranzitit përfshin periudhën e rekrutimit të personit deri në mbërritjen në destinacion. Kjo etapë karakterizohet nga eksperiencë tepër të rrezikshme për shëndetin dhe jetën, siç është kalimi i paligjshëm i kufirit, mënyra transportimi të rrezikshme, por sidomos karakterizohet nga trauma e të kuptuarit të mashtrimit, përdhunimeve, dhunës fizike, humbjes së kontrollit dhe rrezikut të lartë për jetën.

Etapa e destinacionit është etapa e shfrytëzimit maksimal, punës së rëndë pa mundësi kurimi apo ndihme mjekësore. Në shumë raste viktimat mundohen të kurohen vetë me mjete rrethanore e metoda të mësuara apo të detyruara nga trafikantët, duke rezultuar kështu në infeksione, ndërlikime dhe dëmtime të shumta.

Etapa e ndalimit, deportimit dhe e dhënies së dëshmvive është etapa kur zakonisht kalohet në qendra ndalimi me kushte të këqija, në gjendje ankthi, frike dhe presioni psikologjik të vazhdueshëm. Edhe në rastet kur viktimat identifikohen si e tillë dhe bashkëpunon me autoritetet, ka raste kur fokusi është marrja e dëshmisë e nuk merren masa për të mbrojtur shëndetin mendor të viktimës.

Etapa e integritimit dhe e riintegritimit është periudha në të cilën personat e trafikuar shpesh jetojnë të izoluar, kanë frikën se mos paragjykohen dhe në të vërtetë paragjykohen, kanë ndjenja turpi ndaj vetes dhe të tjerëve, kanë vështirësi komunikimi, riaktivizojnë ose krijojnë sjellje të rrezikshme për të përballuar gjendjen, si për shembull pinë duhan, alkool, marrin drogë etj.⁵⁴

Për të kuptuar pasojat që ka trafikimi mbi shëndetin mendor të viktimave është e rëndësishme të kuptohen edhe taktikat e kontrollit që përdorin trafikantët, të cilat janë të ngjashme me ato të

⁵³Zimmerman, C., Yun, K., Shvab, I., et al. Health risks and consequences of trafficking in women and adolescents. Findings from a European study. London School of Hygiene and Tropical, 2003.

⁵⁴Zimmerman, C., Yun, K., Shvab, I., et al. Health risks and consequences of trafficking in women and adolescents. Findings from a European study. London School of Hygiene and Tropical, 2003.

torturuesve, të personave që ushtrojnë dhunë në familje ose që keqtrajtojnë fëmijë.⁵⁵ Qëllimi i këtyre formave të dhunës, të detyrimit dhe të manipulimit psikologjik, është vënia e personit në varësi dhe robëri, duke i shkatërruar besimin që ka te vetja dhe te lidhjet me të tjerët.

Taktikat e përdorura nga trafikantët për t'i mbajtur viktimat në kontroll të përhershëm janë:

Frikësimi dhe terrorizimi: trafikantët i mbajnë viktimat në frikë të vazhdueshme për jetën e vet dhe të të afërmeve të tyre.

Krijimi i kushteve të paparashikueshme dhe të pakontrollueshme të jetesës: trafikantët u ndryshojnë viktimave pa paralajmërim vendin e banimit, ambientin, njerëzit me të cilët kanë filluar të mbështeten e të besojnë, vetë identitetin e tyre. Në këtë mënyrë u nxjerrin jashtë përdorimit strategjitë e kontrollit mbi situatën dhe i bëjnë të adaptojnë strategji të mbijetesës.

Eliminimi i të gjitha mundësive për të marrë vendime: trafikantët nuk i lenë viktimat të marrin vendime, me qëllimin për të krijuar një ndjenjë që mirëqenia ose edhe vetë mbijetesja e personit varet nga dëshira e trafikantit dhe është gjithnjë në dorë të tij.

Gënjeshtria dhe mashtrimi: për të dëmtuar imazhin që kanë te vetja dhe të kuptuarit e botës përreth.

Manipulimi emocional: Trafikantët përpiqen të manipulojnë ndjenjat e viktimave, p.sh., duke i mbajtur në kontroll dhe partneritet intim, duke i bindur viktimat se i dashurojnë në mënyrën e tyre, apo se puna do t'u japë mundësinë të dërgojnë më shumë para në shtëpi te pjesëtarët e familjes, do t'i ndihmojë të plotësojnë ëndrrat e aspiratat e veta për një jetë më të mirë.

Situatat fizike dhe psikologjike në të cilat trafikantët e venë viktimën përshkruhen në faza si:

Faza e *“kushteve të skajshme të mbijetesës”*, në të cilën viktimat detyrohet të përballet me mundësinë shumë reale të vdekjes. Kriminelit i bën të ditur personit që ai/ajo nuk e ka më në dorë sigurinë e tij/saj; tashmë atë e kontrollon vetëm ai.

Faza e *“rraskapitjes fizike”*. Viktimat detyrohen të punojnë për orë të zgjatura, pa pushim, duke u çlodhur shumë pak, çka i bën kriminelët të kenë një kontroll pothuaj absolut mbi to. Duke mos pasur kohë për të marrë veten, njerëzit rraskapiten, nuk mund të mendojnë për strategji vetëmbrojtjeje dhe fokusohen vetëm te përgjigjja e duhur ndaj komandave dhe kërcënimeve të perceptuara të momentit.

Faza e *“kontrollit dhe izolimit”*. Kontakti i vetëm i qenësishëm i viktimës është ai me trafikuesin dhe perceptimi i botës dhe i vetvetes reflektohen nëpërmjet ndërtimit të shtrembëruar që i bën trafikanti botës. Në këtë mënyrë, personi nuk është më i njëjti, ai është thjesht një pasqyrim i kërkesave të trafikantit.⁵⁶

⁵⁵Zimmerman, C. Trafficking in women: Conceptualizing and measuring health risks and consequences. Dissertation for PhD. London School of Hygiene and Tropical Medicine, 2004.

⁵⁶Tchomarova, M. Trafficking in women – personal, psychological and social problems in (non)-united Europe. Sofia: Animus Association Foundation, 2001.

Reagimet e shumë personave të trafikuar ndaj përvojës së trafikimit janë përgjigje psikologjike dhe fiziologjike ose mekanizma përballimi, për të cilat personi shpesh nuk është as i ndërgjegjshëm as nuk i ka nën kontroll.

Si pasojë e këtyre eksperiencave, në kontaktet me ofruesit e shërbimeve, viktimat e trafikimit shfaqin frikë, pasiguri, ankth, mosbesim te të tjerët dhe mosbesim te vetja, vetëvlerësim të ulët, vetëqortim, ndjenjë faji, turp, zemërim ndaj vetes ose të tjerëve lajthitje të kujtesës, shkëputje idesh, izolim, vetmi, varësi, përrulje ose vetëmbrojtje.⁵⁷

Fëmijët e trafikuar ndodhen në një mjedis me kërcënime dhe rreziqe të vazhdueshme. Keqtrajtimi dhe stresi i vazhdueshëm ndikojnë fizikisht te fëmija, pengojnë procesin e të nxënimit, vonojnë rritjen dhe zhvillimin psikologjik.⁵⁸ Përballë këtij lloji abuzimi dhe stresi të vazhdueshëm, fëmijët dhe adoleshentët zhvillojnë një personalitet që i përshtatet mbijetesës, por që nuk funksionon mirë në situata normale jokërcënuese. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, fëmijët e abuzuar shpesh ndihen të detyruar të lidhin marrëdhënie dhe të krijojnë besim te kujdestarët, të cilët mund të jenë të rrezikshëm. Fëmijët e keqtrajtuar mund të kenë probleme në përballimin ose në zhvillimin e autonomisë dhe intimitetit. Meqë besojnë se të rriturit kujdesen për ta dhe i dinë gjërat më mirë, fëmijët shpesh kujtojnë se ka diçka që nuk shkon tek ta dhe që rrjedhimisht janë ata përgjegjës për të këqijat që iu kanë ndodhur dhe veprimet e gabuara që kanë kryer ata vetë. Efektet që ka keqtrajtimi në zhvillim mund të karakterizohen me distancim, ulje të respektit për veten dhe me më pak marrëdhënie shoqërore. Mund të shfaqen edhe probleme të një sjelljeje hiperseksuale ose agresive, përdorim substancash, shkëputje nga marrëdhëniet shoqërore, vetëlëndim ose mënyra të tjera mos funksionuese për përballimin e stresit dhe të ankthit.⁵⁹

Njëllloj si të rriturit e trafikuar, me disa fëmijë mund të jetë abuzuar seksualisht para ose gjatë përvojës së trafikimit, ose gjatë të dyjave. Pasi vendosen në kushte trafikimi, abuzimi dhe shfrytëzimi seksual i fëmijëve bëhet gjë e zakonshme edhe për fëmijët që nuk punojnë në prostitucion.

Abuzimi seksual i fëmijëve sjell pasoja të dëmshme shëndetësore, të menjëhershme dhe afatgjata, dhe përfshin infeksionet seksualisht të transmetueshme, dëmtimin e organeve gjentiale, rreziqet seksuale dhe abuzimin me substancat në të ardhmen, vështirësi në krijimin e marrëdhënieve seksuale të shëndosha, depresion dhe vetëvrasje.⁶⁰ Abuzimi seksual ndikon në mënyrën se si fëmijët, sidomos

⁵⁷Zimmerman, C. Trafficking in women: Conceptualizing and measuring health risks and consequences. Dissertation for PhD. London School of Hygiene and Tropical Medicine, 2004.

⁵⁸World Health Organization. A critical link. Interventions for physical growth and psychological developments: A review. 2003. www.who.int/child-adolescent-health/ [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

⁵⁹World Health Organization. Child abuse and neglect. Fact sheet N150, 1997. <http://www.who.int/inf-fs/en/fact150.html> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

⁶⁰Zickler, P. Childhood sex abuse increases risk for drug dependence in adult women. Research Findings. National Institute of Drug Abuse. NIDA Notes Vol.17, No. 1, 2002. <http://www.nida.nih.gov/NIDA/NNVol17N1/Childhood.html> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

paraadoleshentët dhe adoleshentët, konceptojnë trupin e tyre, vlerën e tyre dhe marrëdhëniet e tyre me të tjerët. Për adoleshentët që janë ende duke zbuluar dhe zhvilluar të kuptuarit dhe sjelljet për gjininë dhe seksualitetin e tyre, prezantimi i dhunshëm dhe me detyrim me seksin dhe marrëdhëniet seksuale krijon modele të gabuara për marrëdhënie dhe praktika të dëmshme në të ardhmen.⁶¹

2.2 Procesi i identifikimit të një viktime trafikimi

2.2.1 PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM IDENTIFIKIMI I VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT?

“Të drejtat e njeriut të viktimave të trafikimit duhet të jenë në qendër të përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar trafikimin dhe mbrojtjen, asistencën dhe sigurimin e kompensimit të viktimave”.⁶² Identifikimi është shumë i rëndësishëm për të ndaluar shkeljen e mëtejshme të të drejtave dhe viktimizimin e mëtejshëm të viktimave të trafikimit e në shumë raste për të ndaluar viktimizimin nga vetë autoritetet e ligjit dhe strukturave që priten të mbrojnë viktimat. Në shumë vende të destinacionit “viktimat e trafikimit mund të merren gabimisht për emigrantë të parregullt dhe të deportohen ose të futen në qendra ndalimi”.⁶³ Komisionari i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut e konsideron dështimin në identifikimin e shpejtë të një viktime trafikimi si “një shkelje të mëtejshme e të drejtave të njeriut të këtij personi”.⁶⁴

Një nga përkufizimet e procesit të identifikimit jepet nga La Strada: “Identifikimi i personave të trafikuar konsiderohet një tërësi veprimesh nëpërmjet të cilave, punonjësi i policisë, bazuar në informacionet e mbledhura nga viktimat e supozuar të trafikimit apo nga persona fizikë/juridikë, të cilët kanë informacion mbi veprimet e paligjshme të ushtruara mbi personin në fjalë, është në gjendje të kryejë një analizë mbi informacionin e mbledhur, të krahasojë të dhënat e krimit të ndodhur me elementet e përkufizimit të veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe arrin në konkluzionin se personi është viktimë e trafikimit. Identifikimi i personave të trafikuar ka si qëllim garantimin e aksesit të një pakete në minimum të ndihmës së nevojshme falas, masa e së cilës përcaktohet nga një legjislacion efektiv”.⁶⁵

⁶¹World Health Organization. Sexual relationship violence in adolescents: A review on the impact of sexual relationship violence on health and opportunities for prevention. Draft. 2003. <http://www.who.int> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

⁶²OSBE/ODIHR. Mekanizmat Kombëtare të Referimit. Bashkimi i përpjekjeve për mbrojtje të të drejtave të personave të trafikuar. Manual Praktik. 2006.

⁶³IOM. Manuali i IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Tiranë, 2007.

⁶⁴UNHRC. Raport i Komisionerit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Parime dhe Udhëzime mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore. 2002.

⁶⁵International Centre for Women’s Rights Protection and Promotion. Identification of Trafficked Persons in Moldova. La Strada. 2006.

Identifikimi i krimit të trafikimit është i rëndësishëm për faktin se vetëm nëpërmjet identifikimit mund të fillojë mbrojtja e viktimave dhe trajtimi i pasojave të krimit në shëndetin e tyre. Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e pasojave të trafikimit mbi shëndetin e viktimave (disa prej të cilave të përshkruara më lart) dhe rëndësinë e ndërhyrjes së shpejtë për rikuperimin e këtyre pasojave, jo thjesht identifikimi por identifikimi sa më i shpejtë i trafikimit rezulton një domosdoshmëri.

Identifikimi i krimit të trafikimit dhe i viktimave të tij është i rëndësishëm gjithashtu për zbulimin e krimit të organizuar dhe goditjes së tij. Trafikantët e njerëzve janë përfshirë në krime të tjera të rënda si trafiku i drogës, armëve, vrasje e bashkëpunim në vrasje etj. dhe viktimat e trafikimit shpesh bëhen dëshmitare apo detyrohen me dhunë t'u shërbejnë trafikantëve në aktet e tyre.

Po ashtu siç mund të kenë informacion për rrjetet kriminale apo individët të tillë, viktimat e trafikimit mund të kenë dijeni për njerëz të tjerë që kanë nevojë për ndihmë urgjente, viktimat të tjera e kjo është shumë e rëndësishme për shpëtimin e personave dhe për të parandaluar krime të tjera.

Viktimat e trafikimit dhe personat që asistojnë viktimat e trafikimit kanë nevojë për masa të posaçme sigurie: referimi i një viktime të trafikimit, për shembull në një strehëz për të pastrehë apo për persona me aftësi të kufizuara, ve në rrezik jetën e viktimës dhe të stafit të ndihmës, duke e ekspozuar viktimën ndaj reperkusioneve të trafikantit në ndjekje të saj/ tij. Në librin e saj “Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Evropën Juglindore”, Rebecca Surtees shkruan se: “Menjëherë sapo të bëhet identifikimi, duhet të ndërmerret shqyrtimi i standardizuar i rrezikut. Niveli i rrezikut është i luhatshtëm; ai shtohet ose pakësohet sipas situatës, kohës, vendndodhjes dhe në varësi të faktit nëse individ ka lëshuar ndonjë deklaratë ose jo, apo është duke bashkëpunuar (ose mendohet se është duke bashkëpunuar) me policinë ose jo, duke e bërë në këtë mënyrë shumë të rëndësishme marrjen e masave për të parashikuar çdo rrezik të mundshëm në të ardhmen”.⁶⁶

2.2.2 ÇFARË MUND TA DËMTOJË PROCESIN E IDENTIFIKIMIT

Një nga diskutimet më të njohura në fushën e luftës kundër trafikimit të njerëzve e jo vetëm në Shqipëri është diskutimi i mospërputhjes së statistikave të raportuara nga aktorë të ndryshëm: atyre të raportuara nga autoritetet e zbatimit të ligjit prej atyre që strehojnë viktimat e trafikimit, atyre që raportohen nga vendet e destinacionit prej atyre të raportuara nga vendet e origjinës. Ky diskutim, përveçse tregon që identifikimi është një proces i vështirë që kërkon kohë dhe kapacitete

⁶⁶Surtees, R. Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Europën Juglindore. OstWest Media: 2007.

të veçanta edhe për profesionistë me eksperiencë, tregon gjithashtu se jo të gjithë aktorët e konsiderojnë identifikimin si pikënisje të mbrojtjes dhe ndihmës për viktimat.

Disa nga shkaqet e diskutuara e të evidentuara të dështimit të identifikimit janë:

- Mosnjohja e dallimit mes kontrabandimit, trafikimit, emigrimit të parregullt, apo shkeljes së paligjshme të kufirit nga ana e individëve apo strukturave që bëjnë identifikimin.
- Mosnjohja e krimit të trafikimit dhe pasojave të tij mbi viktimat e këtij krimi.
- Paragjykimi se vetëm femrat mund të trafikohen dhe ato vetëm për shfrytëzim seksual.
- Paragjykimi se personat e shkolluar, grupe shoqërore apo edhe kombësi nuk mund të bien pre e trafikimit.
- Paragjykimi se viktimat kanë pranuar vullnetarisht shfrytëzimin dhe kanë gjithsesi një pjesë të fajit për situatën në të cilën ndodhen.
- Frika se numri i lartë i viktimave të trafikimit të identifikuar mund të interpretohet si dështim i përpjekjeve për të luftuar trafikun e qenieve njerëzore në vend.
- Mungesa e besimit të viktimave në mbrojtjen e ofruar apo në autoritetin që ofron ndihmën.
- Frika e viktimave se pranimi që kanë qenë viktimë mund të çojë në stigmatizimin e tyre si prostituta apo si persona të paaftë mendërisht.
- Mosmarrja parasysh e faktit që identifikimi kërkon kohë dhe burime të mjaftueshme.
- Mungesa e aftësive apo kapaciteteve vlerësuese të individëve apo strukturave që bëjnë identifikimin.
- Mungesa e shkëmbimit të informacionit dhe e koordinimit për identifikim dhe referim të viktimave.
- Korrupsioni në radhët e strukturave të zbatimit të ligjit.
- Mungesa e motivimit, neglizhenca e strukturave të caktuara për identifikim.
- Mungesa e procedurave të qarta për identifikim dhe referim.
- Varësia e viktimës ndaj trafikantit, apo frika e instaluar nga trafikantët për përfshirje dhe inkriminim të viktimës.
- Kushtëzimi i ndihmës për bashkëpunimin me autoritetin e ligjit.
- Personat e trafikuar shpeshherë vuajnë prej çrregullimit të stresit post-traumatik; ashtu si viktimat e tjera të torturës ata heshtin gjatë marrjes në pyetje për keqpërdorimet serioze që mund të kenë përjetuar.

Po në librin e sipërpërmendur, Rebecca Surtees shprehet se “Për shumë nga viktimat e intervistuar përhoja e procesit të identifikimit ishte një përvojë e lodhshme, e mbushur me shumë emocione dhe reagime. Viktimat folën si për reagime pozitive ashtu dhe negative ndaj personelit identifikues, gjatë fazave të ndryshme të procesit të identifikimit. Nuk ishte e rrallë, për shembull, që viktimat të

ndiheshin të lehtësuara kur identifikoheshin, por edhe të frikësuara e me plot dyshime për aktorin identifikues.

Këto çështje kishin të bënin me mundësinë e qasjes së viktimës tek një informacion i plotë dhe gjithëpërfshirës rreth situatës dhe alternativave që mund të kishin gjatë identifikimit; me aftësitë e mangëta të disa aktorëve identifikues; me përvojat e një trajtimi të kujdesshëm, por dhe të një trajtimi mospërfillës gjatë identifikimit; me disa përvoja të marrjes në pyetje dhe të trajtimit si person i ndaluar, në vend të identifikimit si person i trafikuar; me disa raste korrupsioni midis radhëve të aktorëve identifikues; me raste të keqtrajtimin dhe të moskokëçarjes; me çështje që lidheshin me pengesat gjuhësore në procesin e identifikimit; me faktin që identifikimi kryhej në disa rrethana të pafavorshme për disa viktimat; me rastet kur shumë viktimat nuk dinin kujt t'i drejtoheshin për të kërkuar ndihmë; me probleme që lidheshin me viktimat e trafikimit që nuk dëshironin të identifikoheshin”.⁶⁷

Në librin e OSBE/ODIHR-it “Mekanizmat Kombëtare të Referimit. Bashkimi i Përpjekjeve për Mbrojtje të të Drejtave të Personave të Trafikuar” sugjerohet përdorimi i termit *persona të supozuar të trafikuar*, me shpjegimin se lokalizimi dhe identifikimi i personave të trafikuar është problem themelor në të gjitha strategjitë antitrafik. Për një varg arsyes, ata që janë zënë në trafikimin e qenieve njerëzore si rregull nuk dëshirojnë t’ua zbulojnë statusin ose përvojën e tyre autoriteteve shtetërore. Viktimat mund të kenë ndjenja të thella mosbesimi ndaj zyrtarëve të shtetit që rrjedhin prej përvojës në shtetin e tyre të origjinës. Shpeshherë, viktimat i frikësohen kundërpërgjigjes së dhunshme të trafikantëve kundër tyre dhe anëtarëve të familjes në shtetet e tyre të origjinës. Kërcënimet për përdorim dhune pas kthimit në atdhe mund të rrisin frikën e viktimës prej deportimit për shkak të statusit të tyre ilegal. Meqenëse viktimat e trafikimit shpeshherë ngurrojnë ta identifikojnë veten si të tilla, termi *persona të supozuar të trafikuar* përdoret në përgjithësi për t’i përshkruar personat që mund të jenë viktimat e trafikimit dhe të cilët për rrjedhojë duhet të bien nën fushëveprimin e përgjithshëm të programeve dhe shërbimeve antitrafik.

Rrallë herë qëllon që viktimat e trafikimit të jenë të afta ta nxjerrin veten në mënyrë të pavarur nga situatat ku ndodhen. Kur ndodh që ato tërheqin vëmendjen e autoriteteve, kjo vjen si rezultat i kontrolleve të policisë, autoriteteve kufitare ose autoriteteve të tjera shtetërore. Zyrtarët që besohet të bien në kontakt me viktimat duhet të jenë të vetëdijshëm për rrethanat e veçanta me të cilat ballafaqohen ato dhe të tregojnë ndjeshmëri në punën me to, t’u mundësojnë atyre ndihmë deri te mekanizmat ekzistues mbrojtës. Për autoritetet shtetërore është e rëndësishme të mbahet parasysh fakti që personat e trafikuar jo vetëm që janë viktimat e krimit dhe për këtë meritojnë dhembshuri

⁶⁷Surtees, R. Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Europën Juglindore. OstWest Media: 2007.

dhe të drejta njerëzore, por edhe fakti tjetër që afrimi i vullnetshëm i tyre dhe bashkëpunimi mund të ndihmojë në luftën kundër krimit të organizuar.⁶⁸

Në Europën Juglindore janë njohur si kategori në nevojë për ndihmë kategoritë e mëposhtme:

Viktimë e identifikuar: një person i cili është identifikuar si viktimë e trafikimit në përputhje me një mekanizëm formal ose joformal identifikimi.

Viktimë e mundshme: një individ i identifikuar para se të shfrytëzohej, por vetëm në raste kur ka shenja të forta se bëhet fjalë për një proces trafikimi.

Viktimë e hamendësuar: personat që hamendësohen se janë viktima të trafikimit (pasi përmbushin kriteret e Protokollit të Trafikimit të OKB-së) por që nuk identifikohen formalisht si viktima të trafikimit nga autoritetet përkatëse, ose që kanë refuzuar të identifikohen zyrtarisht apo ligjërisht. Në disa vende, kësaj kategorie personash i referohet si *viktimë e mundshme*.⁶⁹

2.2.3 KUSH MUND TË IDENTIFIKOJË NJË VIKTIMË TRAFIKIMI

Në një raport në vitin 2002 thuhet se “sipas një hulumtimi analitik në një shtet të Europës perëndimore, më shumë se 40% e të gjithë personave të trafikuar tani identifikohen nëpërmjet veprimit lokal të organizatave joqeveritare, autoriteteve lokale dhe numrave telefonikë të emergjencës. Klientët e prostitutave dhe qytetarë të tjerë identifikojnë më shumë se 22 për qind të personave të trafikuar. Vetëm 13.9 për qind e personave të trafikuar të kualifikuar për ndihmë identifikohen dhe referohen nga policia.”⁷⁰

Rebecca Surtees vëren në Europën Juglindore se: “Viktimat e intervistuar ishin identifikuar kryesisht nga aktorë dhe mekanizma të anti-trafikimit nëpërmjet zbatuesve të ligjit, punonjësit në terren, linjat e komunikimit telefonik, personeli i OJQ-ve, personeli i ambasadave, punëtorët socialë, klientët dhe vetë viktimat. Po ashtu, identifikimi ishte bërë edhe nga persona që, përgjithësisht, nuk janë të përfshirë në punën anti-trafikim, si për shembull personeli i transportit, qytetarë të thjeshtë dhe organizata fetare. Zbatuesit e ligjit kishin luajtur një rol kyç në identifikimin e viktimave në rajonin e Europës juglindore dhe përtej këtij rajoni. Zbatuesit e ligjit nuk përfshijnë vetëm policinë e specializuar

⁶⁸OSBE/ODIHR. Mekanizmat Kombëtare të Referimit. Bashkimi i pëpjekjeve për mbrojtje të të drejtave të personave të trafikuar. Manual Praktik. 2006.

⁶⁹Surtees, R. Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Europën Juglindore. OstWest Media: 2007.

⁷⁰Orfano, I. (ed) Protection of Victims of Trafficking and Fight against Crime (Italy and European Scenarios). On the road. Martinsicuro, 2002.

anti-trafikim, por edhe autoritetet e emigrimit dhe të kufirit, njësitë policore të qytetit, policinë ushtarake dhe njësitë kundër krimit të organizuar. Shumë nga viktimat e intervistuar ishin identifikuar si rezultat i një ndërhyrjeje proaktive të zbatuesve të ligjit. Në rastet e tjera, kur familjet depozitonin deklaratat e tyre në polici, kjo çonte në identifikimin dhe lirimin e tyre, madje edhe kur bëhej fjalë për raste jashtë vendit. Një grua shpjegoi sesi ishte liruar pasi kishte marrë në telefon bashkëshortin e saj duke i kërkuar ndihmë, nga lokali ku po shfrytëzohej seksualisht.⁷¹

Në librin e publikuar nga OSBE ODIHR “Mekanizmat Kombëtar të Referimit. Bashkimi i Përpjekjeve për Mbrojtje të të Drejtave të personave të Trafikuar” jepen udhëzime për praktikën më të mira për krijimin e një rrjeti identifikimi të përbërë nga veprimi vendor, linjat telefonike dhe autoritetet e ngarkuara për zbatimin e ligjit.⁷²

Veprimi vendor

I quajtur ndryshe *punë në terren* ose *punë në rrugë*, veprimi vendor është element qenësor në përkrahjen e personave të supozuar të trafikuar në mjedisin në të cilin ata janë të detyruar të punojnë. Veprimi vendor merr shpesh herë formën e dhënies së edukimit shëndetësor personave aktive në industrinë e seksit. Forma të tjera të punës në rrugë mund të kenë si synim fëmijët e pashoqëruar. Qasja me respekt dhe kujdes prej punëtorëve socialë, e kombinuar me informatat kyçe për strukturat për promovim dhe përkrahje të shëndetit, mund të ndërtojë besim mes grupeve qëllimore dhe profesioniste. Kjo mund t'i japë fuqi personit të supozuar të trafikuar që të hyjë në strukturat e përkrahjes, si dhe t'i mundësojë OJF-ve krijimin e një harte të fenomenit të trafikimit dhe kryerjen e një analize të nevojave të viktimave.

Linjat telefonike “Hotlines”

Gjatë veprimit vendor mund të shpërndahen afishe me informata kyçe për strukturat e përkrahjes dhe numrat e linjave telefonike për viktimat e krimeve të ndryshme, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore. Më tej, anëtarët e MKR-së mund të informohen për linjat ekzistuese telefonike për viktimat e dhunës në familje dhe të lidhen me to, meqenëse ata mundet gjithashtu të hasin në raste të trafikimit në njerëz. Gjithmonë kur të jetë mundur, këto linja duhet gjithashtu të mundësojnë këshillime në gjuhë të huaja.

⁷¹Surtees, R. Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Europën Juglindore. OstWest Media: 2007.

⁷²OSBE/ODIHR. Mekanizmat Kombëtare të Referimit. Bashkimi i përpjekjeve për mbrojtje të të drejtave të personave të trafikuar. Manual Praktik. 2006.

Autoritetet e ngarkuara për zbatimin e ligjit

Në “Udhëzime për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktime të trafikimit në Europën juglindore”, UNICEF parashtron udhëzime për marrjen e masave identifikuese proaktive si:

- Shtetet duhet të marrin të gjitha masat për të vendosur procedura efektive për një identifikim të shpejte të fëmijëve viktime.
- Duhet të bëhen përpjekje për të koordinuar ndarjen e informacionit ndërmjet agjencive dhe individëve (duke përfshirë zbatuesit e ligjit, shëndetësisë, agjencive të mirëqenies sociale dhe OJF-ve) për të siguruar që fëmijët viktime të trafikimit të identifikohen dhe asistohen sa më shpejt që është e mundur.
- Autoritetet e emigracionit, të kufirit dhe të zbatimit të ligjit duhet të kenë procedura për identifikimin e fëmijëve viktime në pikat e hyrjes dhe në vende të tjera.
- Shërbimet sociale dhe autoritetet e shëndetit dhe të edukimit duhet të kontaktojnë autoritetet përgjegjëse të zbatimit të ligjit kur ka dijeni apo dyshohet që një fëmije po shfrytëzohet, po trafikohet apo është në rrezik shfrytëzimi dhe trafikimi.
- OJF-të (organizatat e shoqërisë civile) duhet të kontaktojnë autoritetet përgjegjëse të zbatimit të ligjit apo autoritetet e shërbimeve sociale kur ka dijeni apo dyshim që një fëmijë është i shfrytëzuar, i trafikuar apo është në rrezik shfrytëzimi dhe trafikimi.

2.2.4 PËRBËRËSIT E PROCESIT TË IDENTIFIKIMIT

Identifikimi i viktimeve nga ofruesit e shërbimeve ka për qëllim verifikimin e viktimizimit dhe referimin për ndihmë në bazë të vlerësimit të përputhjes së nevojave të viktimës me shërbimet që ekzistojnë e mund të ofrohen.

Në varësi të profilit të individëve apo strukturave që bëjnë identifikimin formal të viktimeve të trafikimit ka shumë emërtime për fazat apo pjesët në të cilat kalon procesi i identifikimit. Dy janë fazat apo pjesët të cilat spikasin:

1. Vlerësimi i informacionit paraprak në përgatitje për intervistimin, dhe
2. Intervista identifikuese

Nëpër këto faza kalon edhe identifikimi që kryhet nga ofruesit e shërbimeve për viktimat e trafikimit. Për ofruesit e ndihmës së viktimeve të trafikimit është i rëndësishëm respektimi i parimit të mbledhjes së informacionit “aq informacion sa i shërben qëllimit”.

1. Vlerësimi i informacionit paraprak

Format e ndryshme të shfrytëzimit dhe prirjet në lëvizje të trafikimit e zgjerojnë shumë gamën e grupeve të rrezikuara nga trafikimi i qenieve njerëzore. Gjithsesi të dhënat empirike dhe statistikore tregojnë se grupet me rrezik më të lartë dhe që duhen synuar për të identifikuar rastet e trafikimit janë grupet e fëmijëve dhe të rinjve të abuzuar, punonjësit e seksit, të kontrabanduarit, emigrantët ilegalë, punëtorët në të zezë, të deportuarit, fëmijët që lypin në rrugë, fëmijët e paregjistruar, fëmijët e pashoqëruar.

Në shumë raste është e pamundur të kihet informacioni paraprak për një person me të cilin do të kryhet një intervistë identifikuese. Pavarësisht nga kjo, personat apo strukturat që bëjnë identifikimin duhet të kenë së paku një informacion të përditësuar lidhur me prirjet e trafikimit në vend, situatën e emigrimit të parregullt, mënyrat e rekrutimit dhe të shfrytëzimit të lidhura me vendin e origjinës dhe destinacionit.

Nëse është i mundur zotërimi i një informacioni paraprak për individin që do të intervistohet nga ana e strukturës, apo individit apo strukturës që e ka sjellë të intervistuarin në kontakt me intervistuesin, atëherë ata elementë që janë të rëndësishme të vërehen janë:

■ Çfarë moshe ka individi

Në shumicën e formave të shfrytëzimit, si shfrytëzimit seksual, punët e rënda, lypja e detyruar dhe transplantimi i organeve, kërkohen individë të rinj e të shëndetshëm. Për këtë arsye dhe për lehtësinë e manipulimit dhe të shtrëngimit, moshën e re është një nga elementët që duhet konsideruar si një nga treguesit e rëndësishëm paraprakë. Disa prej organizatave vendore kanë vënë re se ka pasur edhe raste të shfrytëzimit të moshave të vona, sidomos raste të cilat kanë pasur probleme të shëndetit mendor.

■ Çfarë seksi ka individi

Në shfrytëzimin seksual, shfrytëzimin e prostitucionit, kërkohen më shumë femra sesa meshkuj, në pedofili kërkohen të dyja seksat: seksi pra është një element që duhet konsideruar në kontekstin e formës së shfrytëzimit më të përhapur në vend apo në vendin nga vjen personi.

■ A ka pasur/ka apo jo dokumente personale të rregullta

Në rastet e trafikimit me kalim të kufijve shtetërore është e rëndësishme të vërehet nëse personi ka pasur gjithnjë në kontroll të vet dhe ka përdorur dokumente të rregullta apo jo. Zakonisht, trafikantët i pajisin viktimat me dokumente me emra false, u rritin moshën të miturve, ose u lejojnë të mbajnë dokumentet personale të rregullta vetëm në pikat e kalimit të kufirit për të mos ngjallur dyshime tek kontrollorët. Tek të miturit, mungesa e regjistrimit dhe braktisja e prindërve janë tregues të rëndësishëm të trafikimit.

■ **Vendi nga vjen, konteksti dhe referuesi**

Nëse personi është deportuar nga një shtet tjetër, vjen nga një vend si shtëpi publike, e ka gjetur policia gjatë një bastisjeje, e ka referuar një klient apo një person tjetër pasi ka kërkuar ndihmë, ka ardhur vetë për të kërkuar ndihmë, e ka referuar një organizatë tjetër që ndihmon njerëz në nevojë, është gjetur në rrugë në ikje e sipër etj, të gjitha këto janë të dhëna që mund të jenë tregues të trafikimit.

■ **A ka shenja dhune**

Është tipike për trafikantët të përdorin dhunën fizike dhe keqtrajtimin për të detyruar shfrytëzimin e viktimave. Organizatat që ndihmojnë viktimat e trafikimit kanë vënë re se viktimat e trafikimit kanë shenja të tilla si prerje, djegie me cigare, skalp të dëmtuar etj, ose janë të dobët fizikisht, të kequshqyer etj.

2. Intervista

Marrëveshja e Bashkëpunimit për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore (MKR), e firmosur më datë 18 Korrik 2005, ka zyrtarizuar një format identifikimi i cila aktualisht përdoret nga anëtarët e MKR-së për të përcaktuar një viktimitë të mundshme trafikimi, të rritur apo fëmijë. Seksionet e këtij formati/liste kontrolli përkohë me elementet e trafikimit të përcaktuar në Protokollin e Palermos. Ky formati i MKR-së gjendet në shtojcën I.

Në hyrje të këtij formati jepen shkurtimisht parime dhe udhëzime për mënyrën në të cilën duhet zhvilluar intervista identifikuese. Dokumentet bazë në të cilat mbështeten këto udhëzime janë kryesisht udhëzimet e UNICEF-it dhe OBSH-së për intervistimin e fëmijëve viktimat dhe viktimave të rritura femra të trafikimit.

a. Parimet ku duhet mbështetur intervistimi

UNICEF udhëzon që në intervistimin e fëmijëve e në gjithë procesin e mbrojtjes së fëmijës duhen pasur parasysh e respektuar të drejtat e fëmijës, qoftë të drejtat te tij si fëmijë, të përcaktuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, qoftë të drejtat për masa të posaçme mbrojtjeje si fëmijë viktimitë. Ky udhëzim thekson të drejtën e ndërmarrjes së veprimeve si të jetë më mirë për fëmijën, të drejtën për të mos u diskriminuar, të drejtën për t'iu respektuar mendimi, të drejtën për informacion, të drejtën për konfidencialitet dhe të drejtën për t'u marrë në mbrojtje.⁷³

⁷³UNICEF. Guidelines for Protection Of The Rights Of Children Victims Trafficking in South Eastern Europe. UNICEF. 2003.

Sipas OBSH-së, parimet etike bazë të sigurisë në intervistimin e viktimave të trafikimit që duhet të ndiqen nga ofruesi i shërbimeve janë:

1. Mos dëmto.
2. Mundëso siguri dhe komoditet.
3. Mundëso privatësinë.
4. Mundëso konfidencialitetin.
5. Jep informacion.
6. Merr pëlqim të mirinformuar.
7. Bëji pyetjet me delikatesë dhe ndjeshmëri.
8. Dëgjo me vëmendje dhe në mënyre aktive.
9. Vëzhgo për shenja që tregojnë se ai/ajo kërkon ta ndërpresë intervistën.
10. Reflekto mbi paragjykimet që mund të kesh.
11. Beso. Mos gjyko.
12. Ruaj profesionalizmin ndërsa e trajton personin me respekt dhe dhembshuri.
13. Sigurohu që personat e trafikuar të ndjejnë se kontrollojnë trupin dhe komunikimin e tyre.
14. Tregoj personave të trafikuar se nuk është faji i tyre.
15. Informo personat e trafikuar për të drejtën e tyre për të bërë një kontroll dhe për të pasur një raport mjeko ligjor.
16. Informo personat e trafikuar për të drejtën e tyre për pasjen e aksesit në dosjen personale.
17. Kujtoju personave të trafikuar se cilat janë pikat e tyre të forta.
18. Ofro përkthim.⁷⁴

⁷⁴ World Health Organization. Ethical and Safety Recommendations for interviewing Trafficked Women. WHO. 2003

b. Mënyra e intervistimit

Kushtet dhe mënyrat në të cilat duhet të zhvillohet një intervistë me një fëmijë të trafikuar duhet të jenë të tilla që:

- Punonjësit që marrin në pyetje fëmijët viktime duhet të jenë të trajnuar për nevojat dhe të drejtat e veçanta të fëmijëve dhe kurdo që të jetë e mundur fëmijët viktime duhet të merren në pyetje nga persona të të njëjtit seks.
- Para intervistimit të fëmijës duhet mësuar sa më shumë që të jetë e mundur për rastin e tij/saj dhe duhet të bëhen prezantime të qarta dhe miqësore (kur flitet për diçka që fëmija e njeh është më e lehtë të krijohet një lidhje me të).
- Duhet krijuar një hapësirë e sigurt dhe e rehatshme për të biseduar (duhet të përfshihen lodra, libra, lojëra etj, për të ndihmuar në afrimin me fëmijën).
- Duhet krijuar lidhje duke folur për, ose duke bërë gjëra që nuk lidhen me përvojën e trafikimit (p.sh duhet diskutuar për gjëra të cilat fëmija i di, duhet luajtur ndonjë lojë qe ai/ajo di).
- I duhet kushtuar kohë e mjaftueshme diskutimit dhe nuk duhet nxituar.
- Duhet krijuar atmosferë e qetë dhe joformale (për shembull, nuk duhet krijuar përshtypja e marrjes në pyetje dhe nuk duhet kërkuar përgjigje me insistim).
- Duhet përdorur gjuha e duhur dhe fëminore (i duhet vënë vesh e të përdoren termat që përdor fëmija).
- Fëmijës i duhen shpjeguar gjërat në mënyrë që fëmija t'i marrë vesh lehtë (përdorni mjete vizuale kurdo që të jetë e mundur).
- Pyetjet duhet të përshtaten në mënyrë që të marrin në konsideratë moshën dhe kapacitetin mendor të fëmijës.
- Duhet filluar me pyetje të hapura, duke i dhënë mundësi fëmijës të tregojë historinë e tij/saj. I duhet shmangur pyetjeve që e japin vetë përgjigjen, si: “A të keqtrajtoi ai?”. Duhet përdorur pyetje më të hapura si: “Ç’bëri ai person?”
- Nuk duhet këmbëngulur të mësohen detaje të tjera kur ka shenja që tregojnë që fëmija ka thënë gjithçka që di. Megjithatë, duhet pasur parasysh edhe se fëmijët nuk e japin të gjithë informacionin në qoftë se nuk i bëhet pyetja e duhur dhe japin përgjigjen që ata mendojnë se pret të dëgjojë intervistuesi.
- Intervistat me të miturit duhen bërë në prani të një prindi. Në rastet kur kjo nuk është e mundur, si në rastet kur prindi nuk është i pranishëm ose kur dyshohet ose dihet që familja është përfshirë në trafikim, intervista duhet të bëhet në prani të një kujdestari të trajnuar, psikologu ose punonjësi social.

- Duhet mbyllur intervista në mënyre të tillë që ta sigurojë fëmijën që ai/ajo doli mirë dhe që intervistuesi do të jetë atje të flasë me të sa herë ai/ajo të ketë nevojë.⁷⁵

Në intervistimin me të rritur viktimat të trafikimit duhet bërë kujdes që para se të fillojë intervista të jenë sqaruar dhe marrë masa që:

- Sa herë që është e mundur, intervista të bëhet në një vend të mbyllur dhe jopublik, ku nuk mund të dëgjojnë ose të ndërpresin njerëz të tjerë.
- Personat e vetëm që duhen lejuar të jenë të pranishëm duhet të jenë vetëm viktimat, intervistuesi/intervistuesit, një përkthyes (kur është e nevojshme) dhe një person i kualifikuar për mbështetje (këshilltar ligjor ose psikologjik) kur është e nevojshme.
- Në qoftë se ka dyshime për aftësinë e të intervistuarit për të kuptuar gjuhën e intervistës, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për të gjetur një përkthyes.
- Telefonat celularë duhet të fiken dhe në qoftë se ka në dispozicion një vend të mbyllur, duhet të vendoset një tabelë mbi derë për të njoftuar të tjerët që të mos hyjnë dhe kështu të ndërpresin intervistën.
- Në qoftë se vendi është i mbyllur, intervistuesi duhet të mundohet të gjejë një vend sa më të izoluar që të jetë e mundur, në mënyrë që intervista të mos dëgjohet nga të tjerët.
- Duhet shmangur stili gjykues ose hetues i intervistimit.
- Me personin duhen krijuar lidhje të tilla që ai/ajo të ndihet i respektuar dhe të krijojë besim tek intervistuesi.
- Të informohet personi që të gjitha përgjigjet do të mbahen të fshehta. T'i tregohet atij saktësisht se ç'do të ndodhë me informacionin e marrë dhe si dhe kujt do t'i jepet ai.
- T'i shpjegohet individit që mund të bëjë pyetje në çdo kohë ose të kërkojë sqarime ose përsëritje të asaj ç'ka është shpjeguar ose thënë më parë.
- Të sigurohet që personi i ka kuptuar të gjitha gjërat që i shpjeguat.
- Të pyetet personin nëse ka pyetje pa filluar intervistën.
- Të pyetet personi a është dakord të marrë pjesë në intervistë.
- Intervistuesi duhet të prezantohet dhe të përshkruajë rolin e tij/saj në organizatë.
- Intervistuesi duhet të sigurohet/të pyesë nëse individ i intervistuar ndihet i sigurt dhe i qetë.
- Ta pyesë nëse ai/ajo ka nevojë të shkojë në banjë ose ka nevojë për pije freskuese.
- Ta pyesë nëse individ ka ndonjë dhimbje ose shqetësim, ose nëse individ ka probleme që kërkojnë ndihmë të menjëhershme mjekësore.
- Intervistuesi të mos e bëjë intervistën nëse individ ka probleme mjekësore urgjente, deri sa

⁷⁵UNICEF. Let's Talk: Developing Effective Communication with Child Victims of Abuse and Human Trafficking. UNICEF Kosovo. 2004.

personi të jetë vizituar nga një mjek profesionist.

- Duhet dhënë shpjegime të shkurtra por të mjaftueshme të rolit të organizatës në dhënien e asistencës për viktimat e trafikimit dhe të arsyes së intervistës që po fillon.
- Duhet shpjeguar si do të përdoret informacioni i marrë.
- Duhet shpjeguar se intervista mund të përmbajë pyetje që kanë të bëjnë me historinë e asaj që i ka ndodhur dhe se disa nga temat mund të jenë të pakëndshme, të dhimbshme për t'u kujtuar dhe mund të sjellin kujtime të këqija.
- I duhet shpjeguar individit se nuk është nevoja të përgjigjet menjëherë dhe se mund të bëjë pushim kur të dojë nëse ka nevojë.
- Duhet siguruar që viktimat e kuptojnë që intervista është me dëshirë dhe që nuk është e thënë të përgjigjet. Duhet shpjeguar se sa më shumë informacion të japë aq më shumë do të mund ta ndihmojë organizata. Duhet shpjeguar kufizimet e asistencës që mund të japë organizata (p.sh. në qoftë se asistenca është vetëm për personat e trafikuar, emigrantët e parregullt, fëmijët etj).
- Duhet shpjeguar se, në qoftë se organizata nuk do të mund t'i ofrojë ndihmë të drejtpërdrejtë sepse nuk i përbush kriteret, organizata do të mundohet ta ndihmojë dhe të gjejë një grup ose individ të kualifikuar që mund t'i ofrojë ndihmë.⁷⁶

2.3 RËNDËSIA E REFERIMIT TË VIKTIMËS DHE HAPAT QË DUHET TË NDIQEN

Termi “referim” këtu përdoret me kuptimin e ndihmës që i jepet një personi viktimë trafikimi për t’u kthyer nga një vend zakonisht tranziti ose destinacioni në vendin e origjinës apo në një vend tjetër të tretë të sigurt, ose nga një burim mbrojtjeje dhe asistence në një tjetër brenda një vendi. Ndërsa referimet nga një vend në një tjetër kërkojnë bashkëpunime dhe koordinime të nivelit transnacional, referimet nga një shërbim në tjetrin brenda një vendi kërkojnë bashkëpunim dhe koordinime mes ofruesve të shërbimeve si edhe njësimi/standardizimi i cilësisë së shërbimeve. Në çdo rast, imperativi i referimit dhe kthimit është sigurimi i vazhdimësisë së ndihmës, shmangia e rrezikut për jetën dhe e ritrafikimit.

Praktikat më të mira të referimeve sugjerojnë marrjen e masave të tilla që referimi:

- Të respektojë dinjitetin e viktimës.
- Të bëhet në një kohë sa më të shpejtë të mundshme kur e kërkon viktimat dhe të shmangë vonesat.

⁷⁶IOM. Manuali i IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Tiranë, 2007.

- Të bëhet në mënyrë të vullnetshme në interes të viktimës e me dëshirën e lirë të viktimës.
- T'i jepet prioritet shëndetit dhe mirëqenies fizike dhe mendore të viktimës.
- Të sigurojë vazhdimësinë e mbrojtjes dhe ndihmës.
- Të sigurojë zgjidhje sa më afatgjata dhe të qëndrueshme.
- Të bëhet mbi bazën e një vlerësimi sa më të saktë të mundshëm të rrezikut dhe të përfshijë masa të mirëmenduara për shmangien dhe minimizimin e tij.
- Të respektojë të drejtat e viktimës, e sidomos të drejtën për informim, të drejtën për konfidencialitet, për mosdiskriminim dhe për të marrë pjesë sa më shumë që është e mundur, në vendosjen e modaliteteve, për të zgjedhur alternativën më të mirë të mundshme, për të dhënë pëlqim të mirinformuar dhe për të marrë trajtim dhe kujdes të individualizuar.
- Të bëhet i koordinuar mes strukturës referuese dhe asaj ku referohet viktimja.
- Të bëhet i parapërgatitur.
- Të bëhet në kushtet e unifikimit të standardeve të ndihmës.
- Të minimizojë ritregimin e historisë së viktimës – rimarrjen në pyetje.

Marrëveshja ku përcaktohen përgjegjësitë e aktorëve kyç në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore për sa i përket identifikimit, referimit, akomodimit, asistencës dhe rehabilitimit të viktimave të trafikimit në Shqipëri është Marrëveshja e Bashkëpunimit për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore (MKR) e firmosur më datë 18 Korrik 2005. Në thelb, MKR është një sistem, një rrjet i ngritur mes policisë, shërbimit social, shërbimit diplomatik dhe konsullor, si dhe qendrave pritëse dhe rehabilituese për viktimat e trafikimit.⁷⁷

Vendosja e ndryshme gjeografike e qendrave të ndihmës për viktimat e trafikimit dhe profili i tyre i ndryshëm programor krijon alternativa për një riintegrim të viktimave në përputhje me situatat e tyre individuale. Nga ana tjetër, ekzistenca e qendrave me nivele të ndryshme sigurie krijon mundësinë e shmangies së rrezikut, apo efekteve të panevojshme të masave të posaçme të sigurisë. Gjithsesi, referimi i viktimave në burime të tjera ndihme me bazë komunitare është akoma i mangët, burimet e ndihmës për viktimat në komunitetet e tyre dhe stigmatizimi në zona të mbyllura e të largëta janë disa prej arsyeve për këtë.

Në rastet kur kemi të bëjmë me kthimin e një viktime në vendin/shtetin e saj të origjinës, organizata që e referon/dërgon duhet të sigurohet që përpara nisjes së viktimës se:

- Gjendja mjekësore viktimës është e mirë dhe nuk ka rrezik nga lëvizja.

⁷⁷Shih më lart, kapitulli I.

- Viktima ka treguar se kupton dhe është dakord me të gjitha procedurat e nisjes dhe udhëtimit.
- Në bashkëpunim me të është gjetur një vend i përshtatshëm dhe i sigurt për të qëndruar.
- Janë siguruar të gjitha dokumentet ligjore dhe administrative për kthimin e saj.
- Viktimës i është shpjeguar dhe i janë dhënë të gjitha sugjerimet e referimet e nevojshme për ndihmën në vazhdim.
- Dokumentet e saj janë përcjellë në ofruesin tjetër të shërbimeve që do kujdeset për të dhe është marrë konfirmim prej tyre se do të kujdesen për të.
- Viktima ka kopje të të gjitha dokumenteve të nevojshme vetjake.
- Viktimës i janë dhënë sqarime të hollësishme se çfarë do të ndodhë në vazhdim.

3

*Mbrojtja dhe
riintegrimi i
viktimave të
trafikimit*

3.1 NDËRHYRJA

Duhet pasur parasysh se mirëqenia e menjëhershme e viktimës duhet të zërë gjithmonë vendin kryesor në procesin e riintegrit, prandaj zakonisht iu jepet përparësi çështjeve të sigurisë dhe shëndetit, sidomos kur ka burime të kufizuara njerëzore dhe financiare dhe pak kohë në dispozicion.

Ndihma në mbërritje

Për t'i mbrojtur më mirë viktimat e trafikimit, IOM⁷⁸ rekomandon që organizatat t'i nxisin viktimat të pranojnë ndihmën në mbërritje si pjesë të paketës së ndihmës. Edhe viktimat që ndihmohen për t'u kthyer në atdhe duhet të nxiten të pranojnë ndihmë në mbërritje. Mbështetja fillestare nga organizata pritëse mund të përfshijë ekzaminim dhe trajtim të gjithanshëm mjekësor/psikologjik (ndërhyrje psikologjike në krizë), strehim afatshkurtër dhe ndihmë për nevojat e tjera sociale, ligjore dhe ekonomike të viktimës. Organizata pritëse duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të marrë masa për të shmangur krijimin e një situatë varësie nga programet e saj të riintegrit, në mënyrë që viktima të bëjë një jetë normale duke u mbështetur në forcat e tjera. Gjithsesi, mbështetja afatgjatë duhet të ofrohet nga struktura qeveritare ose joqeveritare.

NDIHMA PARAPRAKE DHE FAZA E PARË E NDIHMËS (AKOMODIMI) NË QENDRËN E RIINTEGRIMIT TË ORGANIZATËS “TË NDRYSHËM DHE TË BARABARTË”

Shërbimet e akomodimit/strehimit dhe shërbimet paraprake/fillestare për përfitueset ofrohen në Qendrën e Riintegrit. Asistenca që i jepet përfitueses gjatë fazës së parë të ndihmës përfshin identifikimin dhe adresimin e nevojave të saj (dhe fëmijës, në rast se e ka me vete) mjekësore, psikologjike dhe përgatitjen e përfitueses për statet e tjera të procesit të riintegrit. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe përfitueses të sapoardhur i caktohet një punonjëse rasti, ndërtohet marrëdhënia e besimit dhe ndihmohet për t'u përshtatur me jetën në qendër. Asistenca akomoduese dhe ndihma paraprake janë pjesë e fazës së parë të riintegrit. Për çdo individ të asistuar plotësohet profili dhe plani i riintegrit, përmes kryerjes së intervistave dhe seancave të këshillimit. Çdo plan individual fillon të zbatohet nëpërmjet punës individuale me rastet, e cila përfshin seanca këshillimi me objektiva dhe strukturë të përcaktuar, kontrolle mjekësore kur janë të nevojshme, trajnime profesionale dhe përgatitje për vazhdimin e arsimit, kurse analfabetizmi, negociim/ndërmjetësim me familjen (kur rastet duan të rivendosin marrëdhënie të shëndetshme me familjen e tyre), etj.

⁷⁸Ky seksion i referohet Manualit të IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Tiranë, 2007.

Elementë të ndërhyrjes në krizë⁷⁹

Njohuritë dhe shprehjet bazë në vlerësimin dhe ndërhyrjen në krizë janë grupi i tretë i burimeve njerëzore përgjatë gjithë procesit të ndihmës dhe kujdesit për personat e trafikuar. Kjo pasi shumica e personave kanë nevojë për ndihmë të parë psikologjike në disa momente të menaxhimit të rastit, që nga strehëzat dhe qendrat në vendet e destinacionit dhe gjatë gjithë rrugës për në qendrat e rehabilitim/riintegritimit në vendin e tyre e më tej.

1. Përcaktimi i strategjisë dhe qëllimeve

Nga vetë emri, “ndërhyrja në krizë” është një paradigmë e kujdesit në situata emergjence. Duke pasur parasysh urgjencën dhe kohën e kufizuar, vlerësimi dhe ndërhyrja në këtë rast janë dy procedura të lidhura ngushtë dhe janë vetëm pjesë të një procesi kompleks, siç tregohet në poshtë:

Rregulli 1 – Shpejtësia

Një person në krizë nuk mund të vendoset në listën e pritjes. Sa më shpejt të nisë ndërhyrja, aq më të mëdha janë mundësitë për të parandaluar ndikimin afatgjatë të ngjarjeve traumatike nga e kaluara e afërt.

Rregulli 2 – Afërsia

Sa më afër kontekstit fizik të ngjarjeve traumatike, aq më shumë mund të parandaloni shtrembërimin e kujtimeve dhe fantazitë false! Kjo do të thotë thjesht ose të ndërhyri sa më afër vendndodhjes origjinale fizike të ngjarjes, ose të vendosni punën me imazhet sa më pranë mjedisit fizik të ngjarjeve stresuese/traumatike.

Rregulli 3 – Përfshirja personale

Ju nuk mund ta ndihmoni një person në krizë të thellë personale nëse nuk keni interesin e plotë për të kuptuar vërtet atë që ka kaluar. Kjo nënkupton përfshirjen tuaj personale dhe investimin emocional mbi bazat e miratimit reciprok mes jush dhe personit që po përpiqeni të ndihmoni.

⁷⁹Në vijim, ky nënkapitull i referohet Manualit të trajnimit Aspektet e shëndetit mendor të trafikimit të qenieve njerëzore, IOM, Budapest: 2004.

Rregulli 4 – Veprimi

“Urtësia” e të menduarit ekologjik thotë “Përpara se të ndryshojmë veten (mjaft e vështirë), le të shohim se ç’mund të ndryshojmë në mjedisin tonë dhe në marrëdhënien tonë me të!”. Ky është ndoshta rregulli më kompleks, më i vështirë për t’u ndjekur, duke pasur parasysh kohën dhe hapësirën e kufizuar për ndërhyrje në kontekstin e ndërhyrjes në krizë. Gjithsesi, meqenëse personat e trafikuar zakonisht përjetojnë *kriza identiteti*, punonjësi duhet të veprojë në mjedisin e tanishëm fizik dhe social. Në të njëjtën kohë, përkujdesësit duhet të shohin përpara në të ardhmen e personit nga këndvështrime të tjera, përveç atyre prej të cilave e ka parë ajo vetë deri tani.

1. Elementë të vlerësimit në krizë

Procedura e vlerësimit duhet të zbulojë:


- *gjendjen e cenueshme/në rrezik* (rrethanat stresuese që i paraprinë gjendjes akute të krizës, për shembull situata familjare, ngjarje traumatike)
- *ngjarjet dhe kushtet e rrezikshme* ndaj të cilave është ekspozuar personi me të cilat është përballur gjatë 12 muajve të fundit dhe ndoshta do t’i duhet të vazhdojë të përballet në të ardhmen e afërt (për shembull me ndikimin e abuzimit fizik ose të torturës psikologjike)
- *strategjitë e përballimit* që personi ka përdorur zakonisht në gjendje tejet stresuese (për shembull, të qara, izolim i tepruar, përdorim i tepruar i alkoolit ose drogave, veprime impulsive)
- *ngjarjet dhe/ose kushtet precipituese*, faktorë që ngacmuan gjendjen akute të krizës me shenja të dukshme dhe modele të sjelljes anormale (të pazakontë), specifike për personin.

2. Elementë të intervistës së vlerësimit në krizë

Intervista është një nga mjetet më të thjeshta, më pak bezdisëse dhe që ndihmon më tepër vlerësimin e krizës. Koha dhe mjedisi i intervistës së krizës duhet të përshtatet me gjendjen fizike dhe mendore të personit. Në situata emergjence duhet të mblidhen vetëm të dhëna bazë, ndërsa më vonë (për shembull 2-3 ditë pas arritjes në një njësi tranzit), mund të përgatitet një intervistë më e thelluar. Rekomandohet fuqishëm që të përdoren lista të treguesve më të zakonshëm të lidhur me krizën, si kujtesë për intervistuesin. Këto lista, si dhe të gjithë dokumentet e tjera, idealisht duhet të plotësohen pas takimit me viktimën e trafikimit.

3. Elementë të ndërhyrjes në krizë

Detyra kryesore e një profesionisti që ndërhyr në krizë është të dallojë cilat janë shkaqet dhe pasojat kryesore psikologjike të një ngjarjeje të fundit të dhunshme (të rrezikshme) që ngacmoi krizën akute në funksionimin social dhe mendor të viktimës së trafikimit. Në këtë drejtim, skema e mëposhtme mund ta ndihmojë profesionistin të bëjë dallimin mes katër modeleve kryesore të reagimit në krizë dhe shkaqeve të tyre.



Skema ndihmon në dy drejtime. Nga njëra anë na mëson të mos ngatërrojmë CSPT (çrregullimin e stresit posttraumatik) me çrregullimet e ankthit, për shembull, pasi të dy modelet e reagimit në krizë janë të ndryshme si në shkaqe ashtu dhe në shfaqjen/pasojat e tyre. Nga ana tjetër, skema është e dobishme për të përcaktuar prioritetet për ndërhyrje.

Përtej diagnostikimit, shumica e profesionistëve kanë nevojë për ndihmë për strukturimin tematik të intervistave të tyre të krizës. Në këtë drejtim, nuk ekzistojnë standarde të parapërcaktuara, por vetëm parime drejtuese. Një parim i dobishëm strukturimi në literaturë është "raportimi/ndihma e shpejtë psikologjike" (debriefing). Elementët e tij janë:

1. *Kontakti i shpejtë.* Rekomandohet që seanca e parë e ndihmës së shpejtë psikologjike të mbahet brenda dy ditëve të para pas një ngjarjeje të rrezikshme.

2. *Fokusimi tek e ardhmja.* Fokusimi i kësaj seance duhet të jetë në ngjarjet më të fundit dhe pasojat e tyre.
3. *Mobilizimi i burimeve.* Nëse është e përshtatshme dhe e pranueshme, një seancë në grup të vogël duket më efektive, krahasuar me intervistën individuale, me qëllim aktivizimin e burimeve mbështetëse të bashkëmoshatarëve. Nga ana tjetër këto burime mund të ndihmojnë shumë për të “normalizuar” reagimet e lidhura me stresin (për shembull panikun) dhe për t’u përdorur më tej në të ardhmen.
4. *Struktura e seancës së ndihmës së shpejtë psikologjike.* Strukturimi i mëposhtëm i seancës duhet respektuar duke lënë vend edhe për elasticitet

■ PREZANTIMI:

Prezantimi i skuadrës dhe pjesëmarrësve
Përcaktimi i rregullave

■ Faktet

Çfarë ndodhi?

■ Mendimet dhe përshtypjet shqisore

Mendimet e para

Vendimet

Përshtypjet

■ Reagimet emocionale

Pyetje mbi mendimet që çojnë në përgjigje për ndjenjat

Çfarë është më e keqja lidhur me atë që ndodhi?

Pranimi i reagimeve

Reagimi në vendngjarje dhe më vonë

Reagimet emocionale, fizike dhe njohëse

■ Normalizimi

Komente mbi reagimet

Udhëzime paraprake

Këshilla mbi përballimin pozitiv

■ Planifikimi dhe përballimi në të ardhmen

Mobilizimi i burimeve mbështetëse (të disponueshme)

Mobilizimi i rrjetit mbështetës “natyror” (të mëparshëm), për shembull, familja, fëmijët, miqtë (nëse ka)

■ Mbyllja (ndërprerja e angazhimit)

Përmbledhja

Burimet e mëtejshme.

3.2 METODAT/TEKNIKAT E VLERËSIMIT

Praktika na tregon se në punën me viktimat e trafikimit rezultojnë efektiv modelin e menaxhimit të rastit. Teorikisht, menaxhimi i rastit është një proces hap pas hapi (step by step) për zgjidhjen e problemit, i cili rrjedh nëpërmjet një serie seancash këshillimi, intervistash, vendimesh, ndërhyrjesh dhe shumë procesesh të tjera, të ndara nga ndihmësit në shkallë të ndryshme të kontaktit personal. Veçoritë

kryesore të drejtimit të zgjidhjes së problemit janë të njohura në teori dhe praktikën e profesioneve të ndihmës, duke përfshirë edhe punën sociale.

HAPI I PARË – NDËRTIMI I MARRËDHËNIES

Qëllimi kryesor i procesit përfshin ndërtimin dhe mbajtjen e një marrëdhënieje mbështetjeje dhe kujdesi. Qëllimi i përgjithshëm është që të bëjë klientin (në rastin tonë personin e trafikuar) të hapet, të rifitojë vetëvlerësimin dhe të rrisë besimin në veten e saj dhe tek të tjerët.

Hapi i dytë – Vlerësimi

Ky hap lidhet me identifikimin dhe vlerësimin e problemeve të personit të trafikuar nga perspektiva të ndryshme, për shembull: nga perspektiva e saj, nga perspektiva se si njerëzit e tjerë të rëndësishëm i shohin dhe i interpretojnë ato, dhe së fundi, se si një ndihmës (menaxhues rasti ose këshillues) i shikon dhe i interpreton ato.

Hapi i tretë – Lehtësimi i ndryshimit

Qëllimi i këtij procesi përfshin strategjitë fillestare dhe ndërhyrjet për të lehtësuar ndryshimin që është nga njëra anë i pranueshëm, i përshtatshëm dhe i dëshirueshëm nga perspektiva e personit, dhe nga ana tjetër i pranueshëm nga perspektiva e njerëzve të tjerë të afërm, duke përfshirë edhe personin e ndihmës. Gjatë kësaj faze, personi dhe ndihmësi (menaxhuesi i rastit) ndërtojnë plane veprimi alternative, vlerësojnë pasojat e mundshme të alternativave të ndryshme dhe vendosin se si të procedojnë në këtë moment.

Hapi i katërt – Vlerësimi përfundimtar

Qëllimi i këtij procesi përfshin vlerësimin e rezultateve të veprimit dhe të ndërhyrjeve, në krahasim me qëllimet afatshkurtra dhe afatgjata. Një vlerësim i rëndësishëm për menaxhuesin e rastit përfshin: Në fund të fundit, a e ndihmoi ky ndërtim marrëdhënieje personin? Në çfarë aspekti e ndihmoi? Nëse nuk e ndihmoi, përse?

Sipas Manualit të trajnimit të IOM-it⁸⁰, tre modelet konceptuale më të nevojshme për vlerësim dhe ndërhyrje në praktikën e përditshme të ndihmës në kontekstin kundër trafikimit, janë:

1. Modeli ekologjik i vlerësimit dhe ndërhyrjes
2. Model i procesit infermieristik të vlerësimit dhe ndërhyrjes

⁸⁰Në vijim, ky nënkapitull i referohet Manualit të trajnimit Aspektet e shëndetit mendor të trafikimit të qenieve njerëzore, IOM, Budapest: 2004.

3. Elementë të ndërhyrjes në krizë (shih seksionin 3.1)

Modeli ekologjik

Viktimave të trafikimit iu duhet të përballen jo vetëm me dëmtimet e shumta morale të veprimeve të dhunshme (për shembull, përballimi i eksperiencës në vetvete), por gjithashtu duhet të balancojnë një sërë faktorësh individualë nga realitetet e tyre të kaluara ose të tanishme. Teorikisht, një person i trafikuar ka nevojë për të paktën tre ndërveprime kritike me mjedisin që të mund të përfitojë një perspektivë të ekuilibruar për një rritje të shëndetshme:

- Nevojat individuale duhet të balancohen nga burimet mjedisore.
- Dëshirat dhe aspiratat individuale duhet të balancohen nga mundësitë mjedisore.
- Shprehitë dhe aftësitë individuale duhet të balancohen nga kërkesat mjedisore.

Modeli ekologjik vë një theks të fortë në funksionimin social dhe jo në keqfunksionimin mendor. Ai sugjeron tre detyra kryesore për vlerësimin dhe ndërhyrjen:

1. Vlerësim të nevojave (të shkuara dhe të tashme) – në kontekstin e burimeve ekzistuese
2. Vlerësim të aspiratave personale (të shkuara dhe të tashme) – në kontekstin e mundësive ekzistuese
3. Vlerësim të aftësive personale të tashme – në kontekstin e pritshmërive personale ose shoqërore për ndryshim.

Modeli i procesit infermieristik

Nga të gjitha modelet teorike, këndvështrimi i procesit infermieristik (PI) është ai që ka ndërthurjen më të madhe me praktikën e përditshme të punës me rastet në fushën e përkujdesit për viktimat e trafikimit. Ekzistojnë tre arsye kryesore për këtë. Së pari, PI ofron një nga këndvështrimet më të gjera të përkujdesit, që përfshin mirëqenien fizike, mendore dhe shoqërore të personit. Së dyti, si art dhe shkencë, infermieristika bashkëkohore ofron standarde dhe njohuri specifike për procesin e plotë të përkujdesit, nga e tashmja deri në momentin e vdekjes. Së treti, PI na ofron një nga kornizat didaktike më gjithëpërfshirëse për të mësuar shprehi specifike të vlerësimit dhe ndërhyrjes tek personat e trafikuar

Në thelb, PI është një udhëzues hap pas hapi për përkujdesin dhe kërkon realizimin e detyrave të mëposhtme:

Vlerësimi: gjatë fazës së vlerësimit, punonjësi duhet të mbledhë dhe shqyrtojë informacionin për të përftuar të gjitha faktet e nevojshme për të përcaktuar gjendjen shëndetësore të viktimës së trafikimit dhe për të përshkruar pikat e saj të forta si dhe problemet e saj

Diagnoza: pas zotërimit të fakteve të nevojshme, punonjësi është gati të analizojë të dhënat për identifikimin e pikave të forta (të cilat do të përforcohen dhe përdoren në zhvillimin e një plani përkujdesi), si dhe problemet aktuale dhe potenciale (të cilat do të bëhen baza për planifikimin e përkujdesit). Punonjësi duhet të vendosë se cilat probleme mund të zgjidhen apo lehtësohen në mënyrë të menjëhershme përmes ndërhyrjeve të drejtpërdrejta, të pavarura (për të cilat zotëron kualifikimin e përshtatshëm) dhe cilat probleme kanë nevojë për ndërhyrje që duhet të fillohen dhe/ose përshkruhen nga punonjës të tjerë të kualifikuar (referim në rrjet).

Planifikimi: pasi janë identifikuar pikat e forta dhe problemet e personit, mund të fillojë puna me rastin, me detyrën specifike të zhvillimit të një plani veprimi që do të reduktojë ose eliminojë problemet dhe do të promovojë zhvillimin.

Zbatimi: nënkupton vënien e planit në veprim.

Vlerësimi: Punonjësi duhet të vlerësojë dhe përcaktojë sesa mirë ka funksionuar plani dhe nëse ka ndonjë ndryshim në të.

Vlerësimi individual dhe i situatës⁸¹

Siç thamë më sipër, procesi i vlerësimit të rastit/viktimës së trafikimit rezulton më i përshtatshëm dhe efektiv kur bazohet mbi tre modelet konceptuale të mësipërme. Për sa i përket përmbajtjes dhe zërave këtij procesi, ai grupohet në dy kategori, të cilat do të detajohen më poshtë:

1. Vlerësimi individual, i cili përqendrohet tek faktorët që lidhen drejtpërdrejt me viktimën
2. Vlerësimi i gjendjes, i cili përqendrohet tek gjendja e pavarur e mjedisit ku ndodhet viktimja, për shembull gjendja e veçantë socio-ekonomike dhe infrastruktura e ndihmës për riintegrim në vendin dhe/ose rajonin në të cilin është kthyer viktimja.

⁸¹Ky seksion i referohet Manualit të IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Tiranë, 2007.

Duhet pasur parasysh se mirëqenia e menjëhershme e viktimës duhet të zërë gjithmonë vendin kryesor në procesin e integrit, prandaj zakonisht iu jepet përparësi çështjeve të sigurisë dhe shëndetit, sidomos kur ka burime të kufizuara njerëzore dhe financiare dhe pak kohë në dispozicion.

1. Vlerësimi individual

Ky vlerësim duhet të kryhet nga persona që e njohin më mirë rastin e viktimës. Këtu mund të përfshihet një punonjës i organizatës që ofron shërbime, një punonjës social, një punonjës i një OJF-je apo një psikolog. Këta persona duhet të vlerësojnë alternativat e riintegrit me synimin e riintegrit të suksesshëm dhe rifutjen në shoqëri të çdo viktime, bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Në radhë të parë, nevojat e viktimës, të cilat mund të përfshijnë nevoja fizike, psikologjike, psikiatrike, ligjore, sociale dhe ekonomike.
- Dëshirat e veçanta të viktimës, dëshirat individuale për alternativa ose shërbime të veçanta riintegrit, të cilat mund të jenë të mundshme ose jo.
- Mundësitë që duhet të shfrytëzohë një viktimë kur gjendet në rrethana të veçanta që lidhen, për shembull, me moshën, gjininë, nivelin e arsimit ose përvojën në punë.
- Niveli i perceptuar i motivimit të viktimës, për shembull nëpërmjet angazhimit dhe rezultateve që lidhen me ndihmën për riintegrit që po i ofrohet dhe/ose rrethanat vetjake.

Në rastin e një referimi ndërkombëtar, vlerësimi vetjak duhet të nisët nga organizata referuese, por të përfundohet nga organizata pritëse në vendin e origjinës.

2. Vlerësimi i situatës për riintegrit

Vlerësimi individual duhet të shoqërohet me një vlerësim të situatës. Ky vlerësim duhet të kryhet nga njerëz që e njohin mirë rastin e viktimës, si dhe rajonin ose vendin e origjinës së viktimës, si më sipër. Këta persona duhet të vlerësojnë mundësitë për riintegrit të çdo viktime, duke u bazuar në këto dy kriteret:

- Mundësitë që mund të shfrytëzohë personi për t'u riintegruar, për shembull disa lloje trajnimi profesional mund të mos të ofrohen në rajonin ose vendin e origjinës ose mund të mos ofrohen sepse nuk ka fonde të mjaftueshme. Po kështu, strehët, shërbimet mjekësore, programet e asistencës sociale ose programet arsimore të qeverisë mund të ofrohen ose jo në vendin ku jeton viktimja.
- Sa lidhje ka ndihma e propozuar për riintegrit me gjendjen e veçantë të viktimës, për shembull trajnimi profesional duhet të ketë lidhje me rajonin, në vendin e origjinës nga i cili

vjen viktimat (nëse një fushë trajnimi nuk është një tipar tipik i rajonit të viktimës apo nëse ka papunësi në këtë fushë, atëherë ajo nuk është e përshtatshme për personin.

3.3 NDIHMA DHE SHËRBIMET QË U OFROHEN VIKTIMAVE

Protokolli për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit në Persona, veçanërisht gra dhe fëmijë, në mbështetje të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, trajton në mënyrë specifike nevojën për ndërhyrje gjithëpërfshirëse e të koordinuara për të mbrojtur viktimat e trafikimit njerëzor dhe për t'u ofruar atyre asistencë praktike.⁸²

Ky protokoll u kërkon shteteve palë të origjinës dhe destinacionit të marrin parasysh zbatimin e masave për ofrimin e rehabilitimit fizik, psikologjik dhe social të viktimave të krimit.

ARTIKULLI 6 I KËTIJ PROTOKOLLI “ASISTENCA DHE MBROJTJA E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT”

1. Në rastet e nevojshme dhe mundësisht më gjerë nën ligjet vendase, çdo shtet palë duhet të mbrojë privatësinë dhe identitetin e viktimave të trafikimit, duke përfshirë, mes të tjerash, ruajtjen konfidenciale të procedurave ligjore lidhur me trafikimin.
2. Çdo shtet duhet të sigurojë që sistemi i tij ligjor dhe administrativ merr masa që i sigurojnë viktimave të trafikimit në rastet e nevojshme:
 - Dhënie informacioni viktimës mbi procedurat administrative dhe gjyqësore.
 - Asistencë për të bërë të mundur që zëri dhe shqetësimet e tyre të njihen dhe të merren në konsideratë pikëpamjet e viktimave.
3. Çdo shtet palë duhet të konsiderojë zbatimin e masave për të siguruar rikuperim fizik, psikologjik dhe social për viktimat e trafikimit, duke përfshirë në rastet e duhura bashkëpunim me organizatat joqeveritare, me organizata të tjera partnere dhe me elementë të tjerë të shoqërisë civile, në mënyrë të veçantë sigurimin e:
 - Strehimit të përshtatshëm.

Shërbimet për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi duhet të fokusohen në mënyrë specifike brenda kuadrit të anti-trafikimit, por nuk duhet të kufizohen vetëm në këtë sektor.

⁸²Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar. Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën nr 55/25, 15 Nëntor 2000.


Shërbimet për viktimat e trafikimit mund të jenë rezidenciale ose komunitare (jorezidenciale). Llojet e shërbimeve që mund të ofrohen:⁸³

Shërbime rezidenciale:⁸⁴

1. Qendra Pritëse

2. Strehëza:

- Qendra riintegruese afatgjata
- Apartamente gjysmë të pavarura
- Apartamente me pavarësi të plotë



⁸³Standardi 1: Qëllimi dhe llojet e shërbimeve në Standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale, të miratuara me VKM 195, dt. 11.4.2007

-⁸⁴Për më tepër informacion shih tek Shtojca II listën e qendrave që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit.

Në Standardin 1 “Qëllimi dhe llojet e shërbimeve” përcaktohet se⁸⁵:

Qendrat rezidenciale ofrojnë minimalisht këto shërbime:

- Akomodim, strehim, veshmbathje, ushqim
- Asistencë mjekësore
- Shërbime psikologjike
- Asistencë ligjore,
- Aktivitete profesionale
- Trajnime profesionale
- Referime në qendra alternative
- Ruajtje ose siguri fizike 24 orë
- Ndërmjetësim me familjen, komunikim periodik telefonik, takime me familjen
- Përkthim për përfitueset e huaja
- Transport për shërbimet e tjera

Llojet e shërbimeve që mund të ofrojnë një qendër ditore dhe komunitare:

- Shërbime të ndihmës ligjore dhe administrative
- Mbështetje në vazhdimësi (Follow up)
- Shërbime psikologjike ose shërbime këshillimi
- Asistencë financiare
- Formim profesional
- Mbështetje për të gjetur punë
- Asistencë mjekësore
- Asistencë për edukim (arsimim)
- Fushata informuese
- Ri-integrim në shkollë
- Shoqërim gjatë kthimit vullnetar

Shërbimet e ofruara adresojnë në mënyrë specifike nevojat e përfituesve⁸⁶ sipas grupmoshave, gjinisë, kombësisë, nevojave të tjera të veçanta, etj.

⁸⁵Standardi 1: Qëllimi dhe llojet e shërbimeve në Standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale, të miratuar me VKM 195, dt. 11.4.2007.

⁸⁶Në këtë kapitull fjalët “përfitues/e”, “rast” përdoren në mënyrë të ndërsjellët duke iu referuar viktimave të trafikimit të cilat përfitojnë nga programet e mbrojtjes dhe riintegrit.

Për personat mbi 18 vjeç.

Ofruesi i shërbimit merr masa që përfituesi të informohet, të zgjedhë dhe të përfitojë sipas nevojës një sërë shërbimesh të nevojshme.

Për personat nën 18 vjeç:

Shërbimet specifike të ofruara adresojnë nevojat e fëmijëve. Ofruesi i shërbimit merr masa që përfituesi, prindi ose kujdestari i tij ligjor të informohen, të përzgjedhin dhe të përfitojnë, sipas nevojës, një sërë shërbimesh të nevojshme.⁸⁷

Të gjitha shërbimet dhe ndihma për riintegrim i duhen ofruar viktimës vetëm nëse ajo dëshiron. Shërbimet duhet të ofrohen vetëm me pëlqimin e mirinformuar të viktimës, duke respektuar të drejtën e saj për intimitet dhe konfidencialitet të plotë.⁸⁸

Viktimave të trafikimit iu duhen dhënë mundësi të ndryshme ndihme në varësi të nevojave, aftësive dhe dëshirave të rastit. Shërbimet e ndihmës mund të jenë rezidenciale ose jorezidenciale. Ndihma për viktimat mund të jepet në familje, në qendrën rezidenciale ose komunitet, por më e rëndësishmja është që çdo viktimë e identifikuar të përfitojë nga programet e ndihmës për riintegrim në mënyrë të pakushtëzuar sepse ndihma mbi të gjitha parandalon ritrafikimin

Paketa e shërbimeve që iu ofrohet viktimave të trafikimit përfshin si më poshtë (por nuk kufizohet në):

- Strehim
- Këshillim psikologjik
- Ndihmë e vazhdueshme mjekësore
- Ndihmë për ri-futjen në sistemin shkollor
- Trajnim profesional
- Këshillim dhe ndihmë për punësim
- Programe pune që gjenerojnë të ardhura
- Zhvillim të aftësive për jetën gjatë riintegrit
- Këshillim dhe mbrojtje ligjore
- Ndërmjetësim me familjen
- Masat e riintegrit në familje/komunitet

⁸⁷Standardi 1: Qëllimi dhe llojet e shërbimeve në Standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale, të miratuar me VKM 195, dt. 11.4.2007.

⁸⁸IOM. Manuali i IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Tiranë, 2007.

- Informacion mbi shërbimet që ekzistojnë në komunitet si dhe kontaktet e nevojshme/hartën e shërbimeve
- Ndhimën specifike për rastet me nevoja të veçanta (rastet me fëmijë - kujdes i paralindjes, kur është shtatzënë; për rastet me probleme sigurie; për rastet me probleme të shëndetit mendor; për rastet që kanë abuzuar me substanca etj)
- Monitorim dhe vlerësim i rastit

Konfidencialiteti dhe ruajtja e anonimatit të viktimave të trafikimit është pjesë shumë e rëndësishme gjatë gjithë procesit të ndihmës për të shmangur paragjykimet dhe stigmën, si dhe për të ruajtur sigurinë fizike të viktimës.

Strehimi: Nevoja e viktimave për strehim të sigurt është sa e menjëhershme, aq edhe afatgjatë. Programet e asistencës për viktimat e pranojnë këtë kërkesë dhe përpiqen të ofrojnë lloje të ndryshme strehimi, bazuar në nevojat e viktimave në fazën e trajtimit në të cilën ndodhen. Çdo punonjës duhet të njihet me llojet dhe numrat e kontaktit të të gjitha strehëzave që ofrojnë shërbime. Së fundi, një tjetër aspekt kritik i programeve të strehëzave të sigurta për viktimat e trafikimit është se ato duhen shoqëruar gjithnjë nga programe të tjera të ndihmës.

Viktimave të trafikimit iu ofrohet strehim në qendrat rezidenciale në fazën e parë të procesit të ndihmës dhe më pas ndihmohen për t'u strehuar në apartamente kur ato kalojnë në fazën e dytë të këtij procesi.⁸⁹

Mjediset e strehimit/strehimet rezidenciale: Janë mjediset që mundësojnë qëndrimin e përkohshëm në to të viktimave të trafikimit, ose edhe për një kohë më të gjatë. Strehëzat mund të jenë të hapura ose të mbyllura; mund të ofrojnë qëndrim afatshkurtër ose afatgjatë dhe/ose përdoren për rastet e emergjencave ose të mbështetjeve për ri-integrim.⁹⁰

Për sa i përket mundësive të strehimit për rastet e trafikuar në Shqipëri, ato janë:⁹¹

1. Qendra Pritëse
2. Strehëza afatgjatë
 - Qendra riintegruese afatgjata
 - Apartamente të mbrojtura me gjysmë pavarësi
 - Apartamente me pavarësi të plotë

⁸⁹Për më tepër informacion shih nënkapitullin 3.6 Planifikimi i mbrojtjes dhe ri-integrimit.

⁹⁰Surtees, R. Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Europën Juglindore. OstWest Media: 2007.

⁹¹Për më tepër informacion shih Shtojcën II me listën e qendrave që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit.

Qendrat Pritëse kanë qëllim të ofrojnë asistencën e parë për viktimën nëpërmjet një pakete bazë shërbimesh për të adresuar nevojat e menjëhershme dhe themelore të tyre, ku përfshihet edhe nevoja për siguri.

Strehëzat/Qendra Riintegruese afatgjata janë qendra që ofrojnë shërbime ri-integruese afatgjata për viktimat e trafikimit.

Apartamentet mund të merren me qera nga organizata që asiston viktimën ose mund të mbështetet financiarisht viktimat e trafikimit për strehimin.

Këshillimi Psiko-social⁹²

Përvoja e trafikimit mund të krijojë prishjen sistematike të lidhjeve bazë dhe thelbësore me familjen, miqtë, sistemet fetare dhe kulturore, shkatërrimin e vlerave qendrore të ekzistencës njerëzore dhe shfaqjen e ndjenjës së turpërimit që ndjek aktet brutale, përfshi torturën dhe përdhunimin. Marrëdhëniet mund të ndryshojnë, përfshi ato me komunitetin dhe figurat e rëndësishme, duke çuar në një ndjenjë të përgjithshme mosbesimi ndaj të tjerëve dhe frikën për të formuar marrëdhënie të reja. Aftësia për intimitet mund të ndryshojë, trishtimi mund të thellohet dhe depresioni mund të bëhet gjithëpërfshirës. Rezultatet e kësaj përvoje mund të jenë të përhershme, pavarësisht trajtimit të përshtatshëm.

Strategjitë dhe asistencat për viktimat e trafikimit fokusohen në arritjen e rehabilitimit dhe ristabilizimit të jetës së personit, kryesisht në shtetin e origjinës.⁹³

Viktimave të trafikimit iu ofrohen këshillime psikologjike individuale dhe në grup. Këshillimi duhet të ofrohet vetëm nga staf i trajnuar.

Këshillimet individuale ofrohen në lidhje me nevojat individuale të përfitueseve dhe me objektivat e vendosura në planin e ndihmës së hartuar nga menaxheri i rastit dhe përfituesja. Zakonisht seancat e këshillimit janë të fokusuara në:

- a) marrjen e vetes pas ngjarjeve traumatike
- b) stabilizimin e gjendjes emocionale
- c) përmirësimin e mirëqenies psikologjike

Këto synime arrihen nëpërmjet ndërtimit të marrëdhënieve ndërpersonale dhe atyre familjare, ngritjes së vetëvlerësimit dhe vetësigurisë, trajnimeve profesionale, punësimit, ndërtimit të planeve për të ardhmen, krijimin e një jetën të pavarur etj.

⁹²Për më tepër informacion shih nënkapitullin 3.5 Këshillimi.

⁹³UNODC. Toolkit to Combat Trafficking in Persons. United Nations, 2006. <http://www.unodc.org/documents/human-trafficking/HT-toolkit-en.pdf> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

Në mënyrë që të monitorohet progresi i përfitueseve, të përmirësohet cilësia e menaxhimit të rasteve dhe e vendimmarrjes, duhet të organizohen takime për menaxhimin e rastit me pjesëmarrjen e ekipit shumë-disiplinor të përbërë prej punonjësve socialë, mësuesve, psikologut, mjekut, juristit. Gjatë takimeve për menaxhimin e rasteve ekipi shumë-disiplinor diskuton për të gjitha rastet me radhë, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në rastet e vështira, në ato që kërkojnë ndjekje të veçantë dhe në rastet e reja.

Shërbimet mjekësore dhe shëndetësore

Viktimat e trafikimit shpesh kanë nevojë mjekësore urgjente, të cilat duhet të trajtohen si çështje parësore. Ato mund të kenë dëmtime fizike ose të kenë qenë ekspozuar ndaj rrezikut të sëmundjeve. Ato mund të jenë detyruar të përdorin droga narkotike ose psikoaktive si mjet për t'i kontrolluar. Vetë viktimat mund të kenë zhvilluar varësi ndaj drogave për të ndihmuar veten në përballimin e situatës. Ato mund të kenë probleme të shëndetit mendor dhe të gjendjeve fizike që i shoqërojnë ato. Ato mund të kenë qenë jo të ndërgjegjshme për çështjet e shëndetit seksual dhe të jenë detyruar të pranojnë praktika seksuale të pasigurta dhe të dhunshme, të cilat rrisin rrezikun e prekjës nga HIV/AIDS dhe sëmundje të tjera seksualisht të transmetueshme. Vizitat dhe diskutimet e para mjekësore, të cilat është e mira të bëhen në praninë e një personi mbështetës nga organizata që do të ofrojë shërbimet dhe një përkthyes (kur është e nevojshme) janë hapi i parë në mënyrë që të identifikohen dëmtimet e dukshme dhe të fillohet një plan trajtimi.

Shumica e përfitueseve vuajnë nga një sërë sëmundjesh të lidhura me problemet shëndetësore, të nevojshme për t'u identifikuar dhe trajtuar. Një pjesë e mirë e përfitueseve kanë qenë të ekspozuara ndaj seksit të pambrojtur, dhunës, kushteve të vështira të jetesës dhe traumës psikologjike.

PROBLEMET SHËNDETËSORE QË HASEN MË SHPESH TEK VIKTIMAT E TRAFIKIMIT JANË:

- Infeksione seksualisht të transmetueshme (IST-SST),
- HIV/AIDS
- Probleme të shëndetit mendor (depression, çrregullime të personalitetit, ankthe, fobi)
- Probleme gjinekologjike
- Probleme alergjike
- Probleme dermatologjike
- Probleme të sistemit tretës (gastro – intestinale)
- Dhimbjet e kokës (migrenë, sinozit)
- Hepatit
- Kirurgji (apandisit)
- Probleme dentare
- Probleme okulistike
- Abuzime me substancat

Viktimat e trafikimit duhet të kryejnë analiza të përgjithshme, si ekzaminime mjekësore dhe gjinekologjike, duke përfshirë testin e SST-ve dhe HIV/AIDS (në mënyrë vullnetare), ekzaminime dentare dhe mjekime, etj.

Duhen asistuar raste gjatë periudhës së shtatzënisë, lindjes dhe pas saj duke ofruar kujdes mjekësor të veçantë për bebet. Në konsideratë duhen pasur edhe rastet të cilat kanë nevojë për kujdes mjekësor të veçantë, siç janë ndërhyrje kirurgjikale apo probleme të tjera serioze.

Rastet me probleme të shëndetit mendor duhen asistuar nga profesionistë të shëndetit mendor. Një kujdes i veçantë mbi çështje të shëndetit i jepet fëmijëve të viktimave të trafikimit.

Për viktimat e trafikimit duhet të zhvillohen gjithashtu aktivitete edukuese për shëndetin, sëmundjet, shkaqet dhe kurat e mundshme. Këto aktivitete informuese dhe edukuese ndihmojnë përfitueset për t'u informuar rreth SST-ve, metodave kontraceptive, viruseve sezonale, standardeve të higjienës, çështjeve shëndetësore, etj.

ASISTENCA MJEKËSORE E MËPOSHTME DUHET TË SIGUROHET PËR TË GJITHA RASTET QË AKOMODOHEN NË QENDËR:

1. Analiza rutinë
 - Analiza gjaku
 - Analiza të Hepatit (HbsAg)
 - Analizë urine
 - Strishë vaginale (ekzaminim për SST)
2. Kontroll i përgjithshëm mjekësor
3. Testi i HIV/AIDS (mbi baza vullnetare)
4. Kujdesi i para dhe pas lindjes
5. Trajtim sipas nevojave për rastet me probleme të shëndetit mendor
6. Trajtim i rasteve që përballen me abstinencën

Trajnimi profesional

Trajnimi profesional është një element i rëndësishëm i planit të riintegrit pasi ndihmon në garantimin e vazhdueshmërisë së riintegritit shoqëror të viktimave të trafikimit duke shtuar shanset e punësimit dhe duke rritur besimin e tyre si edhe aftësitë e përgjithshme jetike.

Identifikimi i trajnimeve profesionale dhe mundësive të punësimit të nevojshme për viktimat e trafikimit janë adresuar si një pjesë e rëndësishme e procesit të riintegimit për viktimat e trafikimit.

Ofruesit e shërbimeve ndihmojnë në identifikimin e mundësive dhe dëshirës së individit për të ndjekur trajnime profesionale, si dhe në këshillimin e rasteve duke i orientuar për mundësitë e trajnimeve dhe mundësitë e punësimit.

Shumë prej përfitueseve nuk kanë pasur eksperiencë pune të mëparshme dhe për të pasur sukses në punësimin e tyre ato kanë nevojë për trajnime profesionale në mënyrë që të ndërtojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre

Viktimat e trafikimit ndihmohen nga edhe nga organizatat për përfitimin e kurseve të formimit profesional falas por edhe nga Qendrat e Formimit Profesional sepse ato përfitojnë disa kurse të formimit profesional falas nga shteti.⁹⁴

Në përgjithësi kurset që viktimat e trafikimit kanë marrë në Shqipëri janë: gjuhë të huaja (kryesisht anglisht dhe italisht), kompjuter, kuzhinë, pastičeri, parukeri, rrobaqepësi, kujdestari fëmijësh, punëtore shtëpie dhe kurs për plan biznesi.

Kurset dhe trajnimet profesionale duhet të jenë të individualizuara në bazë të nevojave, aftësive dhe dëshirave të përfitueseve.

Ofruesit e shërbimit duhet të respektojnë të drejtën e viktimës për të marrë vetë vendimet për të ardhmen e saj, në këtë rast për formimin profesional.

Ndihma për punësim

Punësimi është faktor kyç për fuqizimin e viktimave të trafikimit dhe si rrjedhojë për riintegrimin e tyre në jetën normale.

Viktimat e trafikimit kanë nevojë dhe duhen asistuar në:

- Gjetjen e një pune të sigurt dhe me kushte normale.
- Rritjen e aftësive për të kërkuar punë si: përgatitja e CV-së, letrës së kërkesës për punë, përgatitja për intervistën.

⁹⁴Urdhër nr. 782, datë 04.04.06, i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale "Për tarifën e Sistemit të Formimit Profesional".

- Mbajtjen e punës.
- Këshillimin për stabilitetin në punë.
- Zgjidhjen e problemeve me punëdhënësin dhe kolegët.
- Identifikimin dhe mbulimin e çdo nevojë të veçantë të përfitueseve, veçanërisht ato të lidhura me shqetësimet e sigurisë, etj.
- Ofrimin e informacionit për tregun e punës si dhe mundësitë e ndryshme që ekzistojnë.
- Vendosjen e kontakteve me institucione të ndryshme shtetërore që mund të ndihmojnë në aspektin e punësimit si p.sh me Zyrat Rajonale të Punësimit.
- Zyrat Rajonale të Punësimit ndihmojnë nëpërmjet përfshirjes së viktimave të trafikimit në programet e nxitjes së punësimit.

KUJDES PËR SIGURINË DHE INTIMITETIN

E drejta e viktimës për intimitet duhet të respektohet gjithmonë. Punëdhënësit të tanishëm ose punëdhënësit të mundshëm nuk duhet t'i tregohet për përvojën e trafikimit që ka kaluar viktimja ose aspekte të tjera të së kaluarës të saj që nuk kanë të bëjnë me punën që propozohet. Kjo jo vetëm dhunon të drejtat e viktimës, por shton edhe rreziqet për sigurinë e saj.

Aktivitete që sjellin të ardhura

Aktivitetet që sjellin të ardhura dhe grantet/mikrokreditë për krijimin e bizneseve të vogla janë mënyra të efektshme për rritjen e pavarësisë së viktimës.

Jo të gjithë viktimat e trafikimit mund të bëhen sipërmarrës të mirë. Shpesh viktimat e trafikimit janë në moshë të re dhe pa përvojë dhe nuk kanë përkushtimin e nevojshëm për të filluar një biznesi. Duhet të tregohet kujdes që viktimat të mos shtyhen të nisin biznesin e tyre, pasi dështimi mund të ketë pasoja për respektin që ka viktimja për veten dhe mund të shkaktojë depresion.⁹⁵

Punësimi dhe mbajtja e punës për viktimat e trafikimit është e vështirë për shkak të një sërë faktorësh si kushtet e vështira të punës, informaliteti, pagesat e ulëta, oraret e zgjatura të punës, stigmatizimi etj.

- Vetëpunësimi shihet si një alternativë e mirë dhe me shumë elemente pozitive.
- Ngritja e biznesit personal ndikon në ngritjen e vetëvlerësimit sepse përfitueset e ndiejnë që kanë bërë një gjë të madhe, ndihen më të pavarura dhe më të sigurta për të ardhmen e tyre.

⁹⁵IOM. Manuali i IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Tiranë, 2007.

- Përfitueset janë më të motivuara të përmirësojnë cilësinë e punës dhe të rrisin aftësitë profesionale, gjë që rrit qëndrueshmërinë e tyre në tregun e punës.

PRAKTIKË NË SHQIPËRI

Në Shqipëri u aplikua për herë të parë skema e mikrokredisë për viktimat e trafikimit nga OSBE dhe ILO, në bashkëpunim të ngushtë me qendrat që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit duke u mbështetur me trajnime dhe asistencë teknike nga Fondacioni Besa.

Rastet që u referuan ishin raste me të cilat ishte punuar shumë më përpara se të futeshin në skemën e mikrokredisë nga qendrat, si për arsimimin, formimin e tyre profesional ashtu edhe për të marrë një eksperiencë profesionale.

Përfitueset e rekomanduara për mikrokredinë, të cilat kanë pasur vullnet për të ngritur bizneset e tyre, i përkasin një grupmoshe më të rritur krahasuar me grupin e rasteve që trajtojnë qendrat. Ato janë përfituese që zakonisht kanë një lloj mbështetje familjare. Ato ose kanë krijuar familjet e tyre ose kanë marrëdhënie të mira me familjet dhe kanë një lloj mbështetje të qëndrueshme prej tyre. Përfitueset vijnë nga rrethe të ndryshme dhe bizneset i kanë ngritur në këto qytete: Tiranë, Vlorë, Elbasan, Lushnjë, Lezhë.

Bizneset e ngritura nga këto përfituese janë parukeri, dyqan konfeksionesh, dyqan rrobash.

Edukimi dhe shkollimi

Edukimi dhe rikthimi i viktimave të trafikimit në sistemin shkollor është një nga përparësitë për një riintegrim të suksesshëm për viktimat e trafikimit. Shumë nga rastet e trafikuar e kanë ndërprerë në mes shkollën për shkak të rekrutimit, disa të tjera e kanë ndërprerë më përpara për arsye të ndryshme si largësia apo sepse ju është dashur të punonin për familjen etj. Disa prej viktimave të trafikimit janë analfabete, nuk kanë bërë kurrë asnjë klasë shkollë, për këtë arsye rifutja në sistemin shkollor është shumë e rëndësishme. Ato mund ta vazhdojnë shkollën duke u regjistruar në shkollë dite, me korrespondencë, në klasat e shansit të dytë etj.

Nga të gjithë qendrat që asistojnë viktimat trafiki raportohet mbështetja që kanë dhënë Drejtoritë Arsimore në rrethe të ndryshme të Shqipërisë për të rifutur viktimat e trafikimit në sistemin shkollor.

Disa nga viktimat e trafikimit kanë qenë në gjendje të fitojnë konkurset dhe të futen në sistemin universitar.

Zhvillimi i aftësive për jetën gjatë riintegrit

Viktimave të trafikimit iu jepet ndihmë për të zhvilluar aftësi për jetën duke përfshirë këtu të lexuarit, shkrim, këndim, aftësi sociale bazë, aktivitete si punë dorë dhe aktivitete edukative. Aktivitetet edukative mund të jenë diskutime për tema të ndryshme si SST, droga, menaxhimi i konfliktit, marrëdhëniet njerëzore dhe marrëdhëniet intime etj. Vend të rëndësishëm zë këtu edhe organizimi i

orëve/ditëve muzikore, ekskursionet, aktivitetet sportive, kinemaja, lojërat sociale.

Asistenca ligjore

Viktimat e trafikimit kërkojnë asistencë ligjore, veçanërisht kur pranojnë të veprojnë si dëshmitarë në ndjekjen ligjore të trafikuesit.

Viktimat e trafikimit informohen në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre në rast të bashkëpunimit me forcat ligjore ose të pjesëmarrjes në seancat gjyqësore.

Viktimat e trafikimit që janë dëshmitare duhet të përgatiten para gjykimit nga një avokat/ jurist nëpërmjet:

- Dhënies së informacionit mbi rolin e saj në procedimet penale.
- Dhënies së udhëzimeve dhe këshillave në lidhje me procesin gjyqësor.

Mbështetja e viktimës dëshmitare gjatë gjykimit konsiston në:

- Ofrimin e mbrojtjes fizike dhe ruajtja e privatësisë së dëshmitarëve.
- Rregullimin e të gjitha aspekteve të nevojshme të mbrojtjes së viktimës, si p.sh. të përkthimit të përshtatshëm, dëshmisë me video dhe gjykimit me dyer të mbyllura, kur është e nevojshme.

Mbështetja e viktimës dëshmitare pas gjykimit konsiston në:

- Informimin e saj mbi rreziqet e ndryshme.
- Mundësinë e mbrojtjes nëpërmjet programit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.⁹⁶

Mbështetja e viktimës për marrjen e kompensimit konsiston në:

- Informimin e VeT-së mbi të drejtat saj për kompensim, mbi procedurat e nevojshme gjyqësore.
- Ofrimin e ndihmës ligjore falas gjatë procedimeve.⁹⁷

Nga eksperiencia është parë se rastet që kanë qenë trafikuar kanë nevojë për asistencë ligjore edhe për aspekte të tjera si ndjekje procedure divorci, shpërngulje e gjendjes civile, regjistrimi i fëmijëve

⁹⁶Ligji "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", nr. 9205, dt. 15.03.2004 dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij.

⁹⁷ICMPD. Guidelines for the Development and Implementation of a Comprehensive National Antitraficking Response. ICMPD, 2006.

të përfituesve në gjendje civile, vendosje të fëmijëve të përfitueseve në institucione, çështje të marrjes së kujdestarisë etj.

Zhvillimi i lidhjeve të ngushta mes organizatave joqeveritare që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe ndihmës ligjore ndihmojnë maksimalisht në mbrojtjen dhe asistencën e viktimave.

Asistenca për fëmijët e viktimave të trafikimit

Duhet të sigurohet vazhdimisht asistencë për fëmijët e viktimave të trafikimit. Ka një numër domethënës të viktimave të trafikimit të cilat janë shtatzëna apo të shoqëruara nga fëmijët e tyre kur referohen në programet e ndihmës. E rëndësishme është që të bëhen vazhdimisht përpjekje për të krijuar shërbime të reja për të adresuar në mënyrën e duhur nevojat e veçanta të këtyre grave dhe fëmijëve të tyre. Kështu, duhen përfshirë në aktivitetet e përditshme për përfitueset klasat e prindërimit (ku këto përfituese të marrin informacion të detajuar mbi zhvillimin e fëmijës, ushqyerjen, kujdesi shëndetësor) etj. Po ashtu duhen zhvilluar këshillime me viktimat e trafikimit për të adresuar çështje lidhur me kujdesin dhe lidhjen me fëmijën, të ndihmohen për regjistrimin e lindjes, informimin dhe vendosjen e përkohshme të fëmijëve të përfitueseve në institucione të kujdesit të fëmijës, fondet e ngritura për kujdesin ditor dhe ndihmën e ofruar për regjistrimin në shkollë etj.

Ndërmjetësimi me familjet

Rrjeti social i viktimave të trafikimit është shumë i dobët. Ato duhen ndihmuar për të rikuperuar si lidhjet e humbura ashtu edhe për të ngritur lidhje të reja. Viktimat e trafikimit ndihmohen në rindërtimin e lidhjeve të shëndosha sociale dhe në krijimin e mbështetjes sociale përmes vlerësimit të rrezikut të rrethanave, zhvillimit të aftësive të komunikimit ndërpersonal, si dhe nëpërmjet asistencës ndërmjetësuese për viktimat dhe familjet e tyre.

Në shumicën e rasteve, për viktimat e trafikimit është i vështirë kthimi në familje dhe arsyet kryesore janë mentaliteti dhe stigmatizimi për shkak të eksperiencës së tyre si edhe problemet e sigurisë që mund të shkaktohen për arsye se në shumicën e rasteve trafikantët janë nga zonat e tyre. Disa arsye të tjera pse viktimat e trafikimit nuk kthehen pranë familjeve janë:⁹⁸

- Mund të ndihen të dështuara sepse nuk kanë fituar para (kjo është në rastin kur ato nuk tregojnë punën e vërtetë që kanë bërë).
- Mundësitë për punësim janë shumë më të vogla në zonat e tyre dhe pagat shumë të ulëta.

⁹⁸UN-Interagency Project on Trafficking in Women and Children in the Sub-Mekong Region. Training Manual for Combating Trafficking in Woman and Children. 2001

http://www.un.or.th/traffickingProject/trafficking_manual.pdf [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

- Ato mund të kenë bërë një mënyrë tjetër jetese ku mbizotëron jetesa në qytete të mëdha, liri e pakontrolluar nga prindërit etj.
- Hasin vështirësi në ripërshtatjen me zonat e tyre rurale, me hapësira të vogla dhe të izoluara.
- Viktimat e trafikimit nuk i ndajnë zakonisht eksperiencat e tyre me njerëzit e familjes apo të afërmit sepse ndihen të turpëruara. Këto raste e kanë shumë të fuqishme ndjenjën e turpit për shkak të eksperiencave traumatike. Edhe komuniteti i sheh si persona të papërshtatshëm për t'u martuar dhe për më shumë si persona që mund të kenë efekt çoroditës për të rinj të tjerë. Një mjedis i tillë i stimulon ato për t'u vetëtrafikuar.
- Gjejnë një mjedis familjar të ndryshuar dhe fillojnë të ndihen të prekur sepse kanë ndjesinë se ekzistojnë vetëm për t'ju shërbyer prindërve apo pjesëtarëve të tjerë të familjes etj.

Familja është baza e shoqërisë njerëzore dhe në rastin e viktimave të trafikimit përbën një nga shtyllat kryesore në procesin e riintegritimit të tyre. Vendosja e marrëdhënieve ose ribashkimi me familjen mund të kërkojë kohë dhe është pjesë e planit riintegrues të hartuar ndërmjet menaxherit të rastit dhe viktimës së trafikimit.

Një herë një viktimë trafikimi e asistuar në programet e ndihmës po përballej me vështirësi të shumta në komunikimin me familjen e saj. Në fillim ishte e vështirë nga familjarët të kuptohej se ajo ishte një viktimë e trafikimit dhe nuk kishte faj për atë që i kishte ndodhur.

Pas një periudhe, me ndihmën e punës ndërmjetësuese që bënë punonjësit e ndihmës me familjen, ata komunikuan më në fund me vajzën e tyre, por nuk pranonin që ajo të shkonte në shtëpi qoftë edhe për një ditë për shkak të stigmës nga komuniteti. Kështu që ata ranë dakord që ajo të vinte një natë në shtëpi por të hynte pasi të ishte errësuar dhe të largohej në mëngjes herët pa u gdhirë mirë në mënyrë që të mos e shikonte asnjë person nga fshati.

Menaxheri i rastit ndihmon me mënyra të ndryshme për të ndërmjetësuar mes familjes dhe rastit. Në shumë raste familjet hasin rezistencë qoftë edhe për të biseduar në telefon me rastet që kanë kaluar një eksperiencë trafikimi kështu që menaxheri i rastit mund të bisedojë në fillim me familjarët rreth programit çfarë i ofrohet vajzës/gruas, përfitimet, përmirësimet, si familja mund të kontribuojë në plotësimin e ndihmës dhe në riintegrimin e plotë të së bijës apo gruas së tyre, kontakti që do të mbajë me persona të organizatës/institucionit etj. Po ashtu VeT duhet të marrë seancat e duhura të këshillimit për sa i përket aspektit emocional, social - ekonomik dhe psikologjik të ribashkimit me familjen.

3.4 SIGURIA DHE MARRJA E MASAVE MBROJTËSE⁹⁹

Krijimi i një mjedisi të sigurt për viktimat e trafikimit dhe personelin nis me vlerësimin e rrezikut. Vlerësimi i mirë i rrezikut përfshin një **vlerësim të përgjithshëm të rrezikut**, rishikime të vazhdueshme të tij dhe vlerësime të veçanta për t'iu përgjigjur ngjarjeve të veçanta. Është e rëndësishme të kemi parasysh se ky proces është mirë të kryhet në bashkëpunim me autoritetet vendore e kombëtare të strukturave të zbatimit të ligjit. Nëse organizata juaj nuk ka kapacitete të tilla, atëherë të dhënat e mëposhtme mund t'i marrë nga policia, OJF-të vendase ose ndërkombëtare, etj.

- Shtrirja dhe ndikimi i trafikimit në vend
- A është vendi në fjalë vend burimi, tranziti apo destinacioni, apo ndonjë kombinim i tyre?
- Sa viktima trafikimi mund të kërkojnë ndihmën e organizatës që ofron shërbime?
- Në çfarë mase kontrollohet trafikimi nga grupet e organizuara kriminale?
- Kapaciteti i njohur ose i pritshëm i tyre për të planifikuar dhe vënë në jetë ndëshkime për viktimat dhe/ose personelin e organizatave që ofrojnë shërbime
- Kapaciteti i strukturave vendase të zbatimit të ligjit
- Përhapja e korrupsionit dhe ndikimi i tij në nivelin e rrezikut
- Niveli i angazhimit dhe i mbështetjes së qeverisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Çdo organizatë që ofron shërbime ka përgjegjësinë e ndjekjes së një **procesi të vazhdueshëm të vlerësimit të rrezikut**, pasi një vlerësim i vetëm nuk mjafton. Ai duhet bërë të paktën një herë në muaj, çdo javë ose dhe çdo ditë gjatë periudhave me rrezikshmëri të lartë. Gjithashtu, sa herë ka ngjarje të veçanta, të cilat përbëjnë një rrezik më tepër ose e shtojnë atë, kërkohet një **rishikim specifik i vlerësimit**. Lista e mëposhtme, pa qenë gjithëpërfshirëse, rreshton disa nga këto ngjarje.

- Momenti kur një viktimitë i drejtohet për herë të parë një organizatë që ofron shërbime për ndihmë, sidomos në qoftë se parashikohet që paketa e ndihmës të përfshijë pranimin në një qendër strehimi dhe/ose bashkëpunimin me forcat e zbatimit të ligjit.
- Çdo lëvizje e asistuar e viktimave në rastet kur ata kanë bashkëpunuar me forcat e zbatimit të ligjit dhe kur ka arsye për të besuar që trafikantët kanë dijeni për këtë.
- Çdo lëvizje e planifikuar e viktimave që trajtohen në qendrat e strehimit, jashtë qendrës për të shkuar në spital, klinikë ose në takime të tjera për ndihmë mjekësore ose sociale.
- Çdo viktimitë për të cilën kujdeset organizata që ofron shërbime, që bashkëpunon me forcat e zbatimit të ligjit; çdo lëvizje e saj për të shkuar në takime që kanë të bëjnë me këtë bashkëpunim,

⁹⁹Ky seksion është përshtatur nga Manuali i IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Tiranë, 2007.

si vajtje në mjediset e tyre për të dhënë deklarata ose për të bërë identifikim personi, ose për t'iu nënshtruar analizave mjekësore të policisë.

- Vajtja në mjediset e gjykatave, sidomos kur viktimë është e planifikuar për të dëshmuar në gjyqin e trafikantëve, veçanërisht kur trafikantët e dinë, janë njoftuar për këtë, në kuadër të të drejtave të tyre si persona të akuzuar.
- Çdo lëvizje e viktimës ose e pjesëtarëve të personelit që ka të bëjë me transferimin e viktimës nga një vend në tjetrin për të dëshmuar kundër trafikantëve në vendin tjetër.
- Çdo incident që mund të interpretohet si përpjekje për të trembur viktimën ose një pjesëtar të personelit, si telefonata anonime ose kërcënuese, telefonata të vazhdueshme të heshtura, prania e zgjatur e personave ose makinave të panjohura para qendrës së strehimit, ose ndjekja haptas në distancë e viktimës ose pjesëtarëve të personelit.

Të gjitha llojet e mësipërme të vlerësimit të rrezikut duhet të shoqërohet me një plan për menaxhimin e rrezikut. Çdo procedurë duhet të dokumentohet plotësisht dhe i gjithë dokumentacioni duhet të trajtohet si sekret dhe në përputhje me praktikat më të mira për trajtimin dhe sigurinë e të dhënave konfidenciale dhe atyre të trafikimit.

Ky trajtim tepër konfidencial i informacionit është veçanërisht i rëndësishëm dhe duhet të ndjekë parimet e mëposhtme:

- Të dhënat i bëhen të ditura, si brenda dhe jashtë organizatës, vetëm atyre personave të cilët gëzojnë të drejtën dhe kanë nevojë për to.
- Këto të dhëna nuk i jepen askujt pa miratimin e mirëinformuar dhe me shkrim të viktimës në fjalë.
- Edhe në këtë rast, personeli vlerëson përmbajtjen e të dhënave për t'u siguruar që nxjerrja e tyre nuk e rrit rrezikun që i kanoset viktimës, apo personave të tjerë që kanë lidhje me të, të afërmve, personelit.
- Kopjet në letër të informacionit mbahen të kyçura dhe kur nuk nevojiten më duhet të shkatërrohen plotësisht.

Në takimin e parë me viktimën duhen pasur parasysh këto detaje:

- Në lidhjen me telefon merrni hollësi të plota sesi ta takoni dhe vendosni një sistem kontakti, por pa i dhënë adresën tuaj. Shënoni orën e telefonatës dhe të dhëna të tjera që morët nga ajo dhe kujdesuni se kë keni përreth.

- Në takimin e organizuar përmes një organizate tjetër vërtetoni të dhënat dhe historinë e rastit, lini takim për intervistë dhe sigurohuni që stafi i kësaj organizate të mos të japë informacion më shumë se ato më lart.

Në intervistat me viktimën duhen pasur parasysh këto detaje:

- Mundësisht të bëhen jashtë zyrës.
- Të bëhen vetëm duke lënë takime.
- Viktima të kontrollohet tek dera me mjetet që dispononi.
- Të jetë në dijeni të paktën një person tjetër i organizatës që ju po kryeni intervistë.
- Nëse intervista zhvillohet jashtë zyrës, duhet të jenë të paktën dy anëtarë të personelit.
- Nëse zhvillohet në mjediset e organizatës referuese, të jetë i pranishëm të paktën edhe një pjesëtar i stafit.
- Në mjedise të tjera shtetërore duhet të jetë në ndërtesë të paktën dhe një pjesëtar i stafit të atij mjedisi.
- Asnjëherë të mos zhvillohet intervista në një adresë të dhënë nga viktima.¹⁰⁰

3.5 KËSHILLIMI

Në punën me viktimat e trafikimit, termi këshillim merr një kuptim më të gjerë sesa këshillimi psikologjik. Për t'i ndarë këto terma nga njëri-tjetri, për të dytin do të përdorim termin më të zakonshëm në këtë fushë të praktikës, **këshillimi individual**. Punonjësi social që trajton rastin, në praktikën e përditshme shpesh do të jetë edhe menaxheri i rastit, edhe këshilluesi individual i viktimës. Menaxheri i rastit/punonjësi social i rastit është personi që merr përsipër ndjekjen e rastit, duke identifikuar të gjithë larminë e nevojave që ai ka, përfshi ato mjekësore, financiare, etj, formulon synimet afatshkurtra, mobilizon burimet, planifikon dhe monitoron ndërhyrjet (këto çështje u trajtuan në detaje në nënkapitullin 3.3). Lloji dhe numri i detyrave që do t'i caktohen atij do të varen nga sasia dhe cilësia e burimeve njerëzore të organizatës.

Më poshtë renditen fillimisht disa rregulla dhe rekomandime që duhet të zbatohen nga punonjësit si në rolin e menaxherit të rastit, ashtu edhe në atë të këshilluesit individual. Më tej do të fokusohemi tek ky rol specifik i punonjësit social si këshillues individual, i cili kërkon një nivel të caktuar trajnimi për grupin përkatës. Në punën me fëmijët viktimë të trafikimit duhet të merren këshillues që janë trajnuar për të punuar posaçërisht më fëmijët.

¹⁰⁰Për informacion të mëtejshëm mbi çështjet e sigurisë të stafit shih kapitullin 4, seksionin 4.1.

1. Që në takimin e parë sigurojuni viktimave të trafikimit informacionin e domosdoshëm rreth organizatës që përfaqësoni dhe asistencës që mund t'iu jepet.
2. Viktimës së trafikimit i duhen shpjeguar të drejtat dhe përfitimet nga programi i ndihmës riintegruese.
3. Viktimës së trafikimit i duhet shpjeguar se ajo është e sigurt dhe se i gjithë informacioni rreth saj trajtohet në mënyrë konfidenciale.
4. Kurrë mos e trajtoni atë si viktimë ose në një farë mënyre si të fajshme; ndiqni parimin që krimineli është i fajshëm dhe jo ajo.
5. Kurrë mos i drejtoni kufijtë tuaj zyrtarë drejt viktimës së trafikimit; ruajeni sekretin tuaj.
6. Kurrë mos u përpiqni të gjeni të gjithë të vërtetën rreth viktimës së trafikimit.
7. Komunikoni me respekt, në mënyrë të natyrshme dhe të ngrohtë. Respektoni të drejtën e saj për lirinë e zgjedhjes.
8. Pranojeni ashtu si është.
9. Mos qëndroni si dëgjues i heshtur dhe pasiv. Gjithmonë bëjeni atë të ndiejë se jeni i interesuar në historinë e saj.
10. Kurrë mos u përpiqni të zgjidhni problemet e viktimës së trafikimit ashtu siç dëshironi vetë. Përpiquni ta lehtësoni nga dhimbja shpirtërore, në mënyrë që ta bëni të aftë të vendosë vetë e t'i zgjidhë vetë.
11. Kurrë mos jepni këshilla.
12. Mos i jepni opinionet tuaja ose mënyrën tuaj të zgjidhjes së problemit viktimës së trafikimit. Mos e fajësoni, mos e detyroni.
13. Mos e gjykoni.
14. Mos e ndërprisni.
15. Mos e ndryshoni subjektin e bisedës, mos shfaqni shenja mërzitjeje rreth ndonjë çështjeje të viktimës.
16. Mos bëni përgjithësime.
17. Mos nxirrni përfundime.
18. Mos injoroni pyetjet e viktimës.
19. Përpiquni të kuptoni situatën e viktimës dhe gjendjen e saj emocionale.
20. Flisni për ndjenjat e saj. Bëni një lidhje të ndjenjave të saj me çështjen e bisedës, ngjarjet dhe personat.

21. Përpiquni të ngrini vetëvlerësimin e saj dhe të përmirësoni marrëdhëniet e saj me njerëzit.

22. Përmirësoni aftësitë tuaja profesionale, merrni pjesë në seminare, ëorkshop-e dhe në shkëmbime eksperiencash.

Këshillimi individual me personat e trafikuar

Sipas Manualit të IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit, këshillimi individual i viktimave përbëhet nga ndërhyrje relativisht të shkurtra që fokusohen në zgjidhjen praktike të problemeve dhe sjelljen. Synimi i këshillimit individual është ta ndihmojë viktimën e trafikimit të përballojë dhe të përshtatet me rrethanat e momentit në mënyrë që të rimëkëmbet plotësisht.

Këshillimi afatshkurtër duhet të dallohet qartë nga psikoterapia. Këshillimet janë ndërhyrje afatshkurtra që synojnë ta ndihmojnë viktimën të përballlet me situata specifike të jetës dhe me hapat vijues në procesin drejt rimëkëmbjes dhe në asnjë mënyrë nuk synon të riorganizojë personalitetin e personit.

Në manual sugjerohet se shtrirja dhe lloji i çështjeve që trajtohen në seancat e këshillimit varet nga gjendja, përvoja, rrethanat, sfondi kulturor, mosha, gjinia dhe nevojat e viktimës së trafikimit. Në përgjithësi bëhen ndërhyrje afatshkurtra që fokusohen tek nevojat kryesore dhe më realiste të personit në fjalë.

Për shumicën e viktimave seancat e këshillimit merren me strategjitë për zgjidhjen e problemeve, me mekanizmat e përballimit të tyre dhe lidhjen me çështjet e mëposhtme, të cilat përbëjnë shqetësimin kryesor për viktimën:

- Rivendosja e stabilitetit dhe e mirëqenies emocionale dhe fizike.
- Siguria vetjake dhe ajo e personave të familjes; mbrojtja nga trafikantët.
- Shmangia e dënimeve penale dhe e sanksioneve të tjera.
- Bashkëpunimi me agjencitë e zbatimit të ligjit në proceset ligjore kundër trafikantëve.
- Nëse duhet dhe si duhet të kontaktohen pjesëtarët e familjes në mënyrë që VeT të kthehet në komunitetin nga vjen dhe në familje.
- Reagimi i mundshëm nga familja dhe pjesëtarët e komunitetit ndaj mungesës dhe kthimit të mundshëm të viktimës së trafikimit.
- Koha e nevojshme për të plotësuar dokumentacionin, dokumentet administrative dhe procedurat e nevojshme ligjore.
- Ku dhe me kë do të jetojë.
- Mjetet financiare të mbështetjes dhe të vazhdimësisë.

- Rikuperimi nga ngjarjet traumatike të jetës
- Stabilizimi emocional dhe përmirësimi i mirëqenies psikologjike
- Problemet me gjumin dhe ëndrrat e tmerrshme
- Krizat
- Marrëdhëniet ndërpersonale
- Zgjidhja e konflikteve
- Trajtimi i mungesës së marrjes së drogës
- Motivimi
- Ndjenjat e fajit
- Rritja e vetëvlerësimit
- Forcimi i besimit tek të tjerët, sidomos tek personat e ndihmës
- Marrëdhëniet e dashurisë
- Marrëdhëniet me familjen
- Problemet shëndetësore
- Mundësitë për punësim dhe mbajtja e vendit të punës
- Jeta e pavarur
- Planet për të ardhmen

Parime të këshillimit dhe roli i këshilluesit

Po në këtë Manual sugjerohet që këshilluesi të ndjekë parimin e mëposhtëm, ku dhe bazohet roli i tij specifik:

Viktimave iu duhet dhënë ndihmë dhe mbështetje për:

- Të formuar ose rindërtuar kompetencat, mekanizmat e përballimit dhe aftësitë vendimmarrëse.
- Të zhvilluar burimet e veta që të kuptojnë potencialin vetjak.
- Të formuar zgjidhje praktike sipas nevojave dhe rrethanave të tyre individuale.

Aty sugjerohet përdorimi i një qasjeje fuqizuese të punës sociale, e cila i sheh klientët si persona me pasuri vetjake dhe mundësi, si burime dhe jo si bartës dhe/ose burime patologjike. Kjo bazohet në besimin se klienti mund t'i kuptojë më mirë problemet e veta dhe është personi më i aftë për të hartuar dhe zbatuar një plan për zgjidhjen e këtyre problemeve. Si rrjedhim, detyra e këshilluesit fokusohet tek rindërtimi i vlerësimit për veten dhe bazohet tek burimet vetjake për t'i ardhur në ndihmë viktimës që ta kontrollojë jetën e vet dhe të jetë e aftë për t'i marrë vetë vendimet.

Pra, roli i ndihmuesit është të asistojë VoT-në në hartimin dhe zbatimin e një plani që e ndihmon atë në identifikimin dhe në zgjidhjen e problemeve dhe në artikullimin dhe arrijten e synimeve.

- Si aftësues, këshilluesi ndihmon VoT-në në identifikimin e nevojave, përcaktimin e synimeve, njohjen e pikave të saj të forta dhe e ndihmon atë të gjejë zgjidhje për problemet dhe mënyra për arrijten e synimeve.
- Si ndërmjetës/mbrojtës, këshilluesi ndihmon VoT-në në identifikimin e burimeve të disponueshme, e ndihmon t'i vlerësojë ato dhe mundëson kontaktin me ose referimin tek burime të tjera
- Si mësues, këshilluesi zhvillon aftësitë dhe bazën e informacionit të VoT-së që ajo të jetë më e aftë për të marrë vendime të mirinformuara, të zgjidhë problemet e veta ose të arrijë synimet.

Nuk është kurrë e tepër të theksohet se marrëdhëniet e këshillimit nuk janë marrëdhënie shoqërore! Këshilluesi nuk është shoku apo shoqja e viktimës, por një profesionist me ekspertizën e nevojshme dhe empatinë që e karakterizon profesionin e tij, që ndihmon VoT-në të ndihmojë veten. Ky është dhe qëllimi përfundimtar i këshillimit.

3.6 PLANIFIKIMI I MBROJTJES DHE RIINTEGRIMIT

RIINTEGRIMI I REFEROHET PROCESIT TË RIKUPERIMIT DHE PËRFSHIRJES SOCIALE PAS NJË EKSPERIENCE TRAFIKIMI.

Kjo përfshirje është shumëdimensionale dhe duhet të ndërmerret në aspektet sociale, kulturore dhe ekonomike.

Riintegrimi përfshin vendosjen në një ambient të sigurt, aksesin në standarde të arsyeshme jetese, mundësitë për zhvillim personal dhe ekonomik, si edhe aksesin në mbështetjen emocionale dhe sociale. Në shumë raste, riintegrimi përfshin kthimin e viktimës në familjen e origjinës/komunitetin e origjinës. Megjithatë mund të përfshijë gjithashtu integrimin në një vend të ri, duke u varur nga nevojat dhe interesat e viktimës.

Aspekti qendror i riintegritit të suksesshëm është fuqizimi, mbështetja e viktimave për të zhvilluar aftësi drejt arritjes së pavarësisë dhe vetëmjaftueshmërisë, si edhe përfshirja në mënyrë aktive në rikuperimin dhe riintegrimin e tyre.¹⁰¹

Duke u mbështetur tek vlerësimet individuale dhe në gjendjen e viktimës, mund të hartohet një plan i gjithanshëm për riintegrimin.

Menaxheri i rastit harton planin e riintegritit në bashkëpunim me secilin përfitues të shërbimeve. Ky plan paraqet në mënyrë të dukshme nevojat e vlerësuara të përfituesit dhe veprimet e duhura për të zgjidhur ose përmbushur këto nevoja.¹⁰² Përfituesi përfshihet në mënyrë aktive në kryerjen e vlerësimit dhe hartimin e planit të tij individual të trajtimit. Plani, i cili duhet të jetë në formë të shkruar, realist dhe i arritshëm, duhet të miratohet nga ofruesi i shërbimit dhe nga përfituesi.

Plani përfshin objektivat, aktivitetet, mjetet dhe mënyrat për t'i arritur ato, kush është përgjegjës për çdo veprim, datën e kryerjes së veprimit dhe datat e rishikimeve të bëra periodikisht. Gjatë hartimit të planit të riintegritit duhet të ndihmohen viktimat të caktojnë objektiva realiste që i përshtaten jo vetëm nevojave, aftësive dhe kualifikimeve vetjake, por edhe mundësive që ofron vendi, rajoni, vendbanimi ku bëhet riintegrimi.

Plani i riintegritit mund të rishikohet e të ndryshohet sa herë që nuk është i aplikueshëm për përfituesen, p.sh kur shihet se përfituesja nuk po bën progres.

Plani i riintegritit duhet të hartohet në mënyrë të shkruar midis ofruesit të ndihmës dhe viktimës së trafikimit. Ekipi shumë-disiplinor i përbërë nga punonjësi social, psikologu, mësuesi, mjeku dhe juristi jep kontribut në vlerësimin dhe zbatimin e planit. Format i planit të riintegritit mund të ndryshojë rast pas rasti sepse, siç është theksuar më sipër, ai duhet të jetë një plan i individualizuar dhe t'i përshtatet nevojave dhe mundësive të rastit.

Komponentët kryesorë të një plani riintegrimi mund të jenë:

- Mirëqenia psikologjike e përfitueses/Këshillimi Psikologjik
- Aspekti shëndetësor/mjekësor
- Komponentët financiarë

¹⁰¹Surtees, R. Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Europën Juglindore. OstWest Media: 2007.

¹⁰²Standarti 2: Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesjes për përfituesin në Standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale, të miratuar me VKM 195, dt. 11.4.2007.

- Komponentët ligjorë
- Përfshirja në aktivitete edukative dhe formuese
- Aktivitetet sociale
- Arsimimi, trajnimi profesional
- Punësimi
- Veprimtaritë që sjellin të ardhura
- Siguria

Formati i planit të riintegrit mund të përfshijë:

1. Qëllimin
2. Objektivat
3. Periudhën e zbatimit
4. Aktivitetet dhe mjetet për zbatimin e tij
5. Personat përgjegjës
6. Rezultatet
7. Treguesit për monitorimin e planit

Asistenca për riintegrimin e viktimave të trafikimit planifikohet të realizohet në tre faza:

- **Faza I** - Asistenca fillestare (akomodimi në një qendër ose në alternativa të tjera jorezidenciale).
- **Faza II** - Asistenca afatmesme (jeta gjysmë e pavarur për përfitueset).
- **Faza III** - Asistenca afatgjatë (jeta e pavarur për përfituesen).

Duke theksuar rëndësinë që ka secila nga fazat e mësipërme në procesin e riintegrit, është thelbësore që plani i riintegrit të çdo përfitueseje të ndërtohet në bazë të objektivave që do të realizohen në secilën fazë të tij.

Çdo plan individual fillon të zbatohet nëpërmjet punës individuale dhe në grup me përfituesen, punës me familjen, komunitetin, institucionet dhe organizatat që mund të kontribuojnë në zbatimin e planit.

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë grafike hapat që ndiqen për dhënien e ndihmës për rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit.

Fazat e procesit të ndihmës

| Faza I-Asistenca Fillestare | Faza II-Ndihma afatmesme | Faza III-Ndihma afatgjatë |
|--|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> ■ Identifikim i nevojave të përfitueses (dhe fëmijës së saj), si nevojat mjekësore, psikologjike, sociale, etj. ■ Ofrim i shërbimeve në përgjigje të nevojave të identifikuara të VeT-së. ■ Strehim. ■ Asistenca mjekësore. ■ Vlerësime dhe këshillime psiko-sociale. ■ Mbështetje dhe asistencë ligjore. ■ Negocim/ndërmjetësim me familjen kur rastet duan të rivendosin marrëdhënie të shëndetshme me familjen e tyre. ■ Asistencë dhe mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit. ■ Menaxheri i rastit, në bashkëpunim me përfituesen, ndërtojnë profilin dhe planin e riintegritimit nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> - intervistave - seancave të këshillimit. ■ Kurse/trajnime profesionale. ■ Përgatitje për vazhdimin e sistemit edukues/shkollës. ■ Kurse analfabetizmi. ■ Këshillime dhe ndihmë për punësim. ■ Aktivitete për rritjen e aftësive. ■ Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive. | <ul style="list-style-type: none"> ■ Asistencë për punësim dhe mbajtjen e punës. ■ Strehim në apartamente të monitoruara ose mbështetje financiare për strehim. ■ Përfitim në vazhdim i shërbimeve të riintegritimit. ■ Programe pune që gjenerojnë të ardhura. ■ Punonjësit socialë - asistencë të vazhdueshme psiko-sociale për përfitueset në apartamente dhe në familje. ■ Rishqyrtim i progresit të përfitueses në fusha të ndryshme. ■ Shqyrtim i rrezikut dhe ofrim i mekanizmave mbështetës. ■ Sigurimi i monitorimit dhe i vlerësimit të procesit të rehabilitimit/ri-integritimit. | <ul style="list-style-type: none"> ■ Ofrim i ndihmës për riintegrim nëpërmjet familjes/ komunitetit. ■ Informacion mbi shërbimet dhe burimet e disponueshme në komunitet, kontaktet e nevojshme/hartën e shërbimeve. ■ Ndihma e rasteve për krijimin dhe forcimin e marrëdhënieve me institucionet e ndihmës në komunitetin ku po jeton. ■ Monitorimi dhe follow up |

3.7 MONITORIMI/FOLLOW-UP

Monitorimi dhe ndjekja e mëtejshme e viktimave të trafikimit është shumë e rëndësishme në mënyrë që të sigurohet që procesi i riintegritimit po shkon mirë dhe të asistohet rasti në qoftë se ka nevojë apo po përballet me ndonjë vështirësi.

Monitorimi dhe ndjekja e rastit bëhet me qëllim që:¹⁰³

- Të kontrollohet nëse VeT vazhdon të jetë në familje kur ajo është kthyer në familje (parandalon ritrafikimin).
- Të vëzhgohet ndihma që familja i ofron të rikthyerës.
- Të shihet reagimi i komunitetit.
- Për rastet që po jetojnë në mënyrë të pavarur (p.sh në apartamente) të shikohet se si po ecin.
- Të ofrohet mbështetje emocionale, mundësi trajnimi dhe punësimi kur është e nevojshme.
- Të dëgjohen përjetimet dhe planet.
- Të evidentohen vështirësitë që po kalon.
- Të informohet VeT rreth çështjeve që i interesojnë.
- Të matet deri diku se sa i sigurt është rasti.

Vizitat e follow up-it ofrojnë feedback për programin lidhur me aspektet që kërkojnë përmirësim. Ato ofrojnë mundësi për të vlerësuar progresin dhe rezultatet e ndihmës, problemet që mund të hasen, përshtatjet e nevojshme etj.¹⁰⁴

Monitorimi dhe ndjekja e ish viktimave të trafikimit realizohet përmes vizitave dhe këshillimeve me to. Ndjekja bëhet për përfitueset që kanë filluar të jetojnë në mënyrë të pavarur (janë nëpër apartamente), si dhe për përfitueset që janë kthyer në familjet e tyre.

Monitorimi realizohet me anë të vizitave të punonjëseve të ndihmës në familjet apo apartamentet ku banojnë VeT. Gjatë vizitave monitoruese vlerësohen nevojat e rasteve por edhe jepet asistencë për:

- Marrëdhëniet shoqërore.
- Marrëdhëniet e vendosura me anëtarët e familjes.
- Vlerësohet rreziku i ritrafikimit.

¹⁰³UN-Interagency Project on Trafficking in Women and Children in the Sub-Mekong Region. Training Manual for Combating Trafficking in Woman and Children. 2001

http://www.un.or.th/traffickingProject/trafficking_manual.pdf [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

¹⁰⁴Key points from SC (UK) Manual Working with separated children. 1998; Personal Communication with IOM representative, 2001.

- Problemet me përshtatjen në komunitetin ku po jetojnë.
- Gjendjes së punësimit.
- Nivelit të përgjithshëm të riintegritimit.
- Cilësisë së jetës në përgjithësi.
- Probleme të shëndetit.
- Pakënaqësitë me mjedisin.
- Për të marrë informacion të ri.
- Gjendjen psikologjike.
- Etj.

Aktivitete të ndryshme që zhvillohen për përfitueset në kuadër të aktiviteteve monitoruese të procesit të riintegritimit janë:¹⁰⁵

- Aktivitete për menaxhimin e kohës dhe menaxhimin financiar.
- Aktivitete orientuese për tregun punës (nëse nevojitet ndërrimi i vendit të punës).
- Njohja e tregut të punës.
- Si të mbajnë sa më gjatë të jetë e mundur punën.
- Pjesëmarrja në aktivitete sociale të caktuara, marrëdhëniet me vajzat e tjera në Apartamente, kontaktet dhe marrëdhëniet me familjet.
- Marrëdhëniet me fëmijët e tyre (kur përfitueset kanë fëmijë).
- Ndhima që u nevojitet për të adresuar nevojat e fëmijëve të tyre.

Rastet monitorohen në familjet e tyre në mënyrë që të vlerësohet procesi i riintegritimit brenda familjes. Gjatë monitorimit bëhet vlerësimi i nevojave dhe hapave të nevojshme për adresimin e tyre. Këto raste janë ndihmuar nëpërmjet mbështetjes financiare dhe punësimit në komunitetin e tyre. Për ti ndihmuar përfitueset në këtë aspekt, ofruesit e shërbimit përpiqen për të koordinuar dhe bashkëpunuar me partnerë të ndryshëm në këto zona sidomos me anëtarët e Komiteteve Rajonale Antitrafik, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, punonjësit social të Zyrave Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, administratorët social të bashkive.¹⁰⁶

Organizatat partnere ose institucionet e tjera të trajnuara që ndodhen pranë vendit ku banon viktimat mund të japin jo vetëm ndihmë të drejtpërdrejtë për viktimat, por edhe të zbatojnë planin e riintegritimit dhe të bëjnë vlerësimin e riintegritimit. Por është shumë e rëndësishme që këto organizata/institucione të jenë të trajnuara për standardet e punës me viktimat e trafikimit.

¹⁰⁵Bazuar në eksperiencën e organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”

¹⁰⁶Për më shumë informacion për rolin e këtyre strukturave shih nënkapitullin 1.3 Korniza Institucionale.

Ndonëse viktimat e trafikimit duhet të mbështeten nga programet e riintegrit, kjo nuk është zgjidhje afatgjatë dhe është e nevojshme ti kushtohet vëmendje zhvillimit dhe kalimit në rrjete të tjera që argumentohen më të qëndrueshme. Personat e trafikuar duhet të zhvillojnë mekanizma mbështetës jashtë kornizës së asistencës antitrafik, idealisht nga familja, miqtë dhe komuniteti të cilët mund të jenë një pjesë e rëndësishme e së ardhmes së tyre. Programet e ndihmës mund të luajnë një rol në aktivizimin dhe forcimin e marrëdhënieve ndihmëse brenda mjedisit rrethues të përfitueseve, e cila mund të përfshijë organizatat që angazhohen në ndërmjetësimin me familjen, këshillimin, rritjen e ndërgjegjësimit për komunitetin ose forma të ndryshme ndihme për familjen (dhe madje edhe për komunitetin në tërësi.¹⁰⁷

¹⁰⁷Surtees, R. Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Europën Juglindore. OstWest Media: 2007.

4

*Trajtimi i viktimës
dhe kujdesi ndaj
ofruesve të
shërbimit*

4.1 STANDARDET ETIKE TË PUNËS ME VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

4.1.1 VLERAT DHE ETIKA¹⁰⁸

Vlerat janë ato besime të qëndrueshme që kemi mbi atë që preferojmë si të mirë dhe të drejtë në sjelljen dhe ekzistencën tonë si qenie njerëzore. Meqenëse lidhen me pëlqimin dhe mospëlqimin, vlerat ofrojnë bazën për dallimet mes të mirës dhe të keqes. Vlerat në praktikën e punës sociale i referohen asaj që shihet si e mirë dhe e dëshirueshme. Ato shoqërohen nga emocione dhe përfaqësojnë një qëllim drejt të cilit orientohen veprimet e punonjësit social. Vlerat institucionalizohen përmes adoptimit të normave sociale, pra, sjelljeve të pranuar si të mira dhe të dëshiruara.

Puna sociale është një profesion jo i ndarë nga vlerat. Punonjësit socialë, me besimet dhe vlerat e tyre punësohen në institucione e qendra që reflektojnë pozicione të caktuara vlerash dhe bëjnë ndërhyrje tek klientë që kanë besimet, vlerat dhe traditat e tyre. Nga ana tjetër, ekziston një dallim shumë i rëndësishëm për praktikën, mes vlerave dhe njohurive. Ndërsa vlerat i referohen asaj që preferojmë dhe çfarë bëjmë ne për të, njohuritë e paraqesin botën siç është dhe rrjedhin nga interpretimi më rigoroz i të dhënave më objektive të mundshme. Hapi i parë në praktikën e punës sociale është ndarja e asaj që puna sociale preferon apo dëshiron për njerëzit, nga ajo që puna sociale di për njerëzit. Pra *di* duhet ndarë nga *duhet*.

Vlerat janë zakonisht të përgjithshme dhe abstrakte, ndërsa etika lidhet me rregullat e sjelljes që drejtojnë veprimet në përputhje me vlerat. Vlerat merren me atë që është e mirë dhe e dëshirueshme, kurse etika merret me atë që është e drejtë dhe korrekte. Një nga veçoritë dalluese të një grupi profesional është vetërregullimi, i cili bazohet mbi vlerat dhe parimet e tij etike. Besimet dhe traditat e profesionit të punës sociale reflektohen në dy dokumentet bazë, Kodin Etik dhe Standardet për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale, rregulla të cilat përbëjnë një udhëzues për një rrjedhë të drejtë veprimi. Punonjësit socialë duhet të punojnë në praktikën e tyre të drejtpërdrejtë me klientët sipas parimeve të pasqyruara në këto dokumente.

Ky nënkaptull shqyrton vlerat, Kodin Etik të punës sociale dhe Standardet për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale, duke u fokusuar tek parimet etike bazë të punës sociale të konfidencialitetit, detyrës për të paralajmëruar ose për të mbrojtur, vetëvendosjes dhe miratimit të informuar.

¹⁰⁸Ky seksion i referohet: Bisman C., Social work practice: cases and principles. Brooks/Cole Publishing Company, 1994.

Konfidencialiteti

Konfidencialiteti është një parim etik bazë i profesionit të punës sociale, sipas të cilit punonjësi social është përgjegjës për informacionin e përfutur nga kontaktet me klientin, njohuritë e përfutura duhet të përdoren për qëllime profesionale dhe privatësia e klientit duhet mbrojtur. Komunikimet mes klientëve dhe punonjësve socialë bëhen në konfidencë dhe me besimin se ato do të mbeten të tilla. Si një pjesë thelbësore e formimit të lidhjes së besimit në marrëdhënien profesionale, klientët duhet të dinë se punonjësi social nuk do ta keqpërdorë informacionin për t'i lënduar apo tradhtuar ata. Rregulla të ngjashme etike përcaktojnë marrëdhënie të tjera profesionale, si ato me juristët, mjekët, etj.

Punonjësit socialë janë të detyruar t'i binden parimit të konfidencialitetit të Kodit të tyre Etik dhe të kufizuar nga ligji për të mos ta ndarë informacionin me të tjerët. Ligjërisht, ndonjëherë atyre mund t'iu duhet të ofrojnë informacione të tilla, për shembull në raste kur ky informacion kërkohet nga gjykata. Punonjësit janë përgjegjës për të ditur dhe qartësuar në vendin ku punojnë natyrën e rregullave që duhen respektuar. Informacioni mbi privatësinë e shënimeve është i nevojshëm për t'iu ofruar klientit këshilla të përgjegjshme për konfidencialitetin e seancave.

Të dhënat personale të përfituesit dhe mënyrat e menaxhimit të tyre¹⁰⁹

Ofruesi i shërbimit mbledh dhe ruan të dhënat personale të përfituesit duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale dhe të kujdesshme. Ofruesi i shërbimeve krijon kushte që menaxhimi i të dhënave të bëhet sipas normave ligjore dhe bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit. Trajtimi i të dhënave duhet të kryhet duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, rregulloret e ofruesit të shërbimit, si dhe në marrëveshjet dhe protokollet e bashkëpunimit me institucionet përkatëse.

- Stafi që punon me përfituesin është i detyruar të respektojë kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale dhe klasifikimin e tyre sipas rëndësisë për të mos dëmtuar përfituesin e shërbimit.
- Personat që duhet të kenë akses tek të dhënat janë stafi i ofruesit të shërbimit që përkujdeset drejtpërsëdrejti për përfituesin në fjalë, përfituesi, institucionet ligjore (organet e policisë dhe të drejtësisë). Të dhënat duhet të ruhen në një kasafortë, dollap me çelës, baza e të dhënave e ruajtur me fjalë çelës etj).

Ka dokumentacion dhe një kuadër nënligjor të shkruar mbi përdorimin e të dhënave personale, kush ka akses në këto të dhëna dhe si mund të përdoren ato.

¹⁰⁹Standardi 4: Të dhënat personale të përfituesit dhe mënyrat e menaxhimit të tyre në Standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale, të miratua me VKM 195, dt. 11.4.2007.

- Përfituesi ka akses në dosjet dhe të dhënat e tij individuale.
- Përfituesi është i informuar që informacioni në dosjen e tij/saj mund t'i vihet në dispozicion autoriteteve ligjore.
- Të dhënat konfidenciale personale të përfituesit nuk duhet të ndahen me askënd pa lejen e titullarit të institucionit dhe pa lejen e përfituesit.
- Të dhënat e përfituesit duhet të ruhen të paktën për një periudhë 5 vjeçare.
- Pas përfundimit të periudhës 5 vjeçare këto të dhëna arkivohen. Pas kësaj periudhe të dhënat më të rëndësishme për çdo përfitues ruhen në formë kompjuterike ndërsa dokumentet në formë të shkruar asgjësohen.

Detyra për të paralajmëruar ose për të mbrojtur

Parimet etike shpeshherë janë të lidhura së bashku në mënyrë të tillë që shkaktojnë përplasje dhe konflikt mes njëra-tjetrës. Në disa raste konfidencialiteti i le vendin detyrës për të paralajmëruar ose për të mbrojtur. Sipas Kodit Etik të profesionistëve që punojnë në shërbimet sociale, në rast të marrjes së një informacioni i cili vlerësohet se ka mundësi që të vendosë ose përbëjë rrezik për jetën e përfituesit apo të një personi tjetër, punonjësi është i detyruar të informojë drejtuesin e institucionit, i cili më pas duhet të informojë autoritetet ligjore.

Vetëvendosja

Vetëvendosja është parë gjithmonë si thelbësore për punën sociale, si një e drejtë, vlerë dhe përgjegjësi. Si e drejtë, ajo është thelbi i shoqërive demokratike dhe baza për të drejta dhe privilegje të tjera, si konfidencialiteti dhe privatësia. Si etikë e punës sociale, është e lidhur drejtpërdrejt me vlerën kryesore të profesionit, atë *të dinjitetit të lindur dhe vlerës së individit*.

Përfituesi përfshihet në mënyrë aktive në kryerjen e vlerësimit dhe hartimin e planit të tij individual të trajtimit. Plani, i cili duhet të jetë në formë të shkruar, realist dhe i arritshëm, duhet të miratohet nga ofruesi dhe nga përfituesi.¹¹⁰Përfituesit janë në gjendje të konfirmojnë përfshirjen e tyre në hartimin e dokumentit të vlerësimit dhe të planit të tyre individual. Përfshirja e tyre në hartimin e këtyre dokumenteve konfirmohet nga materialet e shkruara.¹¹¹

¹¹⁰Standarti 2: Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesjes për përfituesin në Standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale, të miratura me VKM 195, dt. 11.4.2007.

¹¹¹Po aty.

Çdo përfitues përfshihet në përcaktimin e aktiviteteve të cilat janë më të përshtatshme për të. Aktivitete të programuara nga OJF-të e ndryshme brenda dhe jashtë rrjetit vihen në dispozicion për të gjithë përfituesit, edhe nëse ato nuk mund të ofrohen të gjitha nga ofruesi i shërbimit. Përfituesi ka të drejtë të përzgjedhë ofruesin e shërbimit më të përshtatshëm për të, brenda zonës së tij, sipas nevojave të vlerësuara. Përfituesi miraton planin e veprimit të përcaktuar nga ai dhe nga ekipi shumë-disiplinor i profesionistëve. Përfituesi në çdo kohë informon punonjës social që ai/ajo nuk është i gatshëm të vazhdojë me këtë plan dhe dëshiron që ky plan të rishikohet ose të ndërpritet.¹¹²

Gjithsesi, për punonjësit e përfshirë në punën e përditshme me viktimat e trafikimit, kjo situatë nganjëherë mund të duket paradoksale. Shkak për këtë bëhet fakti se punonjës socialë janë si agjentë ndryshimi, që punojnë aktivisht për të bërë diçka ndryshe nga ç'ishte, ashtu edhe ekspertë, pra që kanë më shumë dije se klienti mbi disa çështje. Balancimi i aktit të ofrimit të ndihmës së ekspertit me autonominë e klientit mbetet një sfidë për çdo punonjës social. Punonjës socialë duhet të njohin tensionet politike, ideologjike dhe të praktikës që janë pjesë e pandarë e vetëvendosjes, për t'i drejtuar klientët drejt vetëvendosjes së vërtetë.

Miratimi i informuar

Për të arritur aftësinë e vetëvendosjes, viktimat e trafikimit duhet të jenë në gjendje të ofrojnë miratim të informuar. Trajtimi i klientëve si individë autonomë kërkon që ato të kenë informacionin e duhur dhe punonjës socialë duhet të përgatiten t'i informojnë klientët e tyre për natyrën dhe rrjedhën e çdo trajtimi të planifikuar.

Në standardet Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale, të hartuara nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, standardi 1 “Qëllimi dhe llojet e shërbimeve”, theksohet se:

Deklarata mbi qëllimin e shërbimit është e formuluar qartë dhe e shkruar në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të gjithë përfituesit e shërbimeve. Kjo deklaratë u vihet në dispozicion të gjithë përfituesve të shërbimit.

- Dokumente në formë të shkruar ku përshkruhet qëllimi, llojet e shërbimeve, personeli si dhe kualifikimet e tij. Këto dokumente janë vendosur në vende të dukshme.
- Deklarata shoqërohet me rregulloren e brendshme ku përcaktohen qartë dhe dukshëm rregullat, të drejtat dhe detyrimet e jetesës në qendër si për përfituesit ashtu dhe për stafin e punës.

¹¹²Po aty.

- Përfituesit sipas kapaciteteve të tyre konfirmojnë që e kanë marrë dhe kuptuar këtë informacion.
- Anëtarët e stafit janë në gjendje të informojnë gojarisht dhe me shkrim për shërbimet që ka qendra.
- Përfituesit, në përputhje me kapacitetet e tyre, konfirmojnë që e kanë marrë këtë informacion dhe e kanë kuptuar atë. Ky informacion ndodhet në formë të shkruar në dosjen personale të përfituesit.
- Dokumente të cilat shërbejnë për të informuar përfituesin mund të jenë fletëpalosje, broshura etj. Përmbajtja e tyre duhet të përfshijë përkufizimin mbi trafikimin, cili është ofruesi që ofron shërbimet, misioni i tij, qëllimi i shërbimeve, llojet e shërbimeve që janë të disponueshme për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi, grupi përfitues i shërbimeve, kur shërbimet janë falas, përshkrimin e procedurave si konfidencialiteti, siguria dhe mbrojtja e përfituesve etj, cilët janë drejtuesit e shërbimit, oraret e funksionimit të shërbimeve, si mund të kenë akses përfituesit në këto shërbime etj.
- Pranimi në qendrën e shërbimit kërkon njohjen e përfituesit me të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë kohës së akomodimit. Informimi i tij realizohet që në fillim të vendosjes së tij në institucion
- Drejtuesi i qendrës së shërbimit dhe përfituesi nënshkruajnë një kontratë për marrjen e shërbimeve në qendër dhe respektimin e rregullave dhe detyrimeve, bashkëjetesës në qendër. Kontrata është e shkruar në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshëm dhe përfituesi tregon se e ka kuptuar atë para nënshkrimit.

Gjithsesi, miratimi i informuar nuk është aq i thjeshtë të zbatohet në praktikë siç është në teori. Klientët mund të mos jenë gjithnjë në gjendje të bëjnë gjykime të informuara. Profesionistët duhet të marrin gjithnjë parasysh aftësitë e klientëve për të marrë vendime, të kuptojnë faktet, të menaxhojnë racionalisht informacionin dhe të vlerësojnë situatën e tyre. Mungesa e kompetencës nuk duhet marrë asnjëherë si e mirëqenë, për cilindo grup të popullatës. Klientët më pak të zotë, si minorenët, disa nga ata që janë të diagnostikuar me çrregullime mendore apo aftësi të kufizuara, gjithsesi duhet të vlerësohen për aq sa zotësi kanë. Kur klienti vlerësohet si i pazoti, atëherë punonjësi duhet t'i referohet legjislacionit përkatës për të zbatuar rregullat e përcaktuara në lidhje me këtë rast.

Në kontekstin e punës me viktimat e trafikimit, me gjithë vështirësitë që paraqiten, është veçanërisht e rëndësishme që çdo punonjës në kontakt të drejtpërdrejtë me to të udhëhiqet nga parimi i vetëvendosjes. Në thelb, ky parim nënkupton të drejtën e klientit për të qenë i përfshirë në çdo aspekt të ndryshimit, ndaj të cilit është subjekt, dhe jo objekt.

Bloom dhe Fisher (1996)¹¹³ rendisin disa të drejta që rrjedhin prej këtij parimi, të quajtura ndryshe “të drejtat minimale të klientit”:

¹¹³Ky kapitull i referohet: Bloom, M. dhe Fischer, J. Evaluating practice: guidelines for the accountable professional. 1996.

1. Klientët kanë të drejtë të informohen në një gjuhë të kuptueshme për ta se cili është problemi i tyre, sipas perspektivës së profesionistit të ndihmës.
2. Klientët kanë të drejtë të marrin pjesë në zgjedhjen e qëllimeve dhe objektivave të trajtimit të tyre.
3. Klientët kanë të drejtë të njohin me hollësi se çfarë do të ndodhë gjatë procesit të ndërhyrjes – kush supozohet të bëjë çfarë dhe në çfarë kushtesh.
4. Klientët kanë të drejtë dinë se sa do të zgjasë ndërhyrja (dimensionet kohore). Probabilitet ka që zgjedhja e bërë prej tyre do të çojë në zgjidhjen e suksesshme të vështirësive të tyre.
6. Klientët kanë të drejtë të dinë se sa do t'u kushtojë ndërhyrja. Edhe nëse ata nuk paguajnë menjëherë për shërbimet e marra, ata kanë po njësoj të drejtë të dinë vlerën e shërbimeve që u ofrohen.
7. Klientët kanë të drejtë të dinë se çfarë shënimesh do të mbahen dhe se kush do të ketë akses në to.
8. Klientët kanë të drejtë të dinë paraprakisht mbi mbylljen e shërbimeve.
9. Klientët kanë të drejtë të rrisin kontrollin mbi jetën e tyre nëse kanë kontroll mbi të ose të dinë (ose të dijë kujdestari i tyre) pse kur nuk është kështu.
10. Klientët kanë të drejtë të jenë pjesë dhe të informuar lidhur me vlerësimin që iu bëhet situatave të tyre.

Në standardet Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale, të hartuara nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, standardi 3 “Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfituesve” theksohet se:

- Ofruesi i shërbimit ofron informacion të vazhdueshëm mbi të drejtat e përfituesve me qëllim që ata t'i kuptojnë dhe t'i njohin ato.
- Ofruesi i shërbimit afishon forma të shkruara të të drejtave të përfituesve të shërbimeve, dhe sigurohet që nëpërmjet diskutimeve përfituesit i kuptojnë dhe i gëzojnë të drejtat e tyre.

- Stafi respekton dhe promovon të drejtat e përfituesve të shërbimit si dhe i trajton ata me respekt, ruan dinjitetin e tyre në të gjitha aspektet si në kujdesin personal, shëndetësor, aktivitetet sociale, këshillim, jetën komunitare etj.
- Këto të drejta bazohen në legjislacionin shqiptar dhe konventat për të drejtat e njeriut të ratifikuara nga shteti shqiptar. Këto të drejta janë të shprehura qartë dhe zbatimi i tyre është i monitorueshëm.

4.1.2 Kodi etik i punonjësit social

Kodi etik i punonjësit social për Shqipërinë është krijuar dhe botuar për herë të parë në vitin 2003. Ky dokument është fryt i bashkëpunimit të ngushtë mes Departamentit të Punës Sociale dhe Qendrës Shqiptare për Zhvillimin e Shëndetit Mendor. Ky kod është një mjet rregullator i etikës së sjelljes ndaj klientit, kolegëve, organizatës ku punonjësi social punon dhe shoqërisë në tërësi. Në vendin tonë zbatimi i tij ende nuk është një detyrim formal që lidh çdo punonjës social që praktikon profesionin, gjithsesi atij i referohen mjaft organizata e agjenci si për shembull Të ndryshëm, por të Barabartë, Qendra e Zhvillimit për Shëndetin Mendor dhe Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor, etj. Kodi është pranuar dhe mbështetur edhe nga Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë, krijuar në vitin 2004. Në vijim renditen disa nga përgjegjësitë etike më të rëndësishme lidhur me praktikën e punës sociale me viktimat e trafikimit, të përzgjedhura nga kapitulli i parë i këtij Kodi¹¹⁴.

Përgjegjësitë etike të punonjësve socialë ndaj përfituesve¹¹⁵

1. Përkushtim ndaj përfituesve

Përgjegjësia kryesore e punonjësve socialë është të promovojnë mirëqenien e përfituesve. Në përgjithësi, interesat e përfituesve konsiderohen si parësore. Megjithatë, në raste të veçanta, përgjegjësia e punonjësve socialë ndaj shoqërisë në tërësi apo ndaj detyrimeve specifike ligjore mund ta tejkalojë besnikërinë ndaj përfituesve dhe për këtë përfitueset duhen paralajmëruar. Një shembull mund të jetë rasti kur punonjësit social i kërkohet nga gjykata të raportojë nëse klienti ka abuzuar me fëmijën ose ka kërcënuar se do t'i bëjë dëm vetes apo të tjerëve.

¹¹⁴Departamenti i Punës Sociale dhe Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Shëndetit Mendor. Kodi etik i punonjësit social. Tiranë: Grafon, 2003.

¹¹⁵Termi original në Kod është "klientëve". Në këtë material përdoret termi "përfituesve", si më i përshtatshëm për kontekstin.

2. Vetëvendosja

Punonjësit socialë respektojnë dhe nxisin të drejtën e përfitueseve për vetëvendosje dhe i ndihmojnë ato në përpjekjet për të identifikuar dhe qartësuar qëllimet e tyre. Punonjësit socialë mund ta kufizojnë të drejtën e përfitueseve për vetëvendosje, kur sipas gjykimit të tyre profesional, veprimet konkrete apo të mundshme të përfitueseve përbëjnë rrezik serioz, kërcënues për veten apo për të tjerët.

3. Miratimi i informuar

- a) Punonjësit socialë duhet t'iu ofrojnë shërbime përfitueseve në kontekstin e një marrëdhënieje profesionale ku ekziston konsensusi. Punonjësit socialë duhet të përdorin gjuhë të kuptueshme dhe të qartë, për t'i informuar përfitueset mbi qëllimin e shërbimeve, rreziqet dhe kufizimet e lidhura me to, kostot e mundshme, alternativat e arsyeshme, të drejtën e përfitueseve për të refuzuar apo tërhequr miratimin e dhënë më parë dhe kuadrin kohor që mbulon marrëveshja. Punonjësit socialë duhet t'u sigurojnë përfitueseve mundësinë e shtrimit të pyetjeve.
- b) Në rastet kur përfitueset nuk janë të shkolluara ose kanë vështirësi në të kuptuarin e gjuhës së përdorur, punonjësit socialë duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar qartësimin e klientit. Kjo mund të përfshijë shpjegimin verbal të detajuar apo, kur është e mundur, marrjen e një përkthyesi të kualifikuar.
- c) Në rastet kur përfitueseve iu mungon aftësia për të dhënë miratimin, punonjësit socialë duhet të mbrojnë interesat e përfitueseve, duke kërkuar leje nga një palë e tretë. Në këto raste punonjësi social duhet të sigurohet që pala e tretë të veprojë në përputhje me dëshirat dhe interesat e klientit. Punonjësit socialë duhet të ndërmarrin hapa për të rritur aftësinë e përfitueseve për të bërë marrëveshje.
- d) Në rastet kur përfitueset marrin shërbime kundër vullnetit të tyre, punonjësit socialë duhet të japin informacion mbi natyrën dhe shtrirjen e shërbimeve, si dhe për të drejtën e përfitueseve për ta refuzuar shërbimin.
- e) Punonjësit socialë duhet të marrin miratimin e përfituesve që shërbimi i dhënë të mund të regjistrohet në manjetoфон ose video apo të vëzhgohet nga një palë e tretë.

4. Kompetenca

- a) Punonjësit socialë duhet të ofrojnë shërbime dhe të marrin kompetenca vetëm brenda kufijve që i lejon edukimi, trajnimi, licenca, certifikimi, konsultimi i marrë, eksperiencia e mbikëqyrur apo eksperiencia të tjera të rëndësishme profesionale.

- b) Punonjësit socialë duhet të ofrojnë shërbime apo të përdorin teknika të reja të ndërhyrjes, vetëm pas një studimi të gjatë, trajnimit, konsultimi dhe mbikëqyrjeje nga njerëz kompetentë në këto teknika dhe ndërhyrje.

5. Kompetenca kulturore dhe larmishmëria sociale

- a) Punonjëset socialë duhet të kuptojnë kulturën dhe funksionin e saj, si në sjelljen njerëzore ashtu edhe në shoqëri, duke njohur çështjet ekzistuese në të gjitha kulturat.
- b) Punonjësit socialë duhet të kenë njohuri bazë për kulturën e përfitueseve, si dhe të jenë të aftë të tregojnë kompetencë në sigurimin e shërbimeve që janë të ndjeshme ndaj kulturës së përfitueseve dhe ndaj ndryshimeve mes njerëzve dhe grupeve kulturore.
- c) Punonjësit socialë duhet të arsimohen në mënyrë që të kuptojnë natyrën e larmishmërisë sociale dhe të shtypjes në bazë të racës, etnisë, origjinës kombëtare, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, moshës, statusit civil, bindjeve politike, besimit fetar ose aftësisë së kufizuar mendore ose fizike.

6. Privatësia dhe konfidencialiteti

- a) Punonjësit socialë duhet të respektojnë të drejtën e përfitueseve për privatësi. Ata nuk duhet të kërkojnë informacion privat deri atëherë kur ky është thelbësor për ofrimin e shërbimeve. Në momentin kur jepet informacion privat, fillojnë të zbatohen standardet e konfidencialitetit.
- b) Punonjësit socialë mund ta bëjnë publik informacionin konfidencial në rastet kur kjo është e domosdoshme, me miratimin e përfitueseve ose të një personi të autorizuar me ligj për ta dhënë atë, në emër të klientit.
- c) Punonjësit socialë duhet ta ruajnë konfidencialitetin mbi të gjithë informacionin e marrë gjatë shërbimit profesional, me përjashtim të rasteve kur ka arsye profesionale detyruese për të mos e bërë këtë. Opinioni i përgjithshëm se punonjësit socialë duhet ta ruajnë konfidencial informacionin nuk qëndron në rastet kur dhënia e informacionit është e nevojshme për parandalimin e një dëmtimi serioz, të parashikueshëm dhe të mundshëm të vetë përfitueseve, apo të personave të tjerë të identifikueshëm, ose kur rregullat dhe ligjet e kërkojnë një gjë të tillë, qoftë edhe pa miratimin e klientit. Në të gjitha rastet, punonjësit socialë duhet të japin sasinë më të vogël të mundshme të informacionit të nevojshëm për përmbushjen e qëllimit (jepet vetëm informacioni që është drejtpërdrejt i lidhur me qëllimin për të cilin ky informacion po bëhet publik).
- d) Punonjësit socialë duhet t'i informojnë përfitueset për rastet e bërjes publike të informacionit konfidencial dhe për pasojat e mundshme, përpara se të bëhen të njohura të dhënat private.
- e) Punonjësit socialë duhet të diskutojnë me klientët apo me palët e interesuara, natyrën e konfidencialitetit dhe kufizimet në të drejtat e përfitueseve për konfidencialitet. Së bashku me

klientët, punonjësit socialë duhet të shqyrtojnë situatat ku mund të kërkohet të bëhet publik informacioni konfidencial.

- f) Punonjësit socialë nuk duhet ta diskutojnë informacionin konfidencial në mjediset ku nuk mund të sigurohet privatësia.
- g) Punonjësit socialë duhet ta mbrojnë konfidencialitetin e përfitueseve gjatë procedurave ligjore në masën e lejuar nga ligji.
- h) Punonjësit socialë duhet ta mbrojnë konfidencialitetin e përfitueseve kur iu përgjigjen pyetjeve të bëra nga përfaqësues të medias.
- i) Punonjësit socialë duhet të mbrojnë konfidencialitetin e të dhënave të shkruara të klientëve. Ata duhet të ndërmarrin hapa për të ruajtur në vende të sigurta të dhënat e klientëve, të cilat nuk iu jepen personave të paautorizuar.
- j) Punonjësit socialë duhet të jenë të kujdesshëm që ta sigurojnë dhe ta ruajnë konfidencialitetin e informacionit dhe të mos ia transmetojnë palëve të tjera nëpërmjet kompjuterëve, postës elektronike, fax-it, telefonit, etj. Bërja publike e informacionit identifikues duhet shmangur kurdo që është e mundur.
- k) Punonjësit socialë duhet t'i mbajnë të dhënat në atë formë që të ruhet konfidencialiteti i përfitueseve.
- l) Punonjësit socialë nuk duhet ta bëjnë të njohur informacionin identifikues kur flasin për klientët e tyre për qëllime mësimi apo trajnimi, derisa klienti ta ketë dhënë vetë lejen për një veprim të tillë.
- m) Punonjësit socialë nuk duhet ta bëjnë të njohur informacionin identifikues kur diskutojnë për klientët me mbikëqyrësit, derisa klienti të ketë dhënë miratimin apo derisa të ketë nevojë të domosdoshme për një gjë të tillë.

7. Të folurit fyes

Punonjësit socialë nuk duhet të përdorin gjuhë denigruese gjatë komunikimit verbal apo të shkruar me përfitueset. Punonjësit socialë duhet të përdorin gjuhë të përzgjedhur dhe të respektueshme kur flasin me dhe për përfitueset.

Rekomandime etike gjatë këshillimit me viktimat e trafikimit

Organizata Botërore e Shëndetësisë¹¹⁶ liston një sërë rekomandimesh për t'u pasur parasysh në intervistat me viktimat e trafikimit, të cilat janë po kaq të vlefshme kur me to fillohet një proces këshillimi. Njohja e aftësive për përmbushjen e këtyre përgjegjësive kërkon nga profesionisti vullnet për të mësuar se si të komunikojë, dëgjojë dhe t'i përgjigjet në mënyrë të ndjeshme personit të trafikuar.

¹¹⁶World Health Organization. Ethical and Safety Recommendations for Interviewing Trafficked Women. Geneva: WHO Publications: 2003.

REKOMANDIMET E OBSH-SË MBI ETIKËN DHE SIGURINË NË INTERVISTIMIN E GRAVE TË TRAFIKUARA

1. Mos lëndoni.

Trajtojeni çdo grua dhe situatë sikur potenciali për dëmtim/lëndim të jetë ekstrem, derisa të keni fakte që provojnë të kundërtën. Mos ndërmerrni asnjë intervistë që mund ta keqësojë situatën e gruas në terma afatshkurtra ose afatgjata.

2. Njihni subjektin dhe vlerësoni rreziqet.

Mësoni mbi rreziqet e lidhura me trafikimin dhe rastin e çdo viktime të trafikimit para se të ndërmerrni një intervistë.

3. Përgatitni informacionin referues – mos bëni premtime që nuk mund t'i mbani.

Përgatituni të ofroni informacion në gjuhën mëmë të viktimës dhe në atë vendase (nëse janë të ndryshme) mbi shërbimet e përshtatshme ligjore, shëndetësore, të mbështetjes sociale dhe shërbimet e sigurisë, si dhe për të ndihmuar me referimet, nëse kërkohet. Përzgjidhni në mënyrë të përshtatshme përkthyesit dhe kolegët dhe përgatitni ata. Peshoni rreziqet dhe përfitimet e lidhura me punësimin e përkthyesve, kolegëve ose personave të tjerë dhe zhvilloni metoda të përshtatshme për përzgjedhje dhe trajnim.

5. Siguroni anonimitet dhe konfidencialitet.

Mbroni identitetin dhe konfidencialitetin e personit përgjatë gjithë procesit të intervistës – nga momenti që kontaktohet viktimi e deri kur detajet e rastit të saj bëhen publike.

6. Merrni miratimin e informuar.

Sigurohuni që çdo viktimë ta kuptojë qartë përmbajtjen dhe qëllimin e intervistës, qëllimin e përdorimit të informacionit, të drejtën e saj për të mos iu përgjigjur pyetjeve, të drejtën e saj për ta përfunduar intervistën në çdo kohë dhe të drejtën e saj për të vendosur kufizime për përdorimin e informacionit.

7. Përdoreni mirë informacionin e mbledhur.

Përdoreni informacionin në mënyrë të tillë që t'i sjellë përfitime subjektit ose që të ndihmojë zhvillimin e politikave dhe ndërhyrjeve të mira për gratë e trafikuar në përgjithësi.

8. Dëgjoni dhe respektoni vlerësimin e çdo gruaje mbi situatën e saj dhe mbi rreziqet ndaj sigurisë së saj

Pranoni që çdo grua do të ketë probleme të ndryshme dhe mënyra sesi i sheh ajo problemet e saj mund të jetë e ndryshme nga ajo sesi të tjerët mund t'i vlerësojnë ato.

9. Mos e ritraumatizoni një grua.

Mos bëni pyetje që kanë qëllim të provokojnë reagime emocionale. Përgatituni të përgjigjeni ndaj shqetësimit të gruas dhe të theksoni pikat e saj të forta.

10. Përgatituni për ndërhyrje emergjence.

Përgatituni të reagoni nëse një grua thotë se ndodhet në rrezik.

4.2 SIGURIA E OFRUESVE TË SHËRBIMIT

Në nënkapitullin 3.4 jeni prezantuar me çështjet e sigurisë dhe marrjen e masave mbrojtëse, të cilat janë të vlefshme si për sigurinë e viktimave të krimit, ashtu edhe për atë të personelit që punon me to. Gjithsesi, një fokus tek siguria e ofruesve të shërbimit në veçanti nuk është kurrë i tepërt, së pari për specifikat që e përbëjnë dhe së dyti pasi përsëritja dhe theksimi siguron më mirë se këto çështje do të mbahen mend. Ngulitja në kujtesë e praktikave të mira dhe respektimi i tyre në këtë rast janë të një rëndësie të veçantë për të gjithë personat e përfshirë.

Në Manualin e IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit¹¹⁷ theksohen çështjet e mëposhtme lidhur me sigurinë vetjake të ofruesve të shërbimit:

- Siguria e plotë nuk ekziston.
- Siguria vetjake mund të rritet me anë të kombinimit të vlerësimit dhe të menaxhimit të rrezikut dhe duke marrë përsipër sigurinë vetjake.
- Edhe pse ka të ngjarë që mbivlerësimi i shkallës së rrezikut të shkaktojë ankth tek ju, gjithsesi sapo të filloni punë duhet të jeni të informuar për rreziqet që ju kanosen.
- Për hir të sigurisë vetjake duhet të jeni të ndërgjegjshëm për gjithçka ju rrethon, për situatën në të cilën ndodheni, sidomos kur takimet bëhen në mjedise asnjë.
- Gjithnjë kur të diskutoni për rastet e trafikimit, kini mendjen se kush mund të jetë afër dhe të dëgjojë çfarë thoni ju.

Në veçanti, në këtë manual sugjerohet të ndiqen procedurat e mëposhtme për të përmirësuar sigurinë vetjake nga vetë punonjësit që ofrojnë shërbime në strehë:

- Punonjësit duhet ta dinë gjithmonë se ç'kanë përreth.
- Çdo shkëmbim të dhënash mes punonjësve duhet të jetë rreptësisht i ndaluar. Megjithatë, bazuar në parimin e “nevojës për të ditur”, duhet të shkëmbehet ajo çka duhet ditur domosdoshmërisht për kryerjen me korrektësi të punës .
- Në asnjë rast të dhënat konfidenciale vetjake dhe të dhënat konfidenciale të trafikimit nuk duhet t'u jepen përmes telefonit personave, identiteti dhe funksioni i të cilëve nuk njihet nga punonjësit e organizatës që ofron shërbimin.
- Në asnjë rast të dhënat vetjake, adresat ose numrat e telefonit të punonjësve të strehës nuk duhet t'u jepen personave të tretë, të cilët nuk janë pjesë e personelit.

¹¹⁷Ky seksion i referohet Manualit të IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Tiranë, 2007.

Në standardet Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale, të hartuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, standardi 7 “Siguria e përfituesve të shërbimit dhe e stafit” thekson se:

Ofruesi i shërbimit merr masa lidhur me sigurinë e stafit të tij dhe të përfituesve. Në çdo kohë sigurohet paprekshmëria e institucionit të shërbimeve dhe ruhet fshehtësia e vendndodhjes së institucionit. Çdo ofrues shërbimesh ka të përcaktuar qartë mënyrat e përbaljes me situatat e emergjencës dhe të rrezikut.

Në rregulloren e brendshme të tij ofruesi i shërbimit ka të përcaktuar qartë rregullat që lidhen me sigurinë për përfituesit dhe për stafin e tij.

Ofruesi i shërbimit trajnon anëtarët e stafit në lidhje me sigurinë dhe masat përkatëse për ruajtjen e saj në rastet kur rrezikohen përfituesit dhe stafi.

Moduli i trajnimit mund të përmbajë:

- Teknikat bazë të vetë-mbrojtjes për stafin dhe mundësisht për përfituesit.
- Trajtime bazë mbi ndihmën e shpejtë për menaxherët e qendrës dhe stafin jo mjekësor.
- Ndërgjegjësimi për sigurinë dhe vlerësimi i rrezikut.
- Diskutime të rregullta të stafit lidhur me incidentet ku stafi ose përfituesit janë ndjerë të frikësuar si dhe mbi rrugët se si të parandalohen këto incidente në të ardhmen.

4.3 KONSUMIMI PROFESIONAL DHE KUJDESI I PROFESIONISTËVE PËR VETEN¹¹⁸

Profesionistët psikosocialë që punojnë me popullata në nevojë kanë të përbashkët prirjen për të qenë individë tepër të motivuar, shpeshherë disi idealistë dhe gati për të punuar në mjedis stresuese. Kjo është vënë re nga shumë organizata ndërkombëtare humanitare, fillimisht nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe më vonë nga organizata të tjera, si Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) dhe më vonë nga Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM). I njëjti vëzhgim lidhet me veprimet humanitare vendase, pra me profesionistët psikosocialë që punojnë në situata të pazakonta dhe stresuese dhe/ose me popullata në nevojë. Shpesh, ndonëse ata janë teknikisht efektivë në shprehi të ndryshme të specializuara, janë të pandërgjegjshëm lidhur me stresin si një dukuri që mund të ndikojë aftësinë dhe produktivitetin në punë si dhe në kënaqësinë e tyre profesionale. Palumturia, ose disforia intensive¹¹⁹, simptomat fizike, konsumimi profesional

¹¹⁸Ky nënkaptull i referohet Manualit të Trajnimit të IOM-it Aspektet e shëndetit mendor të trafikimit të qenieve njerëzore. Budapest, 2004.

¹¹⁹Disfori: një gjendje që karakterizohet nga të ndjerit i/e pashpresë, jo rehat dhe i/e palumtur.

dhe shfaqje të tjera mund të çojnë, në rastin në të keq, që stafet përndryshe të shëndetshme dhe më parë të motivuara ta lënë punën e tyre me një ndjenjë dështimi personal. Punonjësit humanitarë dhe profesionistët psikosocialë nuk përjashtohen nga pasojat negative të stresit dhe nuk janë të imunizuar nga çrregullimet psikiatrike. Allen (2001) shprehet se për terapistët:

“Ne...jemi subjekt ndaj të gjithë faktorëve të rrezikut që i përkasin klientëve tanë, përfshi cenueshmërinë gjenetike (për shembull ndaj ankthit, depresionit, abuzimit me alkoolin), historinë familjare të çrregullimeve psikiatrike dhe historinë tonë individuale të çrregullimeve të sjelljes emocionale dhe asaj fizike. Për fat, ashtu siç nuk jemi të përjashtuar nga faktorët e rrezikut, nuk jemi të përjashtuar as nga faktorët mbrojtës, midis të cilëve një ndër më të rëndësishmit është një histori atashimesh të sigurta dhe mbështetëse.”¹²⁰

Përkufizime të stresit dhe konsumimit profesional

Së pari, dhe ç’është më e rëndësishme, është evidentuar qartë se edhe nivelet e moderuara të stresit mund të jenë një përbërës i mirë i mjedisit të punës. Në vitin 1936, Hans Selye përdori termin “stres” në një mënyrë të re për të përshkruar modelet e përgjithshme të përshtatjes që paraqesin individët kur përballen me kërcënime ose agresion. Reagimet stresuese janë së pari dhe kryesisht reagime normale dhe përshtatëse fiziologjike dhe psikologjike që lejojnë një person të:

- Fokusojnë vëmendjen e tij/e saj në situatën e rrezikshme.
- Mobilizojë energjinë e nevojshme mendore për të vlerësuar situatën dhe për të marrë vendime.
- Përgatitet për veprime të llojeve të ndryshme (përgjithësisht luftë ose shmangie).

E thënë ndryshe, stresi është një gjendje neutrale për sa kohë personi nuk ushqen stres negativ, qoftë të menjëhershëm apo të vonuar. Përgjithësisht, stresi negativ ndahet në katër kategori:

- Stres bazë i përditshëm me të cilin shumica e personave të motivuar duhet të përballen në situata sfiduese.
- Stres i grumbulluar, i cili është grumbullim i stresit të nivelit të ulët në fasha kohore. Edhe nivelet e ulëta të stresit mund të rriten ditë pas dite nëse kushtet e punës nuk janë të përshtatshme, ose nëse personi nuk ka një stil jetese të shëndetshëm.
- Stresi i ngjarjes kritike i referohet reagimeve akute emocionale dhe fiziologjike ndaj stresit të ashpër dhe potencialisht traumatizues.

¹²⁰Cituar në Manualin e Trajnimit të IOM-it Aspektet e shëndetit mendor të trafikimit të qenieve njerëzore. Budapest, 2004.

- Reagime akute të stresit dhe çrregullimi i stresit postraumatik janë sindroma të mosfunksionimit që mund të shfaqen nëse nuk ofrohet kujdesi i përshtatshëm ndaj personit që ose ka grumbulluar tepër stres për një periudhë të gjatë kohe, ose nuk i është dhënë vëmendje e mjaftueshme pas një ngjarjeje kritike.

Është e rëndësishme të bëhet dallimi mes reagimeve të stresit dhe konsumimit profesional. Ky i fundit i referohet pasojave tek individët shumë të motivuar me ideale të forta. Në fakt, termi “konsumim profesional” është propozuar nga Freudenberg (1974, 1980) për të përshkruar sesi vullnetarët në shërbimet sociale gradualisht dobësohen dhe humbin entuziazmin për të kryer detyrat e tyre.

Konsumimi profesional është përshkruar si një proces gradual i zhgënjimit, i cili ndodh në katër faza që shpesh përsëriten:

- **Entuziazmi.** Kjo fazë fillestare ndodh kur profesionisti e investon të gjithë energjinë e vet në punë dhe merr nga ajo shumicën/të gjithë kënaqësinë e tij. Disa profesionistë janë më idealistë se të tjerët, kanë pritshmëri më të larta dhe shpesh identifikohen me përfituesit e tyre. Nthelb ata nuk janë realistë në përballjen me kushtet dekurajuese dhe popullatat në nevojë.
- **Amullia.** Kjo fazë i referohet procesit të ngecjes dhe humbjes së shpresës e dëshirës për të arritur ndryshime. Puna gradualisht e humb shkëlqimin e saj dhe nuk i plotëson më nevojat e personit.
- **Frustrimi.** Profesionisti nuk është më ndihmues dhe ndihet i pafuqishëm. Disa profesionistë ankohen vazhdimisht. Të tjerë zemërohen dhe fajësojnë mbikëqyrësit dhe ndonjëherë edhe përfituesit për frustrimin e tyre. Shumë shpesh frustrimi çon në brendësim dhe tërheqje.
- **Apatia.** Faza finale ndodh kur profesionisti shkëputet emocionalisht edhe përballë frustrimit. Ai gradualisht pushon së u kujdesuri!

Mekanizmat e përballimit dhe reagimet ndaj stresit të cilat janë të pashëndetshme

Këto reagime mund të trajtohen në dy mënyra: 1) si mekanizma të përballimit ose strategji për të trajtuar një problem dhe 2) si pasoja kur mekanizmat e përballjes nuk kanë qenë mjaft të suksesshme.

1. Mekanizmat e përballimit

Përballimi është një sjellje që synon parandalimin, vonimin, shmangien ose menaxhimin e tensionit dhe stresit. Përballimi nuk është një sjellje e pazakonshme ose e rrallë. Ai ndërthuret me burimet sociale dhe emocionale të personit dhe me mjetet e tij emocionale dhe psikologjike.

Shumica e individëve mësojnë mënyra të individualizuara të trajtimit të stresit, por ato zakonisht ndjekin njërin nga modelet e mëposhtme:

- Shmangie
- Alterim
- Menaxhim
- Parandalim
- Kontroll të shprehjeve të papërshtatshme emocionale

Mekanizmat e përballimit mund të marrin tre forma të ndryshme:

1. Individu mund të përpiqet të ndryshojë burimin e frustrimit apo stresit. Ky veprim supozon njohuri dhe perceptim të shkaqeve. Vëmendja fokusohet në ndryshimin e situatës përpara se të ndodhë frustrimi apo stresi.
2. Individu mund të përpiqet të përcaktojë situatën për të kontrolluar shkallën e stresit dhe për të pakësuar ose zbutur ndikimin e tij. Ripërcaktimi është një mënyrë e menaxhimit të domethënies dhe gravitetit të situatës problematike. Njohja dhe perceptimi janë të rëndësishëm në këtë proces.
3. Individu mund të përpiqet ta menaxhojë stresin në mënyrë që të vazhdojë të funksionojë sa më normalisht të jetë e mundur. Kjo përfshin mohimin, tërheqjen, pranimin pasiv, optimizmin e papërshtatshëm, shmangien ose edhe të menduarit magjik.

2. Kur përballimi normal nuk funksionon më

Përgjithësisht reagimet e stresit (përfshi konsumimin profesional, reagimet akute të stresit dhe çrregullimin e stresit postraumatik) zërthehen në pesë dimensione:

Prezantim i Shkallës së Simptomave të Stresit Traumatik Dytësor

1. Fizike

- Çrregullime të gjumit
- Makthe
- Dhimbje trupi
- Ndryshime të oreksit dhe tretjes
- Ulje e rezistencës ndaj ftohjes dhe infeksionit
- Lodhje e vazhdueshme

2. Emocionale

- Luhatje të humorit, mungesë stabiliteti
- Ankth, frikë e përsëritjes
- Depresion, trishtim
- Irritim, agresivitet
- Vetëfajësim, turp
- Ndjenjë e cenueshmërisë
- Mpirje, shkëputje
- Frikë se mos “infektojnë” persona të dashur kur ndahen eksperiencat
- Irritim dhe mungesë rezistence ndaj frustrimit

3. Njohëse

- Kujtime shqetësuese
- Riaktivizim i ngjarjeve të mëparshme traumatike
- Preokupim për ngjarjen
- Ngurtësi e shtuar, rezistencë ndaj ideve të reja
- Vështirësi në marrjen e vendimeve

4. Të sjelljes

- Shmangie e kujtuesve të ngjarjes
- Shqetësime në marrëdhëniet sociale
- Vështirësi në lidhjen me “të jashtëm” dhe/ose kolegë
- Ulje e nivelit të aktivitetit
- Rritje e përdorimit të alkoolit, drogave/mjekimeve (vetëmjekim për depresionin, ankthin)
- Humbje e entuziazmit
- Shmangie e punës, vonesa të vazhdueshme, produktivitet më i ulët

5. Shpirtërore

- Frustrimi “Pse unë?”
- Cinizëm i rritur
- Humbje e vetëbesimit
- Humbje e qëllimit
- Besim i ri në një qenie më të lartë
- Pyetje të thella ekzistenciale
- Humbje e besimit në shpirtin bashkëpunues të njerëzimit
- Zhgënjim
- Humbje e kuptimit

- Humbje e objektivave jetësore
- Ndjenja tjetërsimi / Largim
- Ndryshime në sistemin e vlerave.

Të gjitha këto reagime kanë një ndikim negativ të dukshëm në detyrat profesionale të personit.

Çfarë mund të bëhet për të shmangur traumatizimin dytësor apo konsumimin profesional?

Çdo profesionist psikosocial që ka punuar me popullata të abuzuara fizikisht dhe seksualisht e pranon faktin se empatia me personat e trafikuar, qoftë edhe minimale, mund të prodhojë reagime intensive dhe të dhimbshme. Në varësi të intensitetit dhe reagimeve të profesionistit, kjo zakonisht quhet traumë dytësore ose konsumim profesional. Për fat të mirë, shumë mund të bëhet për të trajtuar stresin profesional përpara se ai të prodhojë pasoja negative. Faktorët dhe masat mbrojtëse zakonisht gjenerohen nga vetë profesionisti në kombinim me atë që duhet të ofrojë organizata ku është punësuar. Por strategjia bazë për të luftuar kushtet stresuese të punës është vetëreflektimi, vetëvëzhgimi dhe dallimi i pasojave të stresit tek vetja dhe i burimeve të tij (si personale ashtu dhe organizative). Në të njëjtë mënyrë duhen ndihmuar edhe të tjerët për të identifikuar burimet gjeneruese të stresit dhe për të punuar me to.

Në standardet Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale, të hartuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, standardi 6 “Stafi dhe zhvillimi i tij” theksohet se:

- Çdo anëtar i ri stafi i nënshtrohet një trajnimi, i cili sigurohet nga mbikëqyrësi i stafit.
- Ofruesi i shërbimit siguron kualifikimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnim të stafit teknik, sipas nevojave të tyre individuale për trajnim. Kjo nuk mund të jetë më pak se dy javë në vit. Koston e trajnimit e mbulon ofruesi i shërbimi.
- Për të evituar lëvizjet e shpeshta të stafit, e cila ndikon negativisht në cilësinë e shërbimeve duhen ndërtuar forma të ndryshme motivimi për stafin si psh: trajnime, mbikëqyrje individuale, këshillim, aktivitete ripërtëritëse, çlodhëse etj.
- Modulet e trajnimit përcaktohen duke u bazuar në nevojat e vlerësuara të stafit. Vlerësimi i nevojave për trajnim duhet të ndodhë të paktën 1 herë në vit.
- Ofruesi i shërbimit siguron mirëqenien shëndetësore dhe emocionale të stafit nga elementët e mbingarkesës të përhershme dhe të konsumimit profesional (*burn out*) nëpërmjet mbikëqyrjes individuale të ofruar nga persona të jashtëm, takimeve me psikologë, këshillime në grup ose diskutime mes profesionisteve, të paktën 2 herë në vit.

- Mbikëqyrjet individuale, këshillimet në grup ose diskutimet mes profesionistëve që provojnë se janë realizuar sipas nevojave të stafit.
- Programet, plani i veprimit, fleta e vlerësimit të bërë.
- Stafi, që ka ndjekur këto seanca ka reduktuar ngarkesën emocionale, ndihet më i lehtësuar, ka adresuar çështjet e konsumimit profesional, etj.

Faktorët mbrojtës personalë janë shumë më tepër efektivë sesa mendon shumica e profesionistëve. Disa persona bëjnë tepër qëndresë dhe të janë të aftë të funksionojnë për periudha të gjata në situata të vështira pa treguar shenja stresi. Nën kushte stresuese pune, si për shembull në përballjen me persona të traumatizuar, shumica e profesionistëve vetëpërshtaten dhe gjejnë mënyra për të përballuar strese të llojeve të ndryshme, që ndonjëherë mund të jenë edhe tejet mbingarkuese. Stili personal dhe karakteri mund të bëhen edhe më dobiprurës (ndonjëherë edhe në mënyrë të pandërgjegjshme) dhe kështu profesionistët gjejnë rrugë për t'u ç'angazhuar në mënyrë të përgjegjshme nga ngarkesa e tyre e punës (menaxhim i përshtatshëm i programit), flasin rreth ndjenjave të tyre me mbikëqyrësit, kolegët dhe miqtë (ruajtja e një rrjeti social mbështetës), marrin kohë larg punës, gjejnë mënyra për të larguar vëmendjen nga aspekte të dhimbshme të punës, etj. Strategji të tjera specifike mund të jenë të kontrollosh me një njeri të besuar sesi ndihesh, të marrësh pjesë në një trajtim, mbikëqyrje apo terapi, të rilidhesh me burime mbështetëse sociale dhe shpirtërore, etj.

Kujdesi për veten duhet të jetë përgjegjësia kryesore e çdo profesionisti. Kjo nis me të pasurit e një stili jetese të përshtatshëm që përfshin:

- Ushtrime – mirëqenia fizike dhe mendore shpesh shkojnë së bashku
- Ushqyerje e shëndetshme
- Pushim dhe gjumë
- Shplodhje dhe kënaqësi të shëndetshme
- Ekuilibrim i jetës së punës dhe asaj personale

Në përgjithësi, faktorët organizativë mbrojtës janë përbërësit e nevojshëm për të luftuar stresin dhe rrezikun e konsumimit profesional:

- Të pranohet se stresi dhe konsumimi profesional janë probleme TË VËRTETA që mund të ndikojnë tek të gjithë profesionistët
- Të identifikohen simptomat e stresit dhe konsumimit profesional
- Të ndërmerren hapa për të eliminuar faktorët e stresit dhe konsumimit profesional.
- Të vlerësohet efektiviteti i këtyre veprimeve.

Stresi lehtësohet në kontekste drejtimi dhe menaxhimi të përgjegjshëm, që krijojnë një klimë pune mbështetëse të karakterizuar nga:

- Qëndrim komunikimi të hapur
- Disponueshmëri
- Ndërgjegjësim për reagimet
- Pranim i humbjes
- Vlerësim i përpjekjeve.

Drejtimi dhe menaxhimi i përgjegjshëm mund të ofrojnë gjithashtu mbështetje psikologjike dhe profesionale për të gjithë stafin si grup, ose për grupe të vogla, madje edhe për individë që duken më të rrezikuar nga konsumimi profesional.

Modeli më i zakonshëm është të ndërtohen grupe mbështetëse kolegësh, ku anëtarët e stafit mund të ndajnë dhe të shprehin ndjenjat e tyre dhe të kërkojnë zgjidhje. Modeli i grupit ka avantazhin e ndërtimit të një shpirti skuadre në përballjen me kushte të vështira dhe në ofrimin e mbështetjes kolektive për ata që mund të jenë të cenueshëm në çfarëdo momenti. Tashmë dihet se kur grupet mbështetëse funksionojnë mirë:

- Stresorët pranojnë si të vërtetë dhe të ligjshëm.
- Problemi shihet si problem për të gjithë grupin dhe jo si një problem i kufizuar tek individ.
- Qasja e zakonshme ndaj problemit është të kërkojnë zgjidhje, dhe jo fajtorë.
- Ekziston një nivel i lartë tolerance për çrregullimet individuale.
- Mbështetja shprehet qartë, drejtpërdrejt dhe bollshëm në formën e vlerësimit, përkushtimit dhe dhembshuri.
- Komunikimi është i hapur dhe efektiv: ekzistojnë pak pengesa/kufizime kundrejt asaj që mund të thuhet. Cilësia e komunikimit është e mirë dhe mesazhet janë të qarta dhe të drejtpërdrejta.
- Ekziston një shkallë e lartë bashkëpunimi.
- Rolet janë tejet elastike dhe individët nuk janë tepër të kufizuar në ndërmarrjen e roleve të ndryshme. Burimet – materiale, sociale dhe institucionale – përdoren në mënyrë efektive.
- Nuk ekziston një nën-kulturë e dhunës (shpërthimet emocionale nuk janë formë e dhunës).
- Nuk ka abuzim me substancat.

Gjithashtu rekomandohet që stafi i cili punon me persona të traumatizuar të përfitojë nga mbikëqyrja e rregullt profesionale. Në këtë kontekst, mbikëqyrja shihet si një mundësi për profesionistin ose grupin për t'u takuar konfidencialisht me një specialist të shëndetit mendor, të trajnuar si mbikëqyrës.

Puna e tij është të krijojë kushte respekti dhe sigurie për profesionistin në mënyrë që ai/ajo të mund të eksplorojë çështjet e vështira me të cilat përballet gjatë punës me përfituesit e traumatizuar.

Së fundi, një nga masat më të mira për të luftuar stresin dhe traumatizimin dytësor është të ofrohen eksperiencat të ndryshme pune dhe mundësi për të mësuar shprehi të reja. Për këtë arsye, zhvillimi i stafit dhe trajnimi është një mjet thelbësor për t'i mbajtur profesionistët të motivuar, të përfshirë dhe të ndërgjegjshëm për vlerat e tyre. Përtej këtij funksioni psikosocial, njohuritë ofrojnë një kornizë konceptuale që ndihmon në krijimin e një koherence lidhur me eksperiencat, edhe me ato traumatike. Gjithashtu, përfitimi i informacionit më të specializuar përgjithësisht rrit ndjenjën e vetëefikasitetit të personit dhe mund të kontribuojë në rregullimin e nivelit optimal të shkëputjes së nevojshme për të punuar me përfituesit e traumatizuar. Trajnimi i vazhdueshëm gjithashtu nënkupton më tepër informim për pritshmëritë tona në mënyrë që qëllimet tona duhet të jenë realiste. Për më tepër trajnimi i vazhdueshëm ndihmon në shtimin e tolerancës karshi dështimit.

Siç thonë Pearlman dhe Saakvitne (1995) ironikisht:

“Ndoshta rekomandimi më i mirë për kolegët tanë lidhur me jetët e tyre personale, është që ta kenë një të tillë”.

5

*Parandalimi i
fenomenit të
trafikimit të qenieve
njerëzore*

5.1 STRATEGJITË PARANDALUESE

Strategjitë antitrafik të hartuara nga shteti shqiptar, në bashkëpunim me aktorë të tjerë kryesorë janë:

1. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Plani i saj i Veprimit 2005-2007
2. Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit 2005-2007
3. Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit për Periudhën Janar-Dhjetor 2005¹²¹

Ky kapitull përfshin informacion vetëm mbi Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Planin e saj të Veprimit 2005-2007, duke qenë se megjithëse tashmë kjo strategji ka përfunduar afatin e saj kohor, ndërkohë ZKK-ja po harton strategjinë e re për vitin 2008-2010.¹²² Nuk do të trajtohen dy strategjitë e tjera, për shkak të mbarimit të afatit të tyre kohor.

Të tjera strategji që ndikojnë në parandalimin e trafikimit janë:

1. Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, 2007-2010
2. Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2005-2010 dhe Plani i saj i Veprimit
3. -*Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013
4. Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013
5. Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale 2007-2013

Strategjia e zbatuar deri tani në fushën e antitrafikimit në vend ka qenë **Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Plani i saj i Veprimit 2005-2007**, për të cilin ZKK ka hartuar edhe një raport vlerësimi.

Qëllimi i kësaj Strategjie është “të konsolidojë përparimin e bërë që nga momenti i hartimit të Strategjisë Kombëtare Anti-Trafik 2000-2001 të Shqipërisë, dhe në të njëjtën kohë të zhvillojë metoda të reja ligjore e institucionale për t’iu përshtatur karakterit në ndryshim të fenomenit të trafikimit, si dhe të zhvillojë mënyra më sistematike, të besueshme e verifikueshme statistikore për të matur rezultatet.”¹²³

¹²¹Për më tepër informacion shih <http://www.mpcs.gov.al/legjislacioni/strategji-standarte> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

¹²²Për më tepër informacion shih www.moi.gov.al [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

¹²³Qeveria e Shqipërisë. Strategjia Kombëtare Shqiptare për Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore: Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2005-2007.

Në mënyrë specifike, për sa i përket parandalimit, Plani pasqyron pranimin nga ana e Qeverisë të përgjegjësisë së saj për të nxitur më shumë përfshirjen sociale dhe alternativa përkundrejt migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, nëpërmjet harmonizimit të nismave për uljen e varfërisë, barazi gjinore, arsimim dhe krijim të vendeve të punës.

Strategjia e zbatuar deri tani ka qenë e fokusuar në tre drejtime kryesore:

1. Hetimi dhe ndjekja penale e veprave penale të trafikimit në njerëz.
2. Mbështetja dhe mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve.
3. Parandalimi i trafikimit dhe ritrafikimit.

Kjo strategji mbështetet në parimet e mëposhtme:

- Përgjegjësia kryesore është e qeverisë.
- Përfshirja e shoqërisë civile është e rëndësishme.
- Viktimat e trafikimit duhen trajtuar bazuar në parimet e të drejtave të njeriut.
- Aktivitetet anti-trafik duhen bashkërenduar mes fushave e sektorëve të ndryshëm në nivel ministror e zyrtar, si dhe mes qeverisë e organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve.
- Vlerësimi sistematik dhe vazhdueshmëria.

Vlerësimet statistikore kombëtare e ndërkombëtare kanë theksuar se kjo Strategji ka kryer arritjet e mëposhtme:

- Megjithëse akoma një vend burimi për trafikun, Shqipëria nuk është më një vend i rëndësishëm transiti apo destinacioni.
- Janë miratuar ligje anti-trafik, bazuar në standardet ndërkombëtare, përfshirë këtu amendamentet në Kodin Penal, Ligjin Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe atë Anti-Mafia.
- Është ngritur një Gjykatë për Krimet e Rënda dhe Task Forca Rajonale për Krimin e Organizuar, për të trajtuar, ndërmjet të tjerash, çështjet më të rënda të trafikimit të qenieve njerëzore.

Ndër strategjitë e tjera, të cilat me anë të masave që parashikojnë parandalojnë fenomenin e trafikimit, si dhe mbrojnë viktimat e këtij fenomeni, mund të përmendim: **Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, 2007-2010**, dhe Planin e saj të Veprimit¹²⁴, e cila është hartuar në përputhje me ligjin kundër dhunës në familje dhe parashikon masa sociale në ndihmë të grave dhe vajzave të trafikuar apo që janë tepër të cenueshme prej trafikimit.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj strategjie në lidhje me fenomenin e trafikimit është masa e parashikuar për “ndërtimin e programeve me subvencionim të pagës për kategori të përjashtuara grash, si gra e

¹²⁴Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 913, datë 19.12.2007 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, 2007-2010, dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

vajza të trafikuarra e të dhunuara, afër moshës së pensionit, invalidë ose me aftësi të kufizuara (gra në rrezik)”, masë e parashikuar në kuadrin e fuqizimit ekonomik, si një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore dhe eliminimin e rrezikut që kërcënon gratë si grup potencial trafikimi. Sipas kësaj strategjie, gratë po bëhen gjithnjë e më të varfra se burrat. Në mënyrë të veçantë papunësia dhe varfëria po ndikojnë negativisht në statusin social të grave shqiptare. Të dhënat mbi varfërinë në Shqipëri, tregojnë për një feminizim të varfërisë dhe rritje të peshës së grave në grupin e të varfërve. Gjeografikisht kemi ritme më të ulta të reduktimit të varfërisë në këto grup-popullata në zonat rurale, ku përveç shumë faktorëve që prodhojnë varfëri, inferioriteti ekonomik e social i gruas ndikon fuqishëm.

Për më tepër, gratë në Shqipëri kanë më pak akses se burrat për të filluar një punë, për pasojë niveli i papunësisë tek ato është më i lartë. Megjithatë akses i gruas në arsimim është i barabartë me burrat, kjo nuk u siguron grave të njëjtat mundësi në tregun e punës.¹²⁵

Një nga objektivat e planit të veprimit të kësaj strategjie, me qëllim fuqizimin ekonomik të gruas dhe rritjen e mundësive të saj për punësim dhe kualifikim profesional, është edhe rritja e numrit të projekteve apo programeve të cilat nxisin formimin profesional dhe punësimin e grave, si dhe shtrirja e këtyre projekteve edhe në zonat rurale. Gjithashtu është planifikuar edhe ngritja e programeve të kreditimit të grave, sidomos të atyre në zonat sub-urbane dhe rurale për nxitjen e sipërmarrjes.

Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje 2007-2010 u referohet disa akteve ligjore të cilat favorizojnë grupe shoqërore në rrezik, ku përfshihen edhe gratë e trafikuarra. Vlen të përmendet këtu kuadri ligjor në lidhje me arsimin dhe formimin profesional, në mënyrë specifike masa e marrë për tarifën e regjistrimit për kategoritë: komuniteti rom, vajzat dhe gratë e trafikuarra, etj, të cilat është vendosur të ofrohen falas për kurset e profesioneve të ofruara nga Qendrat Publike të Formimit Profesional.¹²⁶

Një strategji tjetër e rëndësishme po në këtë linjë është edhe **Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2005-2010**¹²⁷. Në këtë strategji një vend të veçantë zënë shërbimet sociale që ofrohen për grupet në rrezik, si: fëmijët e gratë e trafikuarra, gratë e dhunuara, romët etj. Për sa i takon fëmijëve të trafikuar, kjo Strategji kontribuon në evidentimin e problemeve shoqërore të cilat shpesh në trafikimin e fëmijëve. Këto probleme janë:

¹²⁵INSTAT. Perspektivat gjinore në Shqipëri. Tiranë, 2004.

¹²⁶Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010. Urdhri Nr. 394 datë 23.02.2004 i Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale “Për tarifën e Sistemit të Formimit Profesional”.

¹²⁷Në vitin 2002 u hartua Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2003-2007, e cila u rishikua në përputhje me ndryshimet legislative dhe në prill 2005 u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 265, 28.4.2005 “Për miratimin e Strategjisë së Shërbimeve Shoqërore (2005-2010)”

- Sisteme të pamjaftueshme shërbimesh për mbrojtjen e fëmijëve, përgjegjës për identifikimin dhe ofrimin e ndihmës së duhur psiko-sociale dhe socio-ekonomike për fëmijët në rrezik dhe familjet e tyre.
- Varfëria, përjashtimi social dhe mundësitë e kufizuara të familjeve për të siguruar ardhura, duke kërkuar që ato të sigurohen edhe me punën e fëmijëve.
- Mundësitë e kufizuara për punësim brenda vendit dhe rrugët e pakta për emigrim legal, shtyjnë fëmijët dhe familjet e tyre për të ndërmarrë rrugëzgjdhje të rrezikshme.
- Pamundësi të fëmijëve dhe familjeve në rrezik për të vlerësuar situatat e mundshme për shfrytëzim.
- Mungesa e marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet pritëse të fëmijëve, viktimat të trafikimit.¹²⁸

Më tej, kjo Strategji liston masat që do të merren në të ardhmen, me fokus në parandalimin e fenomenit të trafikimit:

- Implementimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të fëmijëve, i cili do të paraqesë një politikë që adresohet drejt parandalimit, mbrojtjes, kthimit vullnetar të asistuar, riadhesimit dhe riintegrit të fëmijëve të trafikuar.
- Krijimi i mekanizmave shumë-sektoriale të identifikimit të viktimave të trafikimit dhe veçanërisht të fëmijëve të trafikuar.
- Bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve dhe partnerëve që punojnë në fushën e trafikimit të fëmijëve.
- Rikthimin në shkollë të fëmijëve të trafikuar dhe në rrezik trafikimi, që nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe ofrimin e alternativave për formim profesional për të rinjtë në moshë pune.¹²⁹

Po kështu, për gratë e trafikuar kjo Strategji rithekson nevojën e masave parandaluese. Konkretisht, përmendet nevoja e më shumë shërbimeve për parandalimin e fenomenit dhe zgjidhjen e problemeve ekonomike të grave e vajzave, programeve për sensibilizimin e grave e vajzave, si dhe riintegrimi i tyre në strukturat e shërbimeve sociale.¹³⁰

Një tjetër strategji e rëndësishme në parandalimin e fenomenit të trafikimit është edhe **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013**. Kjo është një nga strategjitë më të fundme, e

¹²⁸Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2005-2010. 23

¹²⁹Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2005-2010.

¹³⁰Po aty.

marsit të 2008-s, e cila harmonizon në një dokument të vetëm strategjik axhendën për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social me axhendën e integritit në Bashkimin Europian dhe në strukturat e NATOS-s, si dhe me atë të realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.

Në vazhdën e zbatimit të MSA-së, në lidhje me krimin e organizuar, terrorizmin dhe trafikimin, përcaktohen ende si sfidë për shtetin shqiptar dhe aktorët e tjerë kryesorë veprat penale që lidhen me trafikimi ne qenieve njerëzore, siç janë ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve apo shfrytëzim për prostitucion dhe keqtrajtimi i të miturve, megjithëse kontrolli për lëvizjet e skafeve ka vazhduar, sikurse dhe ndjekjet penale dhe dënimet e trafikantëve.¹³¹

Vizioni i kësaj strategjie në lidhje me rimin e organizuar, terrorizmin dhe trafikimin është një shoqëri pa kërcënime nga krimi i organizuar, në paqe dhe në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve/eve, duke krijuar në këtë mënyrë imazhin e një vendi të qetë e me standarde të larta të sigurisë. Disa nga përparësitë strategjike dhe politikat që do të ndihmojnë në arritjen e këtij vizioni për sa i përket trafikimit në përgjithësi e parandalimit të tij në veçanti, të përcaktuara në strategjinë ndërsektoriale për luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit janë:

- Sensibilizimi i qytetarëve në lidhje me pasojat e krimit të organizuar mbi destabilizimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit.
- Zbatimi i detyrimeve nga marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore me organizatat ndërkombëtare.
- Fuqizimi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë përpara, gjatë dhe pas procesit gjyqësor nëpërmjet zbatimit rigoroz të ligjit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, përmirësimi të bashkëpunimit midis strukturave përgjegjëse, qofshin këto shtetërore, të pavarura apo organizata ndërkombëtare, si dhe nëpërmjet rritjes së besimit të qytetarëve tek forcat e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori.
- Kryerja e hetimeve me qëllim shkatërrimin e plotë të rrjeteve kriminale, organizatave kriminale apo grupeve të strukturuar, për të gjitha format e krimit.
- Etj

Këto përparësi shërbejnë edhe në ruajtjen e rendit publik, ku për arritjen e tyre parashikohet kryesisht menaxhimi i integruar i kufijve, përmirësimi i menaxhimit të policisë, trajnimi i punonjësve të policisë e të shërbimit të inteligjencës në përdorimin e të dhënave informative, etj.¹³²

¹³¹Këshilli i Ministrave. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Mars, 2008.

¹³²Këshilli i Ministrave. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Mars, 2008.

Përtej temave të mësipërme, kjo strategji e trajton trafikimin edhe në aspektin e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës në familje. Kështu, përparësi mbetet mbështetja për gratë dhe vajzat e pambrojtura përmes fuqizimit të strukturave publike, të cilat trajtojnë viktimat e dhunës dhe të trafikimit, sidomos në fshat, dhe të programeve të cilat synojnë t'i integrojnë këto viktimat.

Të tjera masa, të cilat në mënyrë të tërthortë por efektive ndikojnë në parandalimin e trafikimit me anë të fuqizimit të rolit të gruas në shoqëri janë:

- Fuqizimi ekonomik i grave përmes rritjes së numrit të tyre si sipërmarrëse, duke u dhënë më shumë mundësi për të pasur pronë, kapital dhe kreditime, sidomos për ato të zonave rurale, dhe përmes programeve të posaçme të nxitjes së punësimit të grave.
- Rritja e përfaqësimit të grave e vajzave në proceset vendimmarrëse përmes ndryshimeve në ligjin zgjedhor, si dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare për pjesëmarrjen aktive të grave në strukturat politike dhe ekzekutive.
- Parandalimi i dhunës në familje nëpërmjet edukimit të fëmijëve, të rinjve dhe publikut të gjerë, përmirësimit të programeve të lëndëve mësimore, të teksteve shkollore e jashtëshkollore, trajnimit të profesionistëve të shërbimeve shëndetësore, sociale dhe të arsimit për të identifikuar viktimat e abuzimit sa më herët dhe për të ofruar mbështetje.
- Etj.¹³³

Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013 gjithashtu parashtrohet masa të rëndësishme për parandalimin e fenomenit të trafikimit. E hartuar si një komponent i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, ajo fokusohet në varfërinë dhe përjashtimin social. Përveç varfërisë si shkak kryesor të përjashtimit social, kjo strategji trajton edhe rrezikun e deprivimit apo barrierave të cilat nuk lejojnë që grupe apo individë të caktuar të marrin pjesë plotësisht në shoqëri. Që politikatat të jenë efektive duhet që të marrin parasysh edhe këto nevoja.¹³⁴

Ashtu si në gjithë strategjitë e tjera, rol i rëndësishëm i ngarkohet mekanizmave vendorë, të cilët do të veprojnë menjëherë pas fillimit të decentralizimit. Pushteti lokal është menduar të punojë për përmirësimin e aksesit në shërbime dhe në sigurimin e integritet të grupeve minoritare. Për këtë nevojitet partneritet me OJF-të dhe donatorët për zhvillimin e politikave dhe monitorim, për financime dhe ofrimin e shërbimeve. Lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit duhet të jetë pjesë e të gjitha politikave të qeverisë dhe të pranohet nga shoqëria.

¹³³Po aty.

¹³⁴Këshilli i Ministrave. Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013. 2008

Në mënyrë të veçantë parashikohen masa për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, prej të cilave përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë viktimat e trafikimit. Kështu, politikat e veçanta të përfshira në Strategjinë e Sektorit të Punësimit (në proces) që reflektojnë angazhimin për barazi dhe mos-diskriminim në favor të grupeve në nevojë, përcaktojnë edhe reduktimin e tarifave të kurseve për grupet specifike që kanë qenë të përjashtuar nga tregu i punës në momentin që regjistrohen si të papunë. Këto përfshijnë: PAK, të rinj në nevojë, viktimat e trafikimit, ish të burgosur dhe gratë Rome dhe/ose Egjiptiane.¹³⁵

Gjithashtu, kjo strategji parashtron masa për luftën kundër ose parandalimin e trafikimit të grupeve të tjera në rrezik si fëmijët, vajzat e reja dhe komuniteti Rom me anë të fuqizimit të shërbimeve e politikave për këto grupe. Për shembull, përcaktohen masa për përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe rendin publik nëpërmjet rekrutimit të Romëve si policë dhe parandalimit të trafikimit.¹³⁶

Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013 përmbledh ndër të tjera axhendën e politikave për mundësi të barabarta, të reflektuar në disa dokumente strategjike ndërsektoriale të përgatitur vitet e fundit për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin rom, luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe barazinë gjinore. Kjo strategji është një komponent i rëndësishëm i Strategjisë ndërsektoriale të Përfshirjes Sociale si dhe pjesë e pandarë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Kjo Strategji parashtron objektiva konkrete për reduktimin e varfërisë dhe ofrimin e shërbimeve për grupet në nevojë, në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Për më tepër, ajo mbështetet në prioritetet e Programit të Qeverisë për politikat sociale, reduktimin e varfërisë, përmirësimin e cilësisë së jetës së grupeve

Më poshtë përmendim disa nga masat parësore për mbështetjen dhe mbrojtjen e tre grupeve të rrezikuara nga trafikimi:

- Parandalimi i trafikimit të fëmijëve nëpërmjet bashkëpunimit më të ngushtë me institucionet e tjera publike dhe mbrojtja e ri-integrimit i viktimave nëpërmjet sistemit të referimit.¹³⁷
- Rritja e numrit të grave në vendimmarrjen publike.¹³⁸
- Rritja e aksesit për kategoritë e grave në nevojë për t'u informuar mbi bazën ligjore dhe programet që sigurojnë mbrojtjen sociale si dhe institucionet që ofrojnë këto shërbime.¹³⁹

¹³⁵DCM - Sistemi i Tarifave të Formimit Profesional, 4.04.2006. Cituar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Mars, 2008.

¹³⁶Këshilli i Ministrave. Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013. 2008

¹³⁷Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013.

¹³⁸Po aty.

¹³⁹Po aty.

- Integrimi i fëmijëve rom të rrugës në jetën normale. Për integrimin e këtij grupi fëmijësh është menduar ngritja e qendrave ditore të cilat do të shërbejnë si strehë dhe shkolle, që do të realizohen në bashkëpunim me donatorë vendas dhe të huaj nëpërmjet OJF-ve që zbatojnë projekte në edukimin dhe zhvillimin e kësaj kategorie fëmijësh. Institucione shtetërore si Inspektorati Shtetëror i Punës do të ushtrojë kontrolle sistematike lidhur me punën e zezë të fëmijëve rome.¹⁴⁰
- Etj

4.2 TË TJERA MASA LIGJORE

Programi për promovimin e punësimit për punëkërkuaset femra është miratuar me vendim të qeverisë shqiptare, nr 632, më 18 shtator 2003. Një prej masave të parashikuara nga ky program është edhe fuqizimi i grave në nevojë, si më poshtë:

“Nëse punësohen femra të trafikuar, rome, femra me aftësi të kufizuara, nëna pa bashkëshortë, gra të divorcuara dhe gra me probleme shoqërore dhe financiare (sipas kushteve të mësipërme), punëdhënësi përfiton një financim mujor të barabartë me 4, 6 dhe 8 paga mujore të gruas së punësuar, respektivisht.”¹⁴¹

Përveç programit të sipërpërmendur ka edhe hapa të tjerë pozitivë të ndërmarrë nga qeveria shqiptare me qëllim që të mbështeten punëkërkuaset përmes ofrimit të trajnimeve personale dhe nëpërmjet ndërmjetësimit për vende pune.¹⁴²

Këto masa të programuara synojnë fuqizimin dhe rritjen ekonomike të grave, duke u përqendruar kryesisht tek gratë në nevojë, potencial për trafikim në të ardhmen. Ato janë hartuar bazuar në parimin se lufta kundër fenomeneve kriminale si trafikimi i qenieve njerëzore është efikase në terma afatgjatë kur përpjekjet orientohen drejt shkaqeve që çojnë në lindjen e këtij fenomeni. Disa prej shkaqeve të verifikuara deri tani, ndaj të cilëve edhe janë marrë këto masa, janë: varfëria gjinore, diskriminimi gjinor, përkatësia në grupe/komunitete pakicash që shkakton diskriminim të dyfishtë, etj.

Në vitin 2008, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, përfaqësues të organizatave që ofrojnë shërbime për personat e trafikuar, përfaqësues të institucioneve rezidenciale, të Bashkive dhe të organizatave ndërkombëtare, etj, hartoi **Standardet e Shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar se në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale.**

¹⁴⁰Po aty.

¹⁴¹Metani, A. dhe Omari, S. Drejt rrugës për në BE; Monitorimi i shanseve të barabarta për gratë dhe burrat në Shqipëri. Instituti Shoqëria e Hapur dhe Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim. Tiranë, 2006.

¹⁴²Po aty.

Këto standarde synojnë përmirësimin e jetës së personave të trafikuar apo në rrezik trafikimi. Ato reflektojnë parimet e njohura të barazisë, respektimin dhe garantimin e vlerave dhe të personalitetit të individit, të drejtat për të përfituar dhe për të qenë i mbrojtur, mosdiskriminimin, ruajtjen e konfidencialitetit të jetës private, të dinjitetit dhe të sigurisë, partneritetin, integrimin shoqëror dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit.

Përmendim këtu disa nga standardet që ndikojnë drejtpërdrejt në parandalimin e trafikimit:

- **Standardi 1 – Qëllimi dhe llojet e shërbimeve:** “Ofruesi i shërbimeve ofron një paketë të plotë dhe efikase shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të përfituesve, në bashkëpunim me ofruesit primarë dhe alternativ, për të mundësuar mbrojtjen e personave në rrezik trafikimi si dhe rehabilitim dhe riintegrim për ata të cilët janë tashmë viktimë të trafikimit.”¹⁴³

- **Standardi 4 – Të dhënat personale të përfituesit dhe mënyra e menaxhimit të tyre:** “Ofruesi i shërbimit mbledh dhe ruan të dhënat personale të përfituesit duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale dhe të kujdesshme. Ofruesi i shërbimeve krijon kushte që menaxhimi i të dhënave të bëhet sipas normave ligjore dhe bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit.”¹⁴⁴

- Etj

4.3 PROGRAME PARANDALUESE TË SHOQËRISË CIVILE

Shumica e programeve të zbatuara në Shqipëri, të fokusuar mbi parandalimin përfshijnë **fushata ndërgjegjësuese** në media, programe edukuese në shkolla, projekte trajnimi për gratë, oficerë të policisë, gjyqtarët, dhe aktivitete në klubet rinore.¹⁴⁵

Në përpjekje për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore, qeveria shqiptare ka bashkëpunuar në nivel partnerësh me OJF vendore dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare.¹⁴⁶ Për sa i përket bashkëpunimit me OJF-të vendore, vlen të përmendim:

- Projekti “**Fushata ndërgjegjësuese mbi rrezikun e trafikimit të qenieve njerëzore dhe korrupsionin që përfshin**” – zbatuar nga “Vatra” gjatë viteve 2003-2004. Disa nga aktivitetet e këtij projekti ishin:

- Sesione trajnimi me studentë të shkollave të mesme të Vlorës.
- Tryeza të rumbullakëta.

¹⁴³Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale. Tiranë, 2008.

¹⁴⁴Po aty.

¹⁴⁵Ekonomi, I., Gjermani, E., Danaj, E., Lula, E. dhe Beci, L. Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: Një strategji për parandalimin e trafikimit. Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim. Tiranë, 2006.

¹⁴⁶Ekonomi, I., Gjermani, E., Danaj, E., Lula, E. dhe Beci, L. Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: Një strategji për parandalimin e trafikimit. Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim. Tiranë, 2006.

- Botime, duke përfshirë edhe gazetatat, fletëpalosje, biseda telefonike, debate televizive, etj.
- Kurse kompjuteri dhe të gjuhës angleze me vajza viktime të trafikimit ose në rrezik trafikimi.

Për më tepër, gjatë viteve 2004-2005, vajza dhe gra të komunitetit egjiptian u trajnuan mbi normat e komunikimit, marrëdhëniet prindër-fëmijë, migrimi dhe rrjedhojat psikologjike, paragykimet dhe diskriminimin, dhunën në familje, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, etj.¹⁴⁷

Po sipas studimit “Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: Një strategji për parandalimin e trafikimit”, organizatat ndërkombëtare në mbështetje të përpjekjeve anti-trafik, në bashkëpunim me shtetin por edhe OJF shqiptare, kanë ndërmarrë iniciativa të ndryshme, ku përmendim:

Projekti **“Përzgjedhja e azilkërkuesve dhe emigrantëve në Shqipëri”** (2004-2006), i realizuar bashkërisht nga Zyra e UNHCR-së në Shqipëri, Misioni i IOM-it në Shqipëri, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Drejtoria për Refugjatë në Ministrinë e Brendshme, në bashkëpunim të ngushtë edhe me Drejtorinë e Policisë së Kufirit. Në kuadër të këtij projekti u trajnuan rreth 92% e policisë shqiptare të kufirit në lidhje me atributet e policisë gjyqësore dhe ushtrimin korrekt të këtyretributeve nga oficerët e policisë së kufirit, mbi legjislacionin mbi azilin dhe çështjet e trafikimit, si dhe mbi trajtimin e referimin e rasteve të të huajve të cilët kalojnë ilegalisht kufirin shqiptar.

¹⁴⁷Raporti vjetor 2004. “Vatra”. Tiranë, 2005.

INTERVISTA

A. Shfrytëzimi:

1. Me çfarë aktiviteti merrej i intervistuari jashtë shtetit? _____

(Përgjigjet si: punë bujqësore, shtëpiake, argëtim, prostitucion, kërcimtare, kameriere apo banakiere mund të jenë tregues të trafikimit)

2. Pas sa kohësh pas mbërritjes filloi punë i intervistuari? _____

Më pak se një javë Më shumë se një javë

(Një periudhë prej më shumë se një javë pas mbërritjes dhe para gjetjes së një pune mund të jetë një tregues që ky NUK është një rast trafikimi)

3. A paguhej i intervistuari ndryshe nga sa kishte rënë dakord me punëdhënësin?

Po Jo (Përgjigjja pozitive mund të jetë tregues i trafikimit)

4. A i duhet të intervistuarit t'ia jepte fitimet nga puna e tij një personi tjetër?

Po Jo (Përgjigjja pozitive është tregues i trafikimit)

5. A detyrohej i intervistuari të bënte diçka që nuk dëshironte ta bënte, gjatë kohës që ishte jashtë vendit? A e kanë mashtruar ndonjëherë për punën, apo detyruar, kërcënuar, rrahur apo mbajtur kundër dëshirës së tij në një vend?

Po Jo (Përgjigjja pozitive është tregues i qartë i trafikimit)

6. A ishte puna që bëtë i intervistuari jashtë vendit e ndryshme nga ajo që i ishte premtuar përpara se të ikte nga Shqipëria?

Po Jo (Përgjigjja pozitive mund të jetë tregues i trafikimit)

7. A ishin kushtet e punës më keq seç i priste i priste i intervistuari?

Po Jo (Përgjigjja pozitive mund të jetë tregues i trafikimit)

B. Mënyrat

8. A kishte i intervistuari një borxh për t'i paguar dikujt që e kishte ndihmuar me transportin apo me dokumentet e udhëtimit, ose për të gjetur një punë?

Po Jo (Përgjigjja pozitive është tregues i trafikimit)

9. Teksa ishte jashtë vendit, a ishte i intervistuari i lire të qarkullonte atje sipas dëshirës, apo lëvizjet e tij ishin të kufizuara, ose ishte i shoqëruar gjatë gjithë kohës?

I kufizuar/shoqëruar jo i kufizuar
(Lëvizja e kufizuar është tregues i trafikimit)

10. A ishte kërcënuar, rrahur, detyruar i intervistuari të largohej nga Shqipëria, a ishte detyruar të shkonte në një vend tjetër, apo të qëndronte jashtë vendit pasi kishte vajtur atje me dëshirën e tij?

Po Jo Përgjigjja pozitive mund të jetë tregues i trafikimit)

C. Rekrutimi dhe Transportimi

11. Kush e organizoi transportimin e të intervistuarit?

Vetë Familja I dashuri Shoku Agjenci Rekrutuese
Të tjerë: _____

(Nëse i intervistuari nuk i bëri vetë organizimet, kjo mund të jetë tregues i trafikimit.)

12. Kush i përgatiti dokumentet e të intervistuarit?

Vetë Familja I dashuri Shoku Agjenci Rekrutuese
Të tjerë: _____

(Nëse i intervistuari nuk i bëri vetë organizimet, mund të jetë tregues i trafikimit.)

13. Kush ia gjeti vendin e punës të intervistuarit?

Vetë Familja I dashuri Shoku Agjenci Rekrutuese
Të tjerë: _____

(Nëse i intervistuari nuk i bëri vetë organizimet, ky mund të jetë tregues i trafikimit.)

Nëse jeni përgjigjur “vetë” tek njëra nga pyetjet 11-13, kaloni tek pyetja 14.

Nëse përgjigjet janë të tjera, përveç “vetë”, kaloni tek pyetja 15.

14. Nëse i intervistuari ka bërë një nga këto veprime vetë, a mund të shpjegojë mënyrën si veproi?

Nëse i intervistuari nuk mund të japë një përgjigje të qartë për këtë pyetje, apo nuk e di procedurën për marrjen e një pasaporte apo vize, kjo mund të jetë tregues i trafikimit.

15. Kush pagoi për shpenzimet e transportit të të intervistuarit?

Vetë Familja I dashuri Shoku Agjenci Rekrutuese
Të tjerë: _____

Pagimi nga një pale e tretë mund të jetë tregues i trafikimit.

LISTA E QENDRAVE QË OFROJNË SHËRBIME PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit (QKPVT)¹⁴⁸

Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit (QKPVT) është e vetmja qendër shtetërore, institucion i Shërbimit Social Shtetëror (MPCSSHB). Qendra zhvillon aktivitetin me një kapacitet maksimal prej 100 shtretërisht. QKPVT-ja bashkëpunon edhe me donatorë të ndryshëm, si për shembull IOM, UNICEF, UNHCR, OSCE etj, për nevoja specifike si asistencë teknike dhe financiare, trajnime etj.

QKPVT ofron shërbime për pritjen, akomodimin, rehabilitimin, referimin për integrim dhe riatdhesimin (kur përfituesit janë të shtetësisë së huaj) të tre grupeve të synuara kryesore:

- Gra e vajza shqiptare të trafikuar ose në rrezik.
- Gra e vajza të huaja të trafikuar.
- Fëmijë të pashoqëruar ose në rrezik trafikimi.

Organizimi dhe menaxhimi i kësaj qendre konsiston në aktivitetet e mëposhtme:

- Ushqim, veshje, strehim të përkohshëm (mbulimin e të gjitha nevojave emergjente që përfituesi paraqet).
- Asistencë psiko-sociale.
- Asistencë mjekësore.
- Asistencë ligjore.
- Siguri dhe mbrojtje të lartë të vajzave dhe grave.
- Formim profesional.
- Aktivitete me qëllim angazhimin në punë të ndryshme rehabilituese dhe ri-integruese.
- Referim për integrim.
- Kthim dhe bashkim me familjen.
- Ndjekje të viktimave dhe pasi largohen nga Qendra (kur është e mundur).

¹⁴⁸Informacioni për QKPVT-në është marrë nga raportimet e vazhdueshme të hartuara nga ZKK, tekstet e plota të të cilave mund t'i gjeni në adresën www.moi.gov.al. Parë për herë të fundit më 15 maj 2008.

Tjetër Vizion – Elbasan¹⁴⁹

Tjetër Vizion është një qendër rezidenciale me qendër në Elbasan. Kjo qendër përbëhet nga një strehëz për fëmijë, një strehëz për gra e vajza, si dhe Apartamente të Mbrojtura/Apartamente të Autonomisë së Lartë.

Aktivitetet e ofruara nga shërbimi rezidencial për fëmijë

- Mbarëvajtja shkollore.
- Aktiviteti higjeno-sanitar.
- Libri i jetës.
- Aktivitetet sportive.
- Laboratorë krijues dhe manuale.
- Autonomia në jetën e përditshme.
- Përgatitja profesionale dhe futja në punë.
- Riintegrimi në familjen e origjinës dhe komunitet.

Aktivitetet e ofruara nga strehëzat e grave-vajzave

- Plani i Punës Individuale.
- Përkujdesi shëndetësor.
- Këshillimi psiko-social.
- Mbështetje në marrëdhënien nënë-fëmijë.
- Fuqizimi i grave dhe vajzave.
- Forcimi i marrëdhënieve familjare.
- Riintegrimi socio-ekonomik.

¹⁴⁹Më shumë informacion për këtë qendër do të gjeni në faqen e saj të internetit <http://tjetervizion.org/> (parë për herë të fundit më 15 maj 2008), si edhe në Raportin e Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007, hartuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz.

Kontaktet:

Tel: 00355-54-52919
Fax: 00355-54-53397
Mob: 00355 682078901 / 692124108.
E-mail: tjetervizion@gmail.com

Qendra Psiko-Sociale Vatra – Vlorë¹⁵⁰

Qendra Psiko – Sociale *Vatra*, në kuadër të projektit “Strehëz për vajzat dhe gratë e trafikuar, të rrezikuara, klandestine dhe të dhunuara”, ofron këto shërbime:

- Akomodim nga 3 ditë deri në dy vjet (për të gjithë grupin e akomoduar).
- Intervistim dhe identifikim rasti (nga punonjëse sociale).
- Asistencë mjekësore (nga mjeku dhe infermieri i Qendrës).
- Asistencë ligjore (nga avokati i Qendrës).
- Asistencë psiko – sociale (nga psikologu).
- Sistemim i përkohshëm në apartament me qera për përfitueset.
- Vizita dhe këshillim në familjet e viktimave.
- Kurse profesionale (parukeri, rrobaqepësi, kompjuter, qëndistari).
- Ndërmjetësim për punësim.
- Mbrojtje e viktimave dëshmitare (strehëza mbrohet me polici private të licencuar nga Ministria e Brendshme).
- Vendosje në dispozicion të drejtorive të policive, të makinës dhe stafit të Qendrës për rastet e referuara nga këto polici.
- Gatishmëri 24 orë i stafit të Qendrës.

Kontaktet:

Tel.& Fax ++355 33 24078
Mob: 0692083349 / 0692083339
E-mail: qvatra@icc-al.org

¹⁵⁰Për më shumë informacion shih <http://www.mie.gov.al/upload/pkpl.pdf> (parë për herë të fundit më 15 maj 2008), Raportin e Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007, hartuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz, si edhe www.CAAHT.org. Parë për herë të fundit më 15 maj 2008.

Të Ndryshëm dhe të Barabartë – Tiranë¹⁵¹

Organizata të Ndryshëm & të Barabartë, në bashkëpunim dhe me organizata të tjera, i ofron çdo përfitueseje një paketë shërbimesh në përputhje me nevojat e saj, e cila përfshin:

- Strehim, siguri dhe plan ri-integrimi.
- Asistencë mjekësore.
- Këshillim psikologjik.
- Negocim/ndërmjetësim me familjen.
- Mbështetje dhe ndihmë ligjore.
- Aktivitete sociale.
- Asistencë për regjistrim/vazhdimësi në edukimin shkollor.
- Trajnime profesionale dhe punësim.
- Monitorim dhe ndjekje të mëpasshme për përfitueset e programit.
- Mbështetje për ri-integrim në jetën sociale.
- Strehim/kujdes alternativ.
- Mbështetje financiare për strehim.
- Etj.

Kontaktet:

| | |
|------------------|-------------------------------|
| Zyra Tel. | 04 243 606 |
| Tel. cel: | 069 20 88 696 / 068 40 33 668 |
| E-mail: | different & equal@icc-al.org |

Jetë dhe Shpresë – Gjirokastrë¹⁵²

Qendra Pritëse e Viktimave të Trafikimit “*Jetë dhe Shpresë*” në Gjirokastrë është qendra e parë pritëse në kufi me shtetin grek. Rastet akomodohen dhe trajtohen në qendër për një periudhë nga 7 në 10 ditë dhe ofrohen këto shërbime:

- Pritje të rasteve të referuara nga policia (gra dhe fëmijë) në momentet e para dhe më kritike, si dhe mbulim të gjithë territorit të vendit.
- Akomodim, ushqim dhe plotësim të nevojave të higjienës.
- Intervistim.

¹⁵¹Për më shumë informacion shih www.iomtirana.org.al dhe www.CAAHT.org. Parë për herë të fundit më 15 maj 2008.

¹⁵²Për më shumë informacion shih www.CAAHT.org. Parë për herë të fundit më 15 maj 2008.

- Këshillim psiko-social.
- Mbështetje emocionale e rastit dhe asistencë për ta ndihmuar të marrë një vendim për destinacionin e ardhshëm, që në varësi të rastit mund të jetë një qendër tjetër pritëse afatgjate në Shqipëri apo edhe pranë familjeve të origjinës.
- Procedura lehtësuese për qendrat e tjera pritëse, duke e shoqëruar secilin rast me dosjen përkatëse të të dhënave të grumbulluara, për të ndihmuar në identifikimin e nevojave të menjëhershme të tij gjatë trajtimit në qendrën ku referohet.

Kontaktet:

Tel./ Cel. 069 20 67 785 / 069 20 59 427

Dokumente ligjorë

Fletorja Zyrtare nr. 150, 2006.

Fletorja Zyrtare nr. 22, 2004.

Fletorja Zyrtare nr. 49, 2003.

Fletorja Zyrtare nr. 79, 2004.

Fletorja Zyrtare nr. 14, 2000.

Këshilli i Ministrave. *Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013*. 2008

Këshilli i Ministrave. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013*. Mars, 2008.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. *Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar*. Rezoluta nr 55/25. 15 Nëntor 2000.

Ligji “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, nr. 9205, dt. 15.03.2004 dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Ligji nr. 8920, datë 11.07.2002, Fletore Zyrtare nr. 41, korrik 2002.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. *Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010*.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. *Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2005-2010*.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. *Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013*.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9686, datë 26.2.2007 “*Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të Ndryshuar*”, Fletorja Zyrtare Nr 27, 2007.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9859, datë 21.1.2008 “*Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të Ndryshuar*” Fletorja Zyrtare nr. 10, 2008.

Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. *Neni 19, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës*. 20 nëntor 1989, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar më 27 shkurt 1992.

Neni 4/e i Ligj nr. 9642, datë 20.11.2006 “*Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”*”, Fletorja Zyrtare nr. 132, 2006.

Qeveria e Shqipërisë. *Strategjia Kombëtare Shqiptare për Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore: Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2005-2007*.

Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996 “*Për Ratifikimin e Konventës Europiane Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore*”, Fletorja Zyrtare Nr 20, 1996.

Ligji nr. 9642, datë 20.11.2006 “*Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”*”, Fletorja Zyrtare nr. 132, 2006.

Ligji nr. 9834, datë 22.11.2007 “*Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijëve, për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë”*”. Fletorja Zyrtare Nr 165, 2007.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. *Standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale, të miratuara me VKM 195, dt. 11.4.2007*.

Urdhër i Kryeministrit nr. 203, datë 19.12.2005 “*Për mënyrën e funksionimit të Njesisë Antitrafik*”.

Urdhër nr. 782, datë 04.04.06, i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale “*Për tarifat e Sistemit të Formimit Profesional*”.

Urdhër-Shërbim i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 871, datë 27.12.2007 “*Mbi procedurat që duhet të kryhen për intervistimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera*”.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 11.04.2007 “*Për Miratimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror në Qendrat Rezidenciale për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimit*”.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 05.01.2002 “*Për Krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore*” ndryshuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 653, datë 17.10.2005 “*Për disa ndryshime në vendimin nr. 8, datë 05.01.2002 “Për Krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore”, të ndryshuar*”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 913, datë 19.12.2007 “*Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, 2007-2010, dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj*”.

Raporte

Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor. *Country Reports on Human Rights Practices - 2007*. Marrë nga: <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2007/100544.htm> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

CAAHT. *The State of Efforts to Combat Trafficking of Persons in Albania – August 2006 – July 2007*. Marrë nga: www.CAAHT.com [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

Departamenti Amerikan i Shtetit. *Raporti për Trafikimin në Njerëz i qershor 2007-s*. <http://www.state.gov> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

U.S. Department of State. Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor. *Country Reports on Human Rights Practices 2007*. Marrë nga: <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2007/100544.htm> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

U.S. State Department. Office to Monitor and Combat Trafficking in Persons. *Facts About Human Trafficking*. Marrë nga: <http://www.state.gov/g/tip/rls/fs/2005/60840.htm> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

U.S. State Department. *Trafficking in Persons Report: June 2005*. United States Department of

State, Washington DC, 2005.

UNHRC. *Raport i Komisionerit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Parime dhe Udhëzime mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore*. 2002.

Vatra. *Raporti vjetor 2004*. Tiranë: "Vatra", 2005.

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz. *Raporti i Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007*. Marrë nga: <http://www.moi.gov.al/images/pdf/buletini/RaportiVleresuesStrategjiseKombetareAntitrafikim2005-2007.pdf> [Parë për herë të fundit në 15 maj 2008].

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz. *Raporti i Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007*.

Botime

Anti-Slavery International. *The migration-trafficking Nexus. Combating Trafficking through the protection of migrant's rights*. London: The printed Word. 2003.

Bisman C., *Social work practice: cases and principles*. Brooks/Cole Publishing Company, 1994.

Bloom, M. dhe Fischer, J. *Evaluating practice: guidelines for the accountable professional*. 1996.

Ekonomi, I., Gjermani, E., Danaj, E., Lula, E. dhe Beci, L. *Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: Një strategji për parandalimin e trafikimit*. Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim. Tiranë, 2006.

ICMPD. *Guidelines for the Development and Implementation of a Comprehensive National Antitrafficking Response*. ICMPD, 2006.

INSTAT. *Perspektivat gjimore në Shqipëri*. Tiranë, 2004.

International Centre for Women's Rights Protection and Promotion. *Identification of Trafficked Persons in Moldova*. La Strada. 2006.

IOM. *Consequences of Trafficking and Policy Responses*. Marrë nga: <http://www.iom.int/jahia/Jahia/>

[pid/677](#) [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

IOM. *Manuali i IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit*. Tiranë, 2007.

IOM. *Manualit të trajnimit Aspektet e shëndetit mendor të trafikimit të qenieve njerëzore*. IOM, Budapest: 2004.

Koca, Arqilea. *Vështrim juridiko-penal krahasues kriminologjik dhe procedural mbi trafikimin e qenieve njerëzore*. Tiranë: Konica, 2006.

Metani, A. dhe Omari, S. *Drejt rrugës për në BE; Monitorimi i shanseve të barabarta për gratë dhe burrat në Shqipëri*. Instituti Shoqëria e Hapur dhe Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim. Tiranë, 2006.

Orfano, I. (ed) *Protection of Victims of Trafficking and Fight against Crime (Italy and European Scenarios). On the road*. Martinsicuro, 2002.

OSBE/ODIHR. *Mekanizmat Kombëtare të Referimit. Bashkimi i përpjekjeve për mbrojtje të të drejtave të personave të trafikuar. Manual Praktik*. 2006.

Surtees, R. *Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Europën Juglindore*. OstWest Media: 2007.

Tchomarova, M. *Trafficking in women – personal, psychological and social problems in (non)-united Europe*. Sofia: Animus Association Foundation, 2001.

U-*NICEF. *Guidelines for Protection Of The Rights Of Children Victims Trafficking in South Eastern Europe*. UNICEF. 2003.

UNICEF. *Let's Talk: Developing Effective Communication with Child Victims of Abuse and Human Trafficking*. UNICEF Kosovo. 2004.

UN-Interagency Project on Trafficking in Women and Children in the Sub-Mekong Region. *Training Manual for Combating Trafficking in Woman and Children*. 2001. Marrë nga: http://www.un.or.th/traffickingProject/trafficking_manual.pdf [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

UNODC. *Toolkit to Combat Trafficking in Persons*. United Nations, 2006. Marrë nga: <http://>

www.unodc.org/documents/human-trafficking/HT-toolkit-en.pdf [Parë për herë të fundit në 15 maj 2008].

World Health Organization. *A critical link. Interventions for physical growth and psychological developments: A review. 2003.* Marrë nga: www.who.int/child-adolescent-health/ [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

World Health Organization. Child abuse and neglect. Fact sheet N150, 1997. Marrë nga: <http://www.who.int/inf-fs/en/fact150.html> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

World Health Organization. *Ethical and Safety Recommendations for interviewing Trafficked Women.* WHO. 2003

World Health Organization. *Sexual relationship violence in adolescents: A review on the impact of sexual relationship violence on health and opportunities for prevention.* Draft. 2003. Marrë nga: <http://www.who.int/> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

Zickler, P. *Childhood sex abuse increases risk for drug dependence in adult women. Research Findings.* National Institute of Drug Abuse. NIDA Notes Vol.17, No. 1, 2002. Marrë nga: <http://www.nida.nih.gov/NIDA/NNVol17N1/Childhood.html> [Parë për herë të fundit më 15 maj 2008].

Zimmerman, C. *Trafficking in women: Conceptualizing and measuring health risks and consequences. Dissertation for PhD.* London School of Hygiene and Tropical Medicine, 2004.

Zimmerman, C., Yun, K., Shvab, I., et al. *Health risks and consequences of trafficking in women and adolescents. Findings from a European study.* London School of Hygiene and Tropical, 2003.

Faqe interneti

“Deklarata Botërore e të Drejtave të Njeriut” në faqen zyrtare të OKB-së: [ht-tp://www.un.org/Overview/rights.html](http://www.un.org/Overview/rights.html) [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

“Lista e Konventave” në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme: http://www.mfa.gov.al/shqip/lista_e_konventave.asp [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

Faqja zyrtare e Antislavery Organization: www.antislavery.org [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

Faqja zyrtare e BKTF: www.bktf-coalition.org [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

Faq-ja zyrtare e IOM Tirana: www.iomtirana.org.al [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

Faqja zyrtare e MPÇSSH-së, Strategji dhe standarde: <http://www.mpcs.gov.al/legjislacioni/strategji-standarte> [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

Faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit: <http://www.who.int> [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

Faqja zyrtare e programit CAAHT: www.CAAHT.org [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

Faqja zyrtare e Tjetër Vizion-it: <http://tjetervizion.org/> [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

Konventat në faqen zyrtare të OKB-së: www.uncij.org/documents/conventions [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: <http://www.president.al/shqip/kushtetuta.asp> [Parë për herë të fundit më 15 maj, 2008].

Të tjera

Departamenti i Punës Sociale dhe Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Shëndetit Mendor. *Kodi etik i punonjësit social*. Tiranë: Grafon, 2003.

Key points from SC (UK) Manual *Working with separated children*. 1998; Personal Communication with IOM representative, 2001.

